



UNIVERSITETI “ALEKSANDËR XHUVANI”
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I HISTORISË DHE GJEOGRAFISË
PROGRAMI I DOKTORATURËS

DISERTACION

**TEMA: PËRQASJA E LEGJISLACIONIT
PËR TRASHËGIMINË KULTURORE E NATYRORE
DHE PËRVOJA NË QARKUN E ELBASANIT**

**Paraqitur në kërkim të gradës shkencore
“Doktor i Shkencave Albanologjike”
nga ERJONA HASA**

Udhëhequr nga Prof. Dr. VILSON KURI

ELBASAN, 2017

DEKLARATË STATUORE

Nën përgjegjësinë time deklaroj se ky punim është shkruar prej meje, nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar i tëri ose pjesë të veçanta të tij. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër përveç rasteve të cituara dhe referuara.

E drejtë e autorit © 2017. Të gjitha të drejtat i rezervohen autorit.



UNIVERSITETI “ALEKSANDËR XHUVANI”
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
PROGRAMI I DOKTORATËS

PROGRAM I DOKTORATËS

Tema: PËRQASJA E LEGJISLACIONIT
PËR TRASHEGIMINË KULTURORE
E NATYRORE DHE PËRVOJA NË
QARKUN E ELBASANIT

Paraqitur në kërkim të gradës shkencore “Doktor”
nga ERJONA HASA

Juria e mbrojtjes

1. _____ Kryetar
2. _____ (Oponent)
3. _____ (Oponent)
4. _____ (Anëtar)
5. _____ (Anëtar)

Elbasan, 2017

Studimi “Përfaqja e legjislacionit për trashëgiminë kulturore e natyrore dhe përvoja në Qarkun e Elbasanit” përbën një përpjekje serioze për të ruajtur, administruar dhe pasuruar më tej vlerat që mbart trashëgimia jonë kulturore, e veçanërisht Qarku i Elbasanit. Studimi ynë mbështetet në disa projekte europiane dhe synon të fuqizojë bashkëpunimin midis qeverisjes lokale dhe shoqërisë civile për mobilizimin e tyre në mbrojtje të vlerave të çmuara të trashëgimisë kulturore në Qarkun e Elbasanit.

Studimi synon të dëshmojë se sa i rëndësishëm është mobilizimi i aktorëve kryesorë në fushën e trashëgimisë kulturore në Qarkun e Elbasanit për rritjen e bashkëpunimit midis qeverisjes lokale dhe shoqërisë civile për gjetjen e zgjidhjeve të duhura për sfidat e mëdha në fushën e trashëgimisë kulturore. Ky studim synon të ndërgjegjësojë shoqërinë civile në ruajtjen dhe administrimin e duhur të vlerave të trashëgimisë kulturore në Qarkun e Elbasanit.

Studimi nxjerr në pah nevojën për vendosjen e politikave të mira publike nën nivel lokal por edhe qëndror në fushën e trashëgimisë kulturore, përmes një analize të detajuar të politikave që duhen ndjekur.

Për realizimin e këtij studimi është përdorur metoda cilësore e sasiore. Metoda sasiore ka mundur grumbullimin e të dhënave përmes anketës gjysmë të strukturuar të plotësuar nga popullata dhe metoda cilësore të dhënat përmes intervistave të thelluara me specialistë në insitucionet vendore.

Studimi është përshkrues, pasi mundëson një përshkrim të hollësishëm të çështjeve në studim përmes analizës së detajuar të informacionit që merret nga të anketuarit, nga specialistët e ndryshëm apo nga analiza e literaturës së marrë në shqyrtim.

Fjalë/i kyçe : legjislacion, plan rajonal, trashëgimi kulturore, ruajtje e integruar, strategji rajonale, vullnetarizëm

ABSTRACT

The research “ The approach of the legislation for the integrated conservation and development of the cultural heritage in the region of Elbasan” has made a serious effort to preserve, administer and enrich the values that bear cultural heritage, and especially the Elbasan Region.

Our study is supported by several European projects and aims to strengthen the cooperation between local government and civil society for mobilizing them in the protection of valuable cultural heritage values in the Elbasan Region.

The study aims to demonstrate how important it is to mobilize stakeholders in the field of cultural heritage in the region of Elbasan to increase cooperation between local government and civil society to find appropriate solutions to the major challenges in the field of cultural heritage. This study aims to establish an effective cooperation between voluntary work, civic and social mobilization care taking into account the positive effect produced a store of value, protection of cultural heritage in the region of Elbasan.

Our study represents a serious effort to establish better public policy at the local level but also central to the cultural heritage, through a series of policy analysis.

For the realization of this study are used the qualitative and quantitative methods. The quantitative method has enabled the collection of data through semi-structured survey completed by population and qualitative methods of data through in-depth interviews with experts in local institutions.

The study is descriptive, since it enables a detailed description of the issues in the study through the detailed analysis of information obtained from respondents from different specialists or by the analysis of the literature taken into consideration.

Key words : legislation, regional plan, cultural heritage, integrated conservation, regional strategy, volunteer.

TABELA E PËRMBAJTJES

DEKLARATË STATUORE	ii
Abstrakt	iv
Abstract	vi
MIRËNJOHJE	xiii
LISTA E SHKURTIMEVE/SHKURTESA	xvi
KAPITULLI 1 HYRJE	1
1.1 Prezantim i studimit	1
1.2 Parashtrimi i problemit	5
1.3 Qëllimi dhe objektivat e studimit	7
1.4 Pyetjet kërkimore	7
1.5 Organizimi i studimit	8
KAPITULLI 2 ANALIZA E LITERATURËS	
TRASHËGIMIA KULTURORE DHE RAPORTI I SAJ ME	
INSTRUMENTAT NDËRKOMBËTARË	10
2.1 Instrumentat ndërkombëtare për trashëgiminë kulturore	10
2.2 Legjislacioni kombëtar për trashëgiminë kulturore	13
2.3 Institucionet kryesore të menaxhimit të trashëgimisë kulturore në Qarkun e Elbasanit	18
2.4 Problematikat dhe sfidat aktuale të trashëgimisë kulturore në Qarkun e Elbasanit	19
2.5 Objektet më të rëndësishme të trashëgimisë kulturore në qarkun e Elbasanit	20

KAPITULLI 3 METODOLOGJIA	37
3.1 Instrumentat e kërkimit	37
3.2 Përzgjedhja e kampionit	42
3.3 Kufizimet e studimit	44
3.4 Analiza e të dhënave	45
3.5 Rezultate të anketës për kontributin e vullnetarizmit	49
3.6 Analizat e pavarësisë për variablat në studim	61
 KAPITULLI 4 GJETJET E STUDIMIT	 100
GJETJA E PARË: KRIJIMI DHE PËRVIJIMI I STRATEGJISË RAJONALE TË TRASHËGIMISË KULTURORE, SI NJË GARANCI PËR MUNDËSIMIN E NJË ZHVILLIMI TË QËNDRUESHËM NË NIVEL QARKU	 100
GJETJA E DYTË: ZHVILLIMI I NJË KËNDVËSHTRIMI EUROPIAN PËR HARTIMIN DHE PËRVIJIMIN E NJË PLANI KONKRET RAJONAL TË TRASHËGIMISË KULTURORE NË QARKUN E ELBASANIT.	 101
 KAPITULLI 5 PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	 104
Përfundime	104
Rekomandimet	108
 BIBLIOGRAFIA	 112
 SHTOJCA	 122
SHTOJCË 1 - PYETËSORI	122
SHTOJCË 2 - LISTA E MONUMENTEVE TË KULTURËS QË JANË MARRË NË STUDIM NË QARKUN E ELBASANIT.	132
SHTOJCË 3 - Fotot e objekteve kryesore kulturore	139
SHTOJCË 4 - TABELAT	143

LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Të intervistuar sipas grupmoshës dhe gjinisë	46
Tabela 2 : Si e kuptoni termin “Vullnetarizëm”?	56
Tabela 3 : Testi Hi-Katror	63
Tabela 4: Sa jeni vullnetarë dhe Gjinia	63
Tabela 5 : Testi Hi-Katror	64
Tabela 6 : Testi Hi-Katror	66
Tabela 7 : Grupmosha dhe vullnetarizimi	66
Tabela 8 : Testi Hi-Katror	67
Tabela 9 : Vullnetarizëm dhe vendbanimi	69
Tabela 10: Testi Hi-Katror	70
Tabela 11 : Sa jeni vullnetarë, si qytetarë të Qarkut të Elbasanit dhe vëndbanimi	70
Tabela 12 : Testi Hi-Katror	71
Tabela 13 :Testi Hi-Katror	73
Tabela 14 : Niveli më i lartë i arsimimit të përfunduar dhe vullnetarizmi	74
Tabela 15 :Testi Hi-Katror	75
Tabela 16 : Testi Hi-Katror	77
Tabela 17 : Sa jeni vullnetarë dhe të ardhurave ku futet e ardhurat mesatare mujore	78
Tabela 18 : Testi Hi-Katror	79
Tabela 19 : Vullnetarizëm dhe Gjinia	81
Tabela 20 : Testi Hi-Katror	82
Tabela 21 : Sa jeni vullnetarë, si qytetarë dhe Gjinia	82
Tabela 22: Testi Hi-Katror	83
Tabela 23 : Grupmosha dhe termi “Vullnetarizëm”	84

Tabela 24 : Testi Hi-Katror	85
Tabela 25 : Grupmosha dhe vullnetarizmi	86
Tabela 26 : Testi Hi-Katror	87
Tabela 27 : Termi “Vullnetarizëm” dhe vendbanimi	88
Tabela 28: Testi Hi-Katror	89
Tabela 29 : Vullnetarizmi dhe vendbanimi	90
Tabela 30 : Testi Hi-Katror	91
Tabela 31 : Testi Hi-Katror	93
Tabela 32 : Niveli më i lartë i arsimimit të përfunduar dhe vullnetarizmi	93
Tabela 33 : Testi Hi-Katror	94
Tabela 34 : Termi “Vullnetarizëm” dhe të ardhurat mesatare mujore	96
Tabela 35 : Testi Hi-Katror	97
Tabela 36 : Sa jeni vullnetarë, si qytetarë të Qarkut të Elbasanit dhe të ardhurat mesatare mujore	97
Tabela 37 : Testi Hi-Katror	99

LISTA E GRAFIKËVE

Grafiku 1: Shpërndarja e të anketuarve sipas gjinisë	46
Grafiku 2: Shpërndarja e të anketuarve sipas nivelit arsimor	47
Grafiku 3: Shpërndarja e të anketuarve sipas punësimit	47
Grafiku 4 : Shpërndarja e të anketuarve sipas të ardhurave mujore	48
Grafiku 5: Sa mund të kontribuojë vullnetarizmi në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore?	49
Grafiku 6: A ka iniciativa vullnetare në komunitetin tuaj për mbrojtje të trashëgimisë kulturore?	50
Grafiku 7: A jeni pjesë e këtyre iniciativave?	50
Grafiku 8: A pajtoheni me qëndrimin se vullnetarizmi në trashëgimi kulturore mund të prodhojë zhvillim ekonomik për qytetin?	51
Grafiku 9: Në çfarë objektsh të trashëgimisë kulturore keni kontribuar me veprimtari vullnetare kohëve të fundit?	85
Grafiku 10: Në çfarë vlerash të trashëgimisë kulturore keni kontribuar me veprimtari vullnetare kohëve të fundit?	53
Grafiku 11: A pajtoheni me qëndrimin se vullnetarizmi në trashëgimi kulturore mund të prodhojë zhvillim ekonomik për qytetin?	53
Grafiku 12: Renditni sipas përgjegjësisë (1-5) aktorët e mëposhtëm që kanë rol në nxitjen e vullnetarizmit në mbrojtje të trashëgimisë kulturore?	54
Grafiku 13: Cilët janë faktorët nxitës për ju, që të angazhoheni për punë vullnetare për trashëgiminë kulturore?	55
Grafiku 14: Sa jeni vullnetarë, si qytetarë të Elbasanit?	56
Grafiku 15: A është trashëgimia kulturore prioritet në raport me çështjet e tjera që e preokupojnë Elbasanin?	57
Grafiku 16: Sa e njihni trashëgiminë kulturore të qytetit?	57

Grafiku 17: Cilat kategori moshash duhet të angazhohen në vullnetarizëm për trashëgimine kulturore?	58
Grafiku 18: Sa paraqet pengesë papunësia dhe gjendja ekonomike në angazhimin tuaj vullnetar?	58
Grafiku 19: A ekziston (funksionon) ndonjë grup i vullnetarëve në qytetin e Elbasanit?	59
Grafiku 20 :Sa është e nevojshme që Elbasani të ketë grupe të vullnetarëve rreth çështjeve të ndryshme?	59
Grafiku 21: Vullnetarizimi dhe Gjinia	62
Grafiku 22: Si e kuptoni termin “Vullnetarizëm” sipas grupmoshës	65
Grafiku 23: Sa jeni vullnetarë, si qytetarë të Qarkut të Elbasanit sipas grupmoshës	67
Grafiku 24: Si e kuptoni termin “Vullnetarizëm” sipas vendbanimit	69
Grafiku 25: Sa jeni vullnetarë, si qytetarë të Qarkut të Elbasanit sipas vendbanimit	71
Grafiku 26: Niveli më i lartë i arsimimit të përfunduar dhe përcaktimit të termit të vullnetarizmit	73
Grafiku 27: Niveli më i lartë i arsimimit të përfunduar dhe vullnetarizmi	74
Grafiku 28: Vullnetarizmi dhe të ardhurat	77
Grafiku 29 : Sa jeni vullnetarë, si qytetarë të Qarkut të Elbasanit?	78
Grafiku 30 : Vullnetarizmi dhe gjinia e të intervistuarit	81
Grafiku 31 : Sa jeni vullnetarë, si qytetarë të Qarkut të Elbasanit sipas gjinisë	82
Grafiku 32: Vullnetarizmi sipas grupmoshës	85
Grafiku 33 : Sa jeni vullnetarë, si qytetarë të Qarkut të Elbasanit?	86
Grafiku 34 : Vullnetarizmi sipas vendbanimit	89
Grafiku 35 : Sa jeni vullnetarë si qytetarë të Qarkut të Elbasanit?	90
Grafiku 36 : Niveli më i lartë i arsimimit të përfunduar dhe përcaktimit të termit të vullnetarizmit	92
Grafiku 37 : Niveli më i lartë i arsimimit të përfunduar dhe vullnetarizmi	94

Grafiku 38 : Si e kuptoni termin “Vullnetarizëm”?	96
Grafiku 39 : Sa jeni vullnetarë, si qytetarë të Qarkut të Elbasanit dhe të ardhurat	98

Për realizimin e këtij studimi kanë dhënë një kontribut të çmuar një sërë individësh, të cilët me mbështetjen dhe sugjerimet e tyre, më kanë inkurajuar vazhdimisht në realizimin e tij.

Mirënjohje e thellë u shkon profesorëve të mi në Fakultetin e Shkencave Humane, në veçanti anëtarëve të Departamentit të Histori-Gjeografi për sugjerimet e vlefshme në pasurimin e mëtejshëm të tij.

Falënderoj udhëheqësin tim, Prof.Dr.Vilson Kuri, për ndihmën e pakursyer në realizimin e të gjithë hapave të studimit tim.

Një falënderim shkon për të gjithë punonjësit e trashëgimisë kulturore në qark dhe bashki që pranuan bashkëpunim të singertë për të plotësuar pyetësin, si dhe drejtuesit e institucioneve dhe specialistë të kësaj fushe që intervistua duke mundësuar plotësimin normal të metodologjisë së ndjekur.

Gjithashtu dëshiroj të falënderoj koleget e mia të Fakultetit të Shkencave të Edukimit Elbasan, për mbështetjen e pakushtëzuar për realizimin me sukses të këtij studimi.

Së fundi, do të doja të shprehja falënderimet e mia të padiskutueshme për familjen time, bashkëshortin për mbështetjen dhe mirëkuptimin e vazhdueshëm.

Faleminderit!

1.1 PREZANTIM I STUDIMIT

Trashëgimia kulturore në përbërjen e saj studion të gjitha ato problematika apo çështje që ndikojnë në krijimin dhe përvijimin e identitetit kombëtar të një kombi. Si e tillë, ajo ndikon dukshëm në afirmimin e kontributit që popuj të ndryshëm sjellin në favor të emancipimit të të gjithë njerëzimit. Parë nga ky kontekst qartësojmë se trashëgimia kulturore ndikon ndjeshëm në këto fusha kryesore:

- Së pari, në theksimin e elementit kulturor në kuadrin e identitetit të çdo kombi;
- Së dyti, në evidentimin dhe promovimin e bashkësisë së vlerave që ruan një komb i caktuar;
- Së treti, në vijueshmërinë dhe integrimin e trashëgimisë kulturore me aktualitetin.

Koncepti i sotëm i trashëgimisë kulturore është rezultat i procesit të lidhur me zhvillimin e shoqërisë moderne, vlerat dhe kërkesat e saj. Në të kaluarën, i është kushtuar më tepër rëndësi veprave të veçanta të artit apo monumenteve kryesore, por ngjarjet shkatërruese masive që ndodhën pas viteve 90, kanë bërë që njerëzit të kuptojnë se jeta e tyre është e lidhur ngushtë më kontekstin në të cilën ato jetojnë. Ky kontekst përbën thelbin e identitetit të tyre kulturor, dhe shërben edhe si një referencë intelektuale dhe shpirtërore për një cilësi të ekuilibruar të jetës¹.

Përparimi i çdo shoqërie njerëzore mbështetet fort në arritjet dhe kulturën e shoqërive dhe brezave paraardhës. Kjo është e vërtetë edhe për shoqërinë tonë bashkëkohore. Në mjedisin që na rrethon ruhen elementë të ndryshëm dhe të shumtë të trashëguar deri te në nga shoqëritë dhe brezat para nesh. Aftësia krijuese e shoqërive të së kaluarës ka lënë gjurmë të prekshme që i ndeshim në formën e mbetjeve arkitekturore që gjenden përreth nesh, ashtu dhe në formën e strukturave arkeologjike në sipërfaqen e tokës, në formën e objekteve apo veprave të artit. Çdo objekt i prekshëm lëndor i prodhuar nga shoqëritë apo brezat e kaluar përmban në vetvete një informacion të pasur historik e kulturor.

¹ Feiden, B, J, Jokilehto: Udhëzuesi për menaxhimin e trashëgimisë kulturore botërore, ICCROM, 1998, fq 13.

Trashëgimia kulturore ka dy ndarje bazë: trashëgimia materiale dhe shpirtërore². Trashëgimia kulturore është prodhimi artistik dhe kulturor që seleksionohet dhe vlerësohet vetëm nga koha³. Trashëgimia kulturore materiale karakterizohet nga dy grupe të mëdha:

Pjesë përbërëse e trashëgimisë kulturore është edhe trashëgimia natyrore. Trashëgimia natyrore dhe peisazhi çmohen gjithashtu të barasvlefshme me trashëgiminë kulturore. Vetë peisazhi ka një rol shumë të rëndësishëm publik në formimin e kulturave në çdo mjedis dhe se këto kultura kanë shërbyer e shërbejnë si bazë përbërëse e trashëgimisë evropiane dhe e konsolidimit të identitetit evropian. Në vlerat e trashëgimisë natyrore, mjedisore dhe të peisazhit përfshihen: elementët natyrorë të përbëra nga formacione fizike dhe biologjike, si dhe site natyrore, pra zona me vlera unike shkencore, ekologjike, kulturore, historike, didaktike, fetare apo bukuri natyrore të veçanta. Elementet natyrore janë ata të cilët përbëhet nga formacione fizike dhe biologjike apo grupe të këtij karakteri vetëm kur ato paraqesin një vlerë të jashtëzakonshme, universale nga pikëpamja estetike ose edhe shkencore. Formacionet gjeologjike dhe fiziografike dhe zona të përcaktuara me saktësi janë ato zona të cilat përbëjnë habitatin e llojeve të gjallesave endemike, relike apo të kërcënuara të kafshëve dhe të bimëve të një vlere të jashtëzakonshme, universale nga pikëpamja e shkencës apo ruajtjes. Sitet natyrore janë ato zona natyrore që me saktësi përcaktojnë një vlerë të jashtëzakonshme, universale nga pikëpamja e shkencës, e ruajtjes apo e bukurisë natyrore.

Trashëgimia kulturore shpirtërore ka formë jo lëndore, nuk është i prekshëm dhe i përket botës shpirtërore si psh: përdorimi i gjuhës, krijimtaria gojore, traditat, zakonet, besimet, marrëdhëniet njerëzore, folklori vokal, koreografik apo instrumental⁴. Përveç ndryshimeve të këtyre grupeve të mëdha vihen re dhe dallime në mënyrën e transmetimit, përdorimit dhe të konservimit, të këtyre prodhimeve të trashëgimisë kulturore. Nëse objektet e trashëgimisë materiale kulturore janë pjesë e mjedisit kulturor që na rrethon, trashëgimia kulturore shpirtërore është pjesë e formimit tonë të brendshëm, si pjesëtar i një shoqërie të caktuar.

Në ditët e sotme, koncepti i trashëgimisë kulturore lidhet me të gjithë mjedisin e ndërtuar dhe është rezultat i procesit të lidhur me zhvillimin e shoqërisë moderne, vlerat dhe kërkesat e saj. *Tendenca e sotme është që trashëgimia kulturore të kuptohet sa më shumë të jetë e mundur në tërësinë e saj, në mënyrë që të*

2 Kuri.V, Tradita dhe e Drejta Zakonore Shqiptare, 2011, fq 41.

3 Po aty, fq 42.

4 Neni 4 i ligjit Nr. 9048, dt 07.04.2003 i plotësuar me: *Ligjin nr.9592, datë 27.07.2006; Ligjin nr.9882, datë 28.02.2008; Ligjin nr.10 137, datë 11.5.2009.*

*përmbledhë të gjitha arritjet e qënieve njerëzore në rrjedhën e kohës.*⁵ Trashëgimia kulturore përbëhet nga lloje të ndryshme pasurish që ndërlidhen me një shumëllojshmëri mjedisesh. Kjo trashëgimi përfshin jo vetëm monumentet të rëndësishme, zona historike, por edhe tërësinë e mjedisit të ndërtuar nga njeriu. Burimet e trashëgimisë kulturore mund të lidhen me vlera të ndryshme në varësi të kontekstit të tyre. Por, në çdo rast, duhen përcaktuar qartë konceptet që lidhen me përkufizimet e objektit, vlerave dhe burimeve të trashëgimisë.

Në rrafshin konceptual trashëgimia kulturore materiale shihet si një prej burimeve më të rëndësishme botërore që nuk ripërtërihet.⁶ Nga ky përkufizim, duhen bërë disa përpjekje të veçanta për të rivendosur ekuilibrin ndërmjet nevojave tona dhe mbrojtjes së këtij burimi.

Karakterizimi i trashëgimisë kulturore, vlerat e lidhura me të dhe politikat për mbrojtjen e saj janë paraqitur në dokumenta të ndryshme ndërkombetare të UNESCO-s⁷, nga të cilat më të rëndësishme janë një sërë Rekomandimesh dhe Konventash.⁸

Rekomandimet japin udhëzime të përgjithshme për mbrojtjen e llojeve të veçanta të trashëgimisë, sic mund të jenë zonat historike, zonat arkeologjike etj.⁹ Ndërsa, Konventat shihen më tepër si instrumenta ligjorë, të cilat ratifikohen nga shtetet nënshkruese.¹⁰

Dokumenti më i rëndësishëm ndërkombëtar është Karta Ndërkombëtare për Konservimin dhe Restaurimin e Monumenteve dhe Siteve, e njohur si Karta e Venecias në vitin 1964, gjatë Kongresit të dytë të Arkitektëve dhe Teknikëve të Monumenteve Historike.¹¹ Ky dokument mbart një vlerë të jashtëzakonshme për hartimin e politikave të konservimit në të gjithë globin.

Konferenca e Përgjithshme e UNESCO-s, në vitin 1972¹², përfaqëson një shprehje të vullnetit për të siguruar ndihmë të organizuar ndërkombëtare në mbrojtje të Siteve të Trashëgimisë Botërore dhe vlerave të tyre. Qëllimi i kësaj Konvente është të mbrojë sitet që përfaqësojnë një “vlerë të jashtëzakonshme universale”¹³. Lista e Trashëgimisë Botërore, e cila u themelua dhe u mbështët nga kjo Konventë, identifikon sitet në Shtete të ndryshme Anëtare si burime me rëndësi ndërkombëtare. Së bashku, këto burime unike përfaqësojnë larminë

5 Po aty, fq 14.

6 Shtojca A e Udhëzuesit për Menaxhimin e Trashëgimisë Botërore, fq 135.

7 Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsimin, Shkencën dhe Kulturën, burimi: www.unesco.org

8 Udhëzuesi për menaxhimin e trashëgimisë kulturore botërore, Bernard M. Feilden dhe Jukka Jokilehto.

9 Shtojca C të Udhëzimit për menaxhimin e trashëgimisë kulturore botërore, fq 143.

10 Konventa në lidhje me mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore Botërore, UNESCO 1972 fq 7.

11 Shtojca A e Udhëzimit, fq 135.

12 Konventa në lidhje me Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore Botërore, Paris, 21 nëntor 1972

13 Konventa për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore Botërore, Neni 1, Paris, 1972.

e pasur të trashëgimisë botërore, dhe për rrjedhojë ato mbartin dhe vlera të rëndësishme edukative.

Sipas Konventës për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore Botërore, trashëgimia kulturore përfshin monumente, grupe ndërtesash apo sitesh që përcaktohen në vijim¹⁴:

- **monumente:** vepra arkitektonike, vepra monumentale të skulpturës dhe pikturës, elemente apo struktura të natyrës arkeologjike, mbishkrime, banesa në shpella dhe kombinime elementësh të cilat janë më vlerë të jashtëzakonshme universale në aspektin historik, artistik, apo shkencor;
- **grupe ndërtesash:** grupe ndërtesash të ndara ose të lidhura, që për shkak të arkitekturës, homogjenitetit, apo pozitës së tyre, kanë vlerë të jashtëzakonshme universale në aspektin historik, artistik, ose shkencor;
- **sitet:** vepra të krijuara nga njeriu apo vepra të ndërthurura përmes aktivitetit natyror dhe njerëzor, dhe zona që përfshijnë vende arkeologjike që kanë një vlerë të jashtëzakonshme universale në aspektin historik, estetik, etnologjik apo antropologjik¹⁵.

Në një përkufizim tjetër për trashëgiminë kulturore, referuar Udhëzuesit për Menaxhimin e Trashëgimisë Kulturore Botërore, gjejmë këtë përcaktim: “Trashëgimia kulturore është shprehje e mënyrës së jetës, e zhvilluar në një komunitet dhe e kaluar prej një gjenerate në tjetrën përfshirë këtu praktikën, vëndet, objektet, shprehjen artistike dhe të vlerave”¹⁶.

Ndërkaq, monumetet e kulturës janë pjesë e rëndësishme e trashëgimisë kulturore. Dora njerëzore ka krijuar monumente me vlera të rralla që mbrohen dhe ruhen në mënyrë dhe rrugë të veçantë, të sanksionuara me ligje, që i përcakton si “trashëgimi e veçantë “botërore dhe ndërkombëtare, por edhe tërësinë e mjedisit të ndërtuar nga njeriu. Burimet e trashëgimisë kulturore mund t lidhen me vlera të ndryshme në varësi të kontekstit të tyre¹⁷. Meqënëse trashëgimia kulturore fizike është një prej burimeve më të rëndësishme botërore, atehërë edhe konceptet që lidhen me përkufizimin e objektit, vlerave të tij duhet të jene të përcaktuara qartë . Qyteti i Elbasanit ka një larmi të pakrahasueshme monumentesh kulturore. Një pasuri e cila ofron një potencial të mundshëm për një zhvillim të suksesshëm turistik. Elbasani, një qytet në qendër të Shqipërisë ofron monumente nga më të ndryshëm duke filluar që nga kalatë, sikundër

14 Neni 1 i Konventës “Për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore dhe Natyrore”, Fq 2.

15 Yahaya.A; The Definitions of Heritage from tangible to intangible, International Journal of Heritage Studies, fq 295.

16 ICOMOS,ICTC, 2002.

17 Bernard Feiden dhe Jukka Jokilehto, Udhëzuesi për menaxhimin e trashëgimisë kulturore botërore, ICCROM, 1998, fq 14

është ajo në qendër të qytetit; objekte kulti, xhami dhe kisha të periudhave të hershme dhe me mjaft interes; hamame të peridhës turke. sikundër është ajo e pazarit dhe ajo në brendësi të kalasë; muzeun etnografik; e mjaft objekte me vlera të mëdha që janë realisht një potencial mjaft i fuqishëm për një turizëm kulturor të suksesshëm¹⁸.

Vlerat e monumenteve të kulturës janë të shumta. Shumica e këtyre vlerave janë të papërsëritshme dhe të pakthyeshme, sepse kanë ndryshuar kushtet e formimit të tyre. Sipas kësaj kategorie monumentet e kulturës janë:

1- Burim i pazëvendësueshëm informacioni shkencor për shumë fusha dhe shkenca (historinë, arkeologjinë, etj.)

2- Didaktike dhe kulturore. Duke qenë të papërsëritshme dhe objekte të rralla, monumentet e kulturës kanë vlera të padiskutueshme kulturore dhe didaktike.

3- Turistike. Nëse monumentet e kulturës mirëmbahen dhe mbrohen, nëse studiohen me kujdes, përcaktohen dhe propagandohen vlerat e tyre, atëherë ato mund të kthehen burim jo i vogël të sigurimit të të ardhurave financiare.

1.2 PARASHTRIMI I PROBLEMIT

Po ti referohemi studimeve të kryera në fushën e trashëgimisë kulturore, vihet re se studime të tilla janë fokusuar më tepër tek restaurimi i monumenteve të kultures¹⁹, tek mundësia e zhvillimit ekonomik e turistik që ofron trashëgimia kulturore në një vënd të caktuar.

Studimi ynë përbën një përpjekje serioze për të ruajtur, administruar dhe pasuruar më tej vlerat që mbart trashëgimia jonë kulturore, e veçanërisht Qarku i Elbasanit. Studimi ynë mbështetet në disa projekte europiane dhe synon të fuqizojë bashkëpunimin midis qeverisjes lokale dhe shoqërisë civile për mobilizimin e tyre në mbrojtje të vlerave të cmuara të trashëgimisë kulturore në Qarkun e Elbasanit.

Qyteti i Elbasanit ka një larmi të pakrahasueshme monumentesh kulturore²⁰. Një pasuri e cila ofron një potencial të mundshëm për një zhvillim të suksesshëm turistik. Elbasani, një qytet në qendër të Shqipërisë ofron monumente nga më të ndryshëm duke filluar që nga kalatë, sikundër është ajo në qendër të qytetit; objekte kulti, xhami dhe kisha të periudhave të hershme dhe me mjaft interes; hamame të periudhës turke sikundër është ajo e pazarit dhe ajo në brendësi të kalasë; muzeun etnografik e mjaft objekte me

18 "Strategjia e Zhvillimit Rajonal e Qarkut të Elbasanit", Maj 2012, fq 8.

19 Studimi "Historia e restaurimit të monumenteve të kulturës pas Luftës së Dytë Botërore", E.Orhani

20 Strategjia e Zhvillimit Rajonal Elbasan, Elbasan fq 3.

vlera të mëdha që janë realisht një potencial mjaft i fuqishëm për një turizëm kulturor të suksesshëm. Rajoni i Elbasanit ka një potencial të fuqishëm turistik, i cili aktualisht nuk shfrytëzohet, kurohet dhe promovohet mjaftueshëm. Rajoni posedon shumë atraksione turistike; më shumë se 100 monumente kulturore, 24 kështjella, 2 kulla sahati në Elbasan dhe Peqin, më shumë se 15 objekte kulti, mozaikë etj.²¹

Qarku i Elbasanit ka mjaft objekte me vlera që meritojnë jo vetëm statusin e monumentit kulturor, por pse jo dhe statusin e trashëgimisë botërore. Këto vlera meritojnë studime të detajuara, evidentim të vlerave që mbartin dhe të bëhen propozimet pranë organeve kompetente të konventave përkatëse ndërkombëtare për mbrojtjen e tyre²².

Po ti referohemi Qarkut të Elbasanit, trashëgimia kulturore përfaqësohet nga trashëgimia kulturore materiale dhe ajo shpirtërore. Studimi ynë bazohet kryesisht në trashëgiminë materiale. Trashëgimia kulturore materiale në qark prezantohet në disa kategori monumentesh si: monumente arkitekturore (kala, banesa, hamame), monumente arkeologjike (vendbanime), monumente kulti të besimit të krishterë dhe atij mysliman (kisha, xhami, teqe), monumente historike (muze). Qarku i Elbasanit përbëhet nga 133 monumente kulture²³. Rrethi i Elbasanit ka në përbërjen e tij rreth 85 monumente kulture, ku përfshihen: kala, gërmadha antike, ura me vlera të spikatura kulturore, kisha, xhami, hamame, banesa, shtëpi muze, ndërtesa, muze etj. Rrethi i Librazhdit përfshin rreth 26 monumente kulture, ku spikasin: kala, rrënoja të urave antike, ura, banesa, kisha, shpella etj. Rrethi i Gramshit përfshin 15 monumente të shpallura kulturore, si: tuma, kala, ura, kisha etj. Rrethi i Peqinit përmban 5 monumente kulture, si: kala, rrënoja të urave antike, kulla²⁴.

Studimi ynë do të fokusohet kryesisht në disa prej objekteve kulturore më të rëndësishëm të Qarkut të Elbasanit. Objektet që do të trajtojmë janë: Kalaja e Elbasanit, Kisha e Shën Mërisë, Xhamia Mbret, Hamami i Pazarit, Kalaja e Peqinit, Kisha e Grabovës, Kisha e Shën Kollit, Ura e Kamarës, Gërmadhat antike në Bradashesh, Kisha e Shën Gjon Vladimirit.

21 Strategjia e Zhvillimit Rajonal Elbasan, Elbasan, fq 7.

22 Po aty, fq 8-9.

23 Referuar të dhënave nga Instituti i Monumenteve të Kulturës.

24 Po aty, IMK.

1.3 QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E STUDIMIT

Qëllimi i këtij studimi konsiston në ruajtjen, administrimin dhe pasurimin e mëtejshëm të vlerave që mbart trashëgimia kulturore në Qarkun e Elbasanit. Duke u nisur nga synimi i mësipërm, vëmendje do t'i kushtojmë në këtë studim dhe promovimit të trashëgimisë kulturore në Qarkun e Elbasanit. Ky studim, ndër të tjera synon dhe evidentimin e kontributit real që luan parimi i vullnetarizmit në ruajtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore. Për më tepër, do të shihet edhe ndikimi që koncepti i vullnetarizmit ushtron në zhvillimin ekonomik e më gjërë të Qarkut të Elbasanit. Njëkohësisht, vëmendje e posacme do t'i kushtohet dhe procesit të përballjes dhe përqasjes me legjislacionin aktual konkret në fushën e trashëgimisë kulturore. Në arritjen e këtij synimi, rëndësi paraqet edhe fakti i hartimit dhe përvijimit të strategjisë së ruajtjes dhe pasurimit të trashëgimisë kulturore (në të gjithë treguesit përbërës të saj) në Qarkun e Elbasanit.

1.4 PYETJET KËRKIMORE

- Si ta kuptojmë konceptin e ruajtjes dhe pasurimit të vlerave që përmban trashëgimia kulturore?
- Si pjesë e kësaj trashëgimie, a do të shihen dhe burimet natyrore?
- Koncepti i ruajtjes dhe pasurimit të trashëgimisë kulturore a do të shihet në koherencë të plotë me krijimin dhe përvijimin e një strategjie që synon zhvillimin e qëndrueshëm në Qarkun e Elbasanit?
- A duhet parë me prioritet problemi i trashëgimisë kulturore në raport me lidhjet organike që shqetësojnë zhvillimet në Qarkun e Elbasanit?
- Pyetjet e natyrës kërkimore do të kontribuojnë në evidentimin e rëndësisë së jashtëzakonshme që ka zbatimi konkret i strategjisë për zhvillimin social-ekonomik dhe kulturor të Qarkut të Elbasanit.

Plani i mësipërm ka shërbyer si një referencë e rëndësishme për hartimin e një procesi anketimi me qytetarët e qytetit të Elbasanit.

1.5 ORGANIZIMI I STUDIMIT

Studimi “Përqasja e legjislacionit për trashëgiminë kulturore e natyrore dhe përvoja në Qarkun e Elbasanit” është konceptuar në pesë krerë, ku secili prej tyre trajton në mënyrë të veçantë çështje të veçanta në përmbushje të objektivave të studimit me synimin e realizimit të plotë të qëllimit të tij.

Në kreun e parë të punimit pasqyrohet koncepti i përgjithshëm dhe bashkëkohor i trashëgimisë kulturore si dhe përcaktimi juridik i tij bazuar në instrumenta ndërkombëtarë. Kjo është e përmbledhur në trajtën e një prezantimi të përgjithshëm në lidhje me problematikën që do të parashtrohet në këtë studim.

Më pas, në këtë kapitull parashtrohet problematika e zgjeruar në këtë studim, problemi që do të shtrohet si dhe referimi tek studimet e tjera të ngjashme në fushën e trashëgimisë kulturore. Më pas, vijohet me qëllimet dhe objektivat kryesore të këtij punimi dhe pyetjet kërkimore të adresuara.

Në kreun e dytë të punimit përshkruhet analiza dhe shqyrtimi i literaturës, ku pjesa e parë fokusohet kryesisht tek instrumentat ndërkombëtare në fushën e trashëgimisë kulturore, pjesa e dytë trajton në mënyrë të detajuar legjislacionin shqiptar në fushën e trashëgimisë kulturore dhe raporti i saj me instrumentat ndërkombëtarë. Pjesa e tretë e këtij kapitulli mbyllet me problematikat kryesore të trashëgimisë kulturore në Qarkun e Elbasanit si dhe me listimin e një sërë objektesh kryesore, më të rëndësishme në fushën e trashëgimisë kulturore të qarkut.

Në kapitullin e tretë përshkruhet metodologjia e punimit, e cila është përdorur për realizimin e tij. Metodot e përdorura në këtë studim janë metodat sasiore dhe metodat cilësore. Metoda sasiore ka mundësuar grumbullimin e të dhënave përmes anketës gjysmë të strukturuar, të plotësuar nga popullata e përzgjedhur. Metoda cilësore ka mundësuar mbledhjen e të dhënave përmes intervistave të thelluara me specialistë të ndryshëm në qark, në fushën e trashëgimisë kulturore. Kapitulli mbyllet me analizën e të dhënave të marra nga metodat e përdorura në këtë studim.

Në kreun e katërt pasqyrohen gjetjet kryesore të studimit, duke u fokusuar tek gjetja e parë (Krijimi i një Strategjie Rajonale të Trashëgimisë Kulturore) dhe gjetja e dytë (Zhvillimi i një këndvështrimi evropian për krijimin dhe përvijimin e një Plani Rajonal të Trashëgimisë Kulturore në Qarkun e Elbasanit).

Kreu i pestë përmbledh përfundimet dhe rekomandimet që dalin rreth çështjeve të trajtuara në studim.

Punimi mbyllet me listën e referencave dhe shtojcat përkatëse që janë përdorur në këtë studim.

Duke marrë në konsideratë trashëgiminë kulturore gjeografike mjaft të pasur në Qarkun e Elbasanit si dhe vlerat e saj historike, kulturore, arkeologjike që ato përmbajnë, është e nevojshme që të paraqesim një analizë të detajuar të legjislacionit në lidhje me ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në Qarkun e Elbasanit.

Në çështjen e parë do të analizohen instrumentat ndërkombëtare në fushën e trashëgimisë kulturore, pjesë e të cilave është bërë dhe Shqipëria.

Në çështjen e dytë do të pasqyrohet legjislacioni shqiptar në fushën e trashëgimisë kulturore dhe raporti i saj me të drejtën ndërkombëtare.

Në çështjen e tretë do të trajtohen institucionet përgjegjëse për menaxhimin e trashëgimisë kulturore në Qarkun e Elbasanit.

Në çështjen e katërt do të trajtohen problematikat kryesore të trashëgimisë kulturore në Qarkun e Elbasanit dhe disa nga objektet kulturore më të rëndësishme të tij.

2.1 INSTRUMENTAT NDËRKOMBËTARE PËR TRASHËGIMINË KULTURORE

Vendi ynë disponon një trashëgimi mjaft të pasur kulturore me vlera të spikatura ndërkombëtare. Shqipëria është bërë pjesë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Edukimin, Shkencën dhe Kulturën (UNESCO) në vitin 1958²⁵. UNESCO është dokumenti me vlera të larta juridike në fushat e kulturës, komunikimit, garantimit të të drejtave në arsimim, në shkencat shoqërore e njerëzore²⁶. Qëllimi strategjik i UNESCO-s është që si agjenci e specializuar e Kombeve të Bashkuara, ndihmon për ndërtimin e paqes, zhdukjen e varfërisë, zhvillimin e qëndrueshëm e dialogun ndërkulturor, nëpërmjet arsimit, shkencave, kulturës, komunikimit dhe informimit. Në drejtimin e vet strategjik, UNESCO qëndron e palëkundshme në kërkim të ndërtimit të një kulture të paqes si dhe të zhvillimit e të thellimit të mirëkuptimit të ndërsjellë, pajtimit e dialogut. UNESCO-ja mbështetet në një platformë ku sfidat globale të njerëzimit

²⁵ shih whc.unesco.org

²⁶ po aty, www.unesco.org.review

trajtohen mbi bazën e barazisë ndërmjet shteteve anëtare. Duke patur në themel parimet e universalitetit, të diversitetit dhe të dinjitetit, veprimet e UNESCO-s vazhdojnë të udhëhiqen nga bashkësi vlerash të ndara, të cilat ngërthejnë drejtësinë, solidaritetin, tolerancën, barazinë, respektimin e të drejtave të njeriut, përfshirë të drejtat e grave si dhe larminë kulturore, pluralizmin dhe parimet demokratike. Butrinti, Gjirokastra, Berati dhe së fundmi liqenet e Ohrit dhe Prespës janë ndër pasuritë kulturore mijërvjeçare të vendit tonë që janë tashmë në mbrojtje të UNESCO-s. Angazhimi për mbrojtjen e vlerave dhe pasurive që këto destinacione paraqesin, kanë bërë që të pranohen në listën e trashëgimisë kulturore botërore pranë kësaj organizate²⁷.

Shqipëria ka nënshkruar një sërë Konventash ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore. Konventa “Për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Natyrore Botërore” është miratuar nga Organizata e UNESCO-s më 16 Nëntor 1972²⁸. Shqipëria e ka ratifikuar këtë konventë më 10 korrik 1989. Qëllimi kryesor i kësaj konvente mbetet mbrojtja dhe ruajtja e përbashkët e vlerave të trashëgimisë kulturore e natyrore botërore²⁹. Një vënd i veçantë në këtë konventë i kushtohet mbrojtjes ligjore dhe praktike të trashëgimisë kulturore e natyrore. Konventa i këshillon të gjitha shtetet anëtare për përpjekje me të gjitha mjetet e mundshme për vlerësimin dhe informimin e popujve për trashëgiminë kulturore e natyrore³⁰. Sipas Konventës³¹, trashëgimia kulturore përfshin monumente, grupe ndërtesash apo sitesh që përcaktohen si më poshtë:

- **monumente:** vepra arkitektonike, vepra monumentale të skulpturës dhe pikturës, elemente apo struktura të natyrës arkeologjike, mbishkrime, banesa në shpella dhe kombinime elementësh të cilat janë më vlerë të jashtëzakonshme universale në aspektin historik, artistik, apo shkencor;
- **grupe ndërtesash:** grupe ndërtesash të ndara ose të lidhura, që për shkak të arkitekturës, homogjenitetit, apo pozitës së tyre, kanë vlerë të jashtëzakonshme universale në aspektin historik, artistik, ose shkencor;
- **sitet:** vepra të krijuara nga njeriu apo vepra të ndërthurura përmes aktivitetit natyror dhe njerëzor, dhe zona që përfshijnë vende arkeologjike që kanë një vlerë të jashtëzakonshme universale në aspektin historik, estetik, etnologjik apo antropologjik.

²⁷ www.ata.gov.al

²⁸ “Protection of the world cultural and natural heritage”, Unesco 1972.

²⁹ Shih Preambulen e Konventës “Për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Natyrore Botërore”, F 1.

³⁰ Shih Nenin 3 Të Konventës së mësipërme.

³¹ Neni 1 i Konventës “Për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore Natyrore Botërore”.

Një tjetër dokument me rëndësi të veçantë është edhe Konventa "Për Mbrojtjen e Pasurive Kulturore në Rastet e Konfliktëve të Armatosura"³², e cila është nënshkruar në Hollandë, më 14 Maj 1954, ndërsa Shqipëria e ka ratifikuar atë më 1 Prill 1961. Konventa gëzon një rëndësi të madhe në mbrojtjen masive të trashëgimisë kulturore në rastet e konfliktëve të armatosura. Ajo përbën përpjekjen e parë në fushën e mbrojtjes ndërkombëtare të trashëgimisë kulturore.

Në vitin 2000 është miratuar një tjetër dokument me rëndësi të lartë juridike, në Firence nga Këshilli i Europës³³. Ky dokument njihet si Konventa "Për Mbrojtjen e Peisazhit European". Kjo Konventë nxit mbrojtjen, menaxhimin, planifikimin e peisazheve si dhe bashkëpunimin në nivel european, rajonal, si një element shumë i rëndësishëm i cilësisë së jetës së popullsisë³⁴. Kjo Konventë na paraqet një përkufizim të qartë për të gjitha format dhe dimensionet e peisazhit, si atë fizik, kulturor, natyror, etj. Një element thelbësor i kësaj Konvente mbetet njësimi i trashëgimisë kulturore e natyrore në peisazh, duke tejkaluar ndarjen e të dy kategorive përkatëse³⁵.

Një tjetër dokument me rëndësi strategjike përbën Karta Europiane e Trashëgimisë Arkitekturale, miratuar më 1975 nga Këshilli i Europës. Ky dokument mbart një rëndësi të lartë juridike në lidhje me parimet kryesore të ruajtjes së trashëgimisë kulturore³⁶. Sipas Konventës, ruajtja e integruar e trashëgimisë kulturore është tipari kryesor i planifikimit hapësinor dhe urban³⁷.

Në dokumentat e tjera të njohura ndërkombëtarisht si, Konventa për Mbrojtjen e Trashëgimisë Arkitektonike të Europës³⁸ më 1958 si dhe Konventa Europiane për Mbrojtjen e Trashëgimisë Arkeologjike³⁹ 1992, koncepti i "ruajtjes së integruar" të trashëgimisë kulturore është zhvilluar së tepërmi. Ky evolucion është zhvilluar paralelisht me zgjerimin e konceptit të trashëgimisë kulturore, duke përfshirë shumë kategori burimesh⁴⁰. Të gjithë këto instrumenta konfirmojnë qartazi ruajtjen e trashëgimisë arkeologjike europiane, jo vetëm nga vëndet që janë drejtpërdrejtë të interesuara, por edhe nga të gjithë

32 "The Convention of the Protection of Cultural Property in the Event of Armed Conflict", Hagë, 1954.

33 Shiko Konventën Europiane të Peisazheve, KE, 2000.

34 Po aty, neni 3 i Konventës.

35 Po aty, neni 4.

36 Convention for the Protection of the Architectural Heritage of Europe http://www.coe.int/t/dg4/cultureheritage/heritage/Archeologie/default_en.asp

37 po aty, Convention for the Protection of the Architectural Heritage of Europe http://www.coe.int/t/dg4/cultureheritage/heritage/Archeologie/default_en.asp

38 Konventa e Keshillit të Europës për mbrojtjen e trashëgimisë arkitekturale europiane, Granada, 1985, fq 87.

39 Konventa e Keshillit të Europës për mbrojtjen e trashëgimisë arkeologjike, Valetta 1992, fq 78.

40 Shiko "Trashëgimia Europiane"-Një Strategji e qëndrueshme për zhvillimin e Europës Jug-Lindore, KE, Strasburg 2008.

shtetet europiane për të parandaluar rrezikun e shkatërrimit të objekteve të trashëgimisë kulturore⁴¹.

Shqipëria ka ratifikuar Konventën e UNESCO-s “Për Mbrojtjen e Trashëgimisë Nënujore”, më 19 Qershor 2009, Paris⁴². Kjo Konventë përcakton parimet kryesore në fushën e mbrojtjes së trashëgimisë nënujore, nxit shtetet anëtare që të mos e shfrytëzojnë këtë pasuri për arsye tregtimi⁴³. Ky dokument u krijon mundësinë shteteve anëtare që të mbrojnë në mënyrën më të mirë të mundshme trashëgiminë nënujore.

Një tjetër Konventë e ratifikuar nga vëndi ynë është Konventa “Për Mjetet e Ndalimit dhe Parandalimit të Importit, Eksportit dhe Transferimit të Paligjshëm të Pronësisë së Pasurisë Kulturore”, e cila është nënshkruar nga Konferenca e Përgjithshme e Organizatës Kulturore, Arsimore, Shkencore të Kombeve të Bashkuara (UNESCO), më 14 Nëntor 1970⁴⁴. Shqipëria e ka miratuar këtë konventë më 9 Shtator 1999⁴⁵. Kjo Konventë nxit shtetet anëtare që të mbrojnë pasuritë e tyre ekzistuese brënda territorit kundër rreziqeve të ndryshme që kanë të bëjnë me gërmimet klandestine dhe eksportet e paligjshme⁴⁶. Sipas Konventës, importi, eksporti dhe kalimi i paligjshëm i pronësisë së pasurisë kulturore përbën një nga shkaqet kryesore të varfërimit të trashëgimisë kulturore dhe për këtë arsye është i nevojshëm bashkëpunimi i vazhdueshëm midis shteteve për mbrojtjen e pasurive të pronësisë kulturore⁴⁷.

2.2 LEGJISLACIONI KOMBËTAR PËR TRASHËGIMINË KULTURORE

Në përputhje me legjislacionin ndërkombëtar dhe detyrime që rrjedhin prej tij, adresuar shteteve anëtare, Shqipëria ka hartuar legjislacionin e saj përkatës në fushën e trashëgimisë kulturore. Të gjithë instrumentat ndërkombëtarë që përmendëm më sipër janë ratifikuar nga vëndi ynë dhe janë botuar në Fletoren Zyrtare⁴⁸. Në vijim, do të trajtojmë disa nga ligjet dhe aktet nënligjore në fushën e trashëgimisë kulturore në vëndin tonë.

41 Shiko Preambula e Konventës “Për Mbrojtjen e Trashëgimisë Arkeologjike”, fq 1.

42 Ligji Nr. 10027, datë 11.12.2008.

43 www.unesdoc.unesco.org.

44 www.unesco.org.

45 Ligji Nr.8523, datë 9.9.1999.

46 Shiko Preamblën e Konventës “Për Mjetet e ndalimit dhe Parandalimit të Importit, Eksportit dhe Transferimit të Paligjshëm të Pronësisë së Pasurisë Kulturore”.

47 Neni 2 i Konventës “Për Mjetet e ndalimit dhe Parandalimit të Importit, Eksportit dhe Transferimit të Paligjshëm të Pronësisë së Pasurisë Kulturore”.

48 Shiko www.qbz.gov.al.

Akti i parë ligjor në fushën e trashëgimisë kulturore shqiptare është *"Rregullorja e brendshme për rregullimin e muzeut mbretëror"*⁴⁹. Ky akt i përket kohës së Perandorisë Osmane, të vitit 1889, që i siguroi trashëgimisë mijërvjeçare shqiptare mbijetesën e vet. Ky ishte hapi i parë juridik i sanksionimit të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore shqiptare⁵⁰.

Periudha para Luftës së Parë Botërore, pak kohë para shpalljes së Pavarësisë, karakterizohej nga një sërë dokumentash me rëndësi juridike të lartë në fushën e trashëgimisë kulturore. Kështu, në vitin 1912 miratohet ligji *"Për Mbrojtjen e Monumenteve"*⁵¹. Ky akt riafirmoi mbrojtjen e vlerave të veçanta që mbartin objektet e trashëgimisë sonë kulturore.

Disa vite më vonë, konkretisht, në vitin 1922, del e para qarkore e Ministrisë së Arsimit lidhur me *ruajtjen dhe mbrojtjen e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme*, e cila pasohet më 1929 me dekret ligjin për monumentet kombëtare. Ky dekret ligj njihet si ligji i parë i vlerave të trashëgimisë historike e kulturore në Shqipëri. Në këtë dokument Ministria e Arsimit u ngarkua me përgjegjësinë për ruajtjen e monumenteve me vlera të konsiderueshme historiko-kulturore⁵².

Pas Luftës së Dytë Botërore, Shqipëria ishte privuar nga një lëgjislation për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe si rrjedhojë nuk ekzistonin strukturat përkatëse në mbrojtje të saj⁵³.

Më 17.03.1948, del dekreti Nr. 568 *"Mbi mbrojtjen e monumenteve të kulturës dhe sendeve të rralla"*⁵⁴. Ky dokument pati një rëndësi të madhe për kohën pasi mori në mbrojtje të gjitha monumentet e luajtshme dhe të paluajtshme me vlera të veçanta.

Në vitin 1974 shpallet Vendimi Nr.229 i Këshillit të Ministrave *"Mbi gjurmimin dhe vënien nën mbrojtje të ndërtimeve popullore"*.⁵⁵ Ky vendim pati tepër rëndësi për kohën pasi u hapi rrugë disa urdhrave për mbrojtjen nga shteti të shumë monumenteve kulturore.

Pavarësisht faktit të sanksionimit të këtyre akteve ligjore me rëndësi të lartë juridike në fushën e trashëgimisë kulturore, legjislacioni përkatës pas Luftës së Dytë Botërore nuk paraqitet i plotë dhe nuk arrin ti përshtatet problematikave

49 Fondi Nr 13 i Këshillit të Ministrave, Arkivi Qëndror i Shtetit, 1889.

50 Fondi Nr 13 i Këshillit të Ministrave, AQSH.

51 Fondi i Këshillit të Ministrave, Arkivi i Shtetit, 1912.

52 Shiko Dekret-Ligjin "Për mbrojtjen e monumenteve kombëtare", 28.05.1929.

53 Trashëgimia Kulturore: akte ligjore dhe nënligjore. Ministria e Kulturës, Rinisë, Sporteve. Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore, Tiranë 2003.

54 Neni Nr 1 i Dekretit "Të gjitha monumentet e luajtshme dhe të pa luajtshme kulturore dhe historike, artistike dhe etnografike, si dhe sendet natyrore të rralla me karakter botanik, gjeologjik, paleontologjik, minerallogjik, petro- grafik dhe gjeografik, ose me bukuri të veçantë, vihen nën mbrojtje të Shtetit pa marrë parasysh se kush i ka në pronësi ose në posedim. Vlehtë shkencore dhe estetike e këtyre sendeve është pasuri e përbashkët e popullit."

55 Fondi Nr 15 i Këshillit të Ministrave, 1974, Arkivi Qëndror i Shtetit.

që ekzistonin në fushën e trashëgimisë sonë kulturore. Megjithëse përpjekjet ishin maksimale në kuadër të mbrojtjes së objekteve të trashëgimisë sonë kulturore, kushtet politike të Shqipërisë nuk lejuan plotësisht përfshirjen e tyre.

Dokumenti bazik ligjor në fushën e trashëgimisë kulturore mbetet Ligji nr. 7867 datë 12.10.1994 *“Për mbrojtjen e pasurisë kulturore të luajtshme e të paluajtshme”*⁵⁶, pas ndryshimeve demokratike, ndonëse bënte fjalë për mbrojtjen e pasurisë kulturore materiale dhe jo shpirtërore.

Ndërkohë, ligji më organik në fushën e trashëgimisë kulturore është Ligji nr 9048 datë 07.04.2003 *“Për trashëgiminë kulturore”* i ndryshuar⁵⁷. Ai njihet si ligji bazë i standardeve bashkëkohore, ligji organik më i kompletuar për ruajtjen, mbrojtjen dhe popullarizimin e trashëgimisë sonë popullore. Ky ligj ka 5 kapituj kryesorë ku secili përmban këto probleme:

Në pjesën e parë të ligjit *“Për trashëgiminë kulturore”* trajtohen dispozita të përgjithshme, duke i klasifikuar objektet e trashëgimisë kulturore materiale e shpirtërore mbi baza shkencore, tipologjike dhe kohore, duke pasqyruar njëherazi edhe kriteret e këtij vlerësimi. Këtu përcakton institucionet e ngarkuar për mbrojtjen dhe studimin e trashëgimisë kulturore që janë: Drejtoria e trashëgimisë kulturore në MTKRS, këshilli Kombëtar i Restaurimit (KKR), Këshilli Kombëtar i trashëgimisë shpirtërore, Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore, Instituti i Monumenteve të Kulturës etj. Në këtë ligj trajtohen çështjet e pronësisë, të regjistrimit dhe vlerësimit ku theksohet se shteti pavarësisht nga pronari është i detyruar t’i mbrojë këto vlera, duke kufizuar interesat e të gjithë shoqërisë për objektet me vlera unike që kanë rëndësi për kulturën kombëtare.

Në pjesën e dytë trajtohen saktë problemet të marrdhënieve juridike të këtyre vlerave me pronarin dhe shtetin lidhur me mbrojtjen, ruajtjen, regjistrimin, lëvizjen e tyre brenda e jashtë vendit.

Në pjesën e tretë të ligjit sanksionohen statuset e kategorive të ndryshme të trashëgimisë kulturore të paluajtshme, vënia nën mbrojtje, financimi i ndërhyrjeve restauruese, shfrytëzimi i objekteve për funksione të dobishme pa dëmtuar vlerat e tyre. Rëndësi i kushtohet gërmimeve arkeologjike dhe mbrojtjen e saj gjatë punimit.

Pjesa e katërt e ligjit trajton çështjet lidhur me kundravajtjen në raport me vlerat e trashëgimisë.

Pjesa e pestë dhe e fundit trajton dispozitat kalimtare dhe të fundit lidhur me problematikën e zbatimit të Ligjit dhe nxjerrjen e akteve të tjera nënligjore në shërbim të tij. Pjesë e këtij legjislacioni janë: Ligji nr. 8926 datë 22.07.2002

56 www.ligjet.com

57 www.ligjet.com

“Simbolet kombëtare”⁵⁸ dhe Ligji nr. 9386 datë 04.05.2005 “Për muzetë”⁵⁹.

Një tjetër ligj me rëndësi të lartë juridike në fushën e trashëgimisë materiale është Ligji Nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për Arkivat”⁶⁰, i cili ka si qëllim të mbrojë trashëgiminë dokumentare të vendit tonë.

Së fundmi, ligji Nr. 45, datë 28.04.2016 “Për Vullnetarizmin” tashmë i miratuar, përbën një rregullim të mirëfilltë ligjor të vullnetarizmit, me qëllim rritjen e angazhimit qytetar, dhe rritjes së pjesmarrjes së individëve për përmirësimin e cilësisë së jetës në komunitet si dhe, zhvillimi e vlerave të solidaritetit njerëzor⁶¹.

Interesi i të rinjve dhe qytetarëve është gjithmonë e më shumë në rritje sa i takon punës vullnetare dhe dëshirës për të qenë aktiv në komunitet dhe social në përditshmëri, por mungesën e një strategjie për vullnetarizmin dhe një kuadri ligjor rregullator në këtë aspekt e bën të vështirë për institucionet të hapin dyert për vullnetarët dhe gati të pamundur për qytetarët të tregohen vullnetarë ose të kryejnë punë vullnetare.

Ndër shtysat kryesore për të punuar me këtë ligj, përveç kërkesës së drejtpërdrejtë të të rinjve, ishin edhe benefitet, që sjell vullnetarizmi në shoqëri. Impakti që ka te vullnetarët drejtpërdrejtë, duke zhvilluar tek ata ndjenja humane dhe duke i bërë më të përgjegjshëm. Impakti që ka për shoqërinë në tërësi në aspektin social dhe në zhvillimin e demokracisë dhe impakti pozitiv që krijohet në ekonominë e vendit është tashmë gjerësisht i provuar.

Gjithashtu, Bashkimi Evropian rekomandon formalizimin e punës vullnetare si një mundësi për të nxitur një shoqëri aktive, për të shtuar solidaritetin në komunitet dhe njëkohësisht për të rritur kapacitetet personale të individit⁶².

Aktet nënligjore kryesore për trashëgiminë kulturore

Bazuar në Ligjin nr.9048, datë 04.07.2003 “Për trashëgiminë kulturore” i ndryshuar⁶³, kanë dalë akte nënligjore për trashëgiminë materiale si më poshtë:

Urdhëri i Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, bazuar në Ligjin Nr. 9048, Datë 09.04.2003 “Për Trashëgiminë Kulturore” shpalli ditën ndërkombëtare të trashëgimisë kulturore⁶⁴. 29 shtatori është caktuar si dita kombëtare e trashëgimisë kulturore. Në këtë ditë të rëndësishme përkujtohet me respekt trashëgimia kombëtare shqiptare, pjesë e trashëgimisë europiane. Në vitin

58 www.ligjet.com.

59 www.ligjet.com.

60 www.ligjet.com.

61 Neni 2 I Ligjit Nr 45, datë 28.04.2016 “Për Vullnetarizmin”, Fletore Zyrtare Nr 92, faqe 5219.

62 www.europa.eu.

63 Ligji është azhurnuar me ligjet: Ligji 9592, datë 27.7.2006 dhe Ligji Nr. 9882, datë 28.02.2008.

64 Shiko Nenin 5, pika 2 e Ligjit Nr.9048, dt 09.04.2003 “Për Trashëgiminë Kulturore”.

2004, më 29 shtator filloi startin Festivali Folklorik i Gjirokastrës. Kjo ngjarje mbart vlera të identitetit tonë kulturor kombëtar dhe bazohet në trashëgiminë europiane të përbashkët⁶⁵.

Një akt tjetër nënligjor është katalogizimi nga Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore të objekteve të trashëgimisë në administrim të institucionet kombëtare dhe të atyre të pushtetit vendor⁶⁶, rreth 30 mijë objekte. Qendra ka miratuar kartelat tip të regjistrimit dhe pasaportën tip për çdo objekt që regjistrohet. Në QKIPF po krijohet database e gjithë trashëgimisë kulturore shqiptare.

Me një vendim të posaçëm të Këshillit të Ministrave në vitin 2003 është ngritur Komisioni i Përhershëm i Vlerësimit të Objekteve të Trashëgimisë Kulturore pranë QKIPK për vlerësimin e objekteve të pronësisë private të luajtshme që kërkohet të nxirren jashtë territorit të RSH⁶⁷. Ministri i MTKRS cakton emrat e këtij komisioni.

Një akt tjetër i rëndësishëm në fushën e trashëgimisë kulturore ka përcaktuar qartë një institucion tepër të rëndësishëm, që njihet si Këshilli Kombëtar i Restaurimit⁶⁸. Ky organizëm i rëndësishëm përcakton se cilat objekte duhen restauruar dhe jep licensë për subjekte private që duan të merren me restaurimin⁶⁹.

Me një tjetër vendim të rëndësishëm të Këshillit të Ministrave të vitit 2007 janë përcaktuar procedurat e shitjes me ankand të objekteve të trashëgimisë kulturore me vlera të zakonshme⁷⁰.

Ndërkohë, disa vite më vonë, janë miratuar nga Këshilli i Ministrave rregulloret e parqeve arkeologjike, qyteteve historike etj dhe shpallja e Pallatit të Brigadave dhe të parkut të tij si asambël historik dhe zonë e stimuluar⁷¹.

Një rëndësi të madhe paraqet fakti se me vendim të posaçëm të Këshillit të Ministrave janë përcaktuar kundravajtjet administrative të cilat dënohen me gjobë nga strukturat e inspektorëve të gjobave⁷².

65 Urdhri i Ministrit “Për shpalljen e ditës ndërkombetare të trashëgimisë kulturore”.

66 Vendimi Nr.795, datë 26.11.2003 “Për ngritjen, përbërjen dhe mënyrën e funksionimit të Komisionit të Përhershëm të Vlerësimit të objekteve të Trashëgimisë Kulturore, në pronësi private, të luajtshme dhe për kriteret shkencore e procedura të vlerësimit të këtyre objekteve”.

67 Vendimi Nr.795, datë 26.11.2003 “Për ngritjen, përbërjen dhe mënyrën e funksionimit të Komisionit të Përhershëm të Vlerësimit të objekteve të Trashëgimisë Kulturore, në pronësi private, të luajtshme dhe për kriteret shkencore e procedura të vlerësimit të këtyre objekteve”.

68 www.imk.gov.al.

69 Për më tepër, shiko Urdhrin Nr 390, datë 13.10.2009 “Për miratimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar të Restaurimit”.

70 www.km.gov.al.

71 Shiko Vendimin Nr. 249, datë 30.04.2014.

72 Shiko Kreu IV, Neni 49 i Ligjit.

Si përfundim mund të themi se, pas viteve '90 në vëndin tonë legjislacioni kombëtar për trashëgiminë kulturore pësoi ndryshime rrënjësore drejt përmirësimit të vazhdueshëm. Legjislacioni kombëtar në këto vite u mbështet ngushtësisht në modelet që ofronin shtetet më të zhvilluara perëndimore në fushën e trashëgimisë kulturore. Një moment mjaft i rëndësishëm mbetet miratimi i ligjit për mbrojtjen e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme në vitin 1994, i cili trajtoi si pasuritë kulturore të paluajtshme, ashtu edhe ato të luajtshme. Në këtë akt ligjor mjaft të rëndësishëm, për herë të parë u bënë përpjekjet për heqjen e të drejtës ekskluzive që kishte shteti shqiptar për të kryer restaurimet e monumenteve të kulturës. Kjo e drejtë iu njoh dhe subjekteve privatë që interesoheshin në kuadër të mbrojtjes dhe restaurimit të monumenteve të kulturës.

2.3 INSTITUCIONET KRYESORE TË MENAXHIMIT TË TRASHËGIMISË KULTURORE NË QARKUN E ELBASANIT

Menaxhimi i trashëgimisë kulturore në përgjithësi në vëndin tonë, është i lidhur ngushtësisht me ratifikimin e instrumentave ndërkombëtare për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, si dhe me miratimin e legjislacionit kombëtar përkatës. Po ti referohemi Qarkut të Elbasanit, aktorët kryesorë të përfshirë në këtë proces janë të shumtë. Krahas institucioneve vendore, kemi dhe institucionet qendrore që kanë përgjegjësinë dhe detyrimin ligjor të menaxhimit të trashëgimisë kulturore. Vitet e fundit është vënë re në këtë drejtim, edhe aktivizimi i gjërë qytetar i shoqërisë civile në mbrojtje të vlerave të objekteve të trashëgimisë kulturore.

Institucionet qendrore njihen si organet kryesore në fushën e mbrojtjes dhe menaxhimit të trashëgimisë kulturore. Ministria e Kulturës njihet si institucioni kryesor në fushën e mbrojtjes të trashëgimisë kulturore të vëndit tonë⁷³. Ky institucion, në përputhje të plotë me drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore, ushtron veprimtarinë e saj në fushën e trashëgimisë kulturore, materiale dhe shpirtërore. Ajo është përgjegjëse për hartimin e strategjive të ndryshme, politikave dhe planeve në nivel kombëtar dhe vendor⁷⁴.

Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Durrës, Sektori Elbasan, është një tjetër institucion që merret me mirëmbajtjen, ruajtjen dhe administrimin e trashëgimisë kulturore në Qarkun e Elbasanit. Misioni kryesor i këtij institucioni mbetet kontrolli, ruajtja, administrimi dhe promovimi i objekteve të trashëgimisë kulturore në qark.

⁷³ www.kultura.gov.al

⁷⁴ po aty; www.kultura.gov.al

Muzeu etnografik u krijua më 1986 në Elbasan, pranë një shtëpie karakteristike me çardak, e cila është restauruar më tej. Ky muze përmban kuadrin historik, zejtarinë me shumë lloje zejesh, veshjesh, tipesh banesash qytetare karakteristike elbasanase në disa ambiente të ndryshme⁷⁵. Ky monument tradite u krijua në shtëpinë e Sejdinëve, shumë afër sheshit të Bezistanit.

Komunitetet lokale luajnë gjithashtu një rol shumë të rëndësishëm në ruajtjen dhe menaxhimin e trashëgimisë kulturore të Qarkut Elbasan. Megjithë përpjekjet e bëra në këtë drejtim, ende mbetet problematikë angazhimi i tyre në fushën e trashëgimisë kulturore⁷⁶. Ndonëse ndjehet ndërgjegjësimi i komunitetit në ruajtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore, vënia në zbatim mbetet mjaft e ulët.

2.4 PROBLEMATIKAT DHE SFIDAT AKTUALE TË TRASHËGIMISË KULTURORE NË QARKUN E ELBASANIT

Qarku i Elbasanit është i pasur me burime kulturore e territoriale që nxisin zhvillimin lokal të turizmit kulturor. Shumëllojshmëria e shprehjeve kulturore dhe trashëgimisë është një element shumë i rëndësishëm në këtë Qark. Për më tepër, gjeografia natyrore dhe kulturore ofrojnë një ekperiencë unike për turistët e vizitorët e ndryshëm. Por, në kuadër të problematikës që po përballlet në ditët e sotme trashëgimia kulturore e Shqipërisë dhe trashëgimia kulturore e Qarkut të Elbasanit nuk mund të përjashtohet nga problemet e shumta që kanë të bëjnë kryesisht me ruajtjen, menaxhimin dhe mbrojtjen e vlerave të çmuara të trashëgimisë kulturore⁷⁷. Kjo situatë në të cilën ndodhen objektet me vlerë në qark ka ardhur si pasojë direkte e neglizhencës njerëzore për sa i takon zbatimit me rigorozitet të ligjit themelor dhe akteve nënligjore që rrjedhin prej tij.

Në përputhje me pikëpamjet bashkëkohore të trashëgimisë kulturore në Botë dhe Europë, është e rëndësishme që institucionet e trashëgimisë kulturore të bashkive të Qarkut të Elbasanit të zbatojnë të gjithë legjislacionin e UNESCO-s dhe legjislacionin kombëtar shqiptar për Trashëgiminë Kulturore⁷⁸. Referuar procesit anketues me qytetarët në Qarkun e Elbasanit dhe analizës interpretative të akteve ligjore në fushën e trashëgimisë kulturore, disa nga problematikat, të cilat shtrojnë ndërhyrje të menjëhershme janë:

Mungesa e kujdesit për ruajtjen e monumenteve të kulturës në qark po sjell çdo ditë e më tepër degradimin gradual të trashëgimisë kulturore në Qarkun

75 Enciklopedia Elbasan, fq 386.

76 Referuar anketimeve të kryera me popullatën e vendosur pranë objekteve të trashëgimisë kulturore në Qarkun e Elbasanit.

77 Shiko Strategjinë Rajonale të Qarkut Elbasan 2012-2016, fq 10.

78 Ligji bazë “Për trashëgiminë kulturore”, datë 09.04.2003 i azhurnuar.

e Elbasanit. Vitet e fundit, Qarku i Elbasanit po përballlet me goditje nga më të ndryshmet si pasojë e rindërtimit, urbanizimit kaotik dhe të egër, zhvillimit të pakontrolluar, betonizimit duke dëmtuar vlerat e objekteve kulturore. Nga ana tjetër, në këtë qark vihet re mungesa e përkujdesjes së duhur institucionale në mbrojtje të vlerave kulturore të objekteve të trashëgimisë kulturore.

Fonde të pamjaftueshme të nevojshme për ruajtjen dhe restaurimin e objekteve të trashëgimisë kulturore kanë ndikuar në gjendjen mjaft të vështirë dhe të degraduar të monumenteve dhe objekteve të trashëgimisë kulturore në qark. Nëse do të analizojmë aspëktin e politikave publike në qark, sektori i kulturës dhe i trashëgimisë kulturore qëndrojnë shumë larg pozitës që duhet të kenë në mbrojtje të vlerave të trashëgimisë kulturore.

Mungesa e punës vullnetare në mbrojtje të objekteve të trashëgimisë kulturore vihet re në qark nëse do ti refoerohe mi pyetësoreve të realizuar në rrethet përkatëse. Një zgjidhje alternative ndaj situatës aktuale do të ishte propogandimi dhe shfrytëzimi i punës vullnetare në funksion të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore në Qarkun e Elbasanit.

Mungesa e një inventarizimi të plotë të objekteve me statusin e monumenteve të kulturës pengon krijimin e një Plani efikas për diversitetin e trashëgimisë kulturore në Qarkun e Elbasanit.

Mosruajtja e peisazhit në trevat e Qarkut të Elbasanit është një nga problematikat më të mëdha që përballlet trashëgimia kulturore. Duhet hartuar një kornizë e plotë ligjore dhe ekperimentale për një planifikim territorial në mënyrë të vazhdueshme⁷⁹.

2.5 OBJEKTET MË TË RËNDËSISHMË TË TRASHËGIMISË KULTURORE NË QARKUN E ELBASANIT

Në krahun e djathtë të derdhjes së lumit Shkumbin atje ku ai kryqëzohet me rrugën e famshme Egnatia shtrihet qyteti i Elbasanit me emrin e lashtë Skampis. Gjatë historisë së lashtë Elbasani e ndërroi shpesh emrin e tij, por për herë të parë e gjejmë të shkruar në dokumentat historike të shekullit të II-të si vicus me emrin Scampis në varësi të Dyrrahut⁸⁰. Scampisi ishte një kastium (kështjellë) tipike romake e ndërtuar në kapërcjellin e shek.III- IV e.s.

Fortesa rrethohej me mure të fuqishëm. Nga të katër anët një hendek i thellë me ujë dhe 26 kulla të formave të ndryshme (në formë U-je dhe patkoi) përforconin fuqinë mbrojtëse të saj. Kalaja kishte katër hyrje një për secilën anë.

79 Shiko Ligjin Nr. 8906. datë 6.6.2002 "Për Zonat e Mbrojtura".

80 Shiko Enciklopedinë e Qarkut Elbasan.

Në shek.VI qyteti zhvillohet jashtë kështjellës duke qenë qendër peshkopale me një katedrale dhe një bazilikë në kodrën e Tepes pranë Kalasë. Në vitin 1466 Kalaja e Elbasanit bie në duart e osmanëve, të cilët e rindërtuan thuajse tërësisht dhe prej tyre ai mori emrin Ilj-basan (Elbasan). Me këtë emër u bë qendër sanxhaku në shek.XVII-XVIII-të duke patur një zejtari tejet të zhvilluar dhe një tregti brenda dhe jashtë vendit. Në mes të shek. XVII-të ai numëronte 900 dyqane, 2.000 shtëpi banimi. Zejet më të dëgjura ishin regjia e lëkurave (tabakët), punimi i mëndafshit dhe i argjendit (zbukurime dhe armë). Brenda qytetit përveç banesave dhe dyqaneve Elbasani përmbante tashmë një numër të madh ndërtesash kulti si: kisha, manastire, xhami, dhe hamame (banja publike).

Rrapi i Bezistanit⁸¹

Ndodhet në qendër të qytetit. Emërtimi i tij lidhet me tregun e mbyllur, i quajtur bezistan, bërthamë e rëndësishme tregtare, ndërtuar në shek. XVII, që përfshinte një numër të konsiderueshëm dyqanesh. Historikisht ka shërbyer si pikë referimi për ngjarjet historike, arsimore e kulturore të Elbasanit. Të gjitha këto janë pasqyrë e së kaluarës së tyre historike-shoqërore dhe thelbi i ndërgjegjes qytetare për të sotmen dhe të ardhmen e zhvillimit, në hapësirën kombëtare.⁸²

Rrapi i Vojvodës

Rrapi 700 vjeçar, i shpallur “monument kulture” dhe i pagëzuar me emrin Vojvoda⁸³, ndodhet në të dalë të qytetit, në pjesën lindore të tij. Komandanti ushtarak, mëkëmbës në perandorinë Osmane, Vojvoda, në kohën e lirë qetësohej dhe pushonte pikërisht tek ky rrap, prandaj dhe ka marrë emrin e tij, thonë gojëdhënat në qytet. Rrapi shërbente gjithashtu edhe si pikë takimi e drejtimi për karvanët që vinin nga vise të ndryshme të perandorisë osmane. Rrapi ka një pamje madhështore.

Sipas gojëdhënave ai duhet të jetë 700 vjeçar, por mund të jetë edhe më shumë se kaq. Edhe pse për disa vite ai u la në harresë dhe asnjë nuk kujdesej për të, vitet e fundit rrap i sërish mori pamjen e dikurshme. Ish-kryetari i bashkisë, Ardian Turku, rrethoi rrapin, për ta ruajtur atë nga dëmtimet dhe për të ruajtur vlerat që ai ka pasur.

Shumë poezi janë shkruar e shumë këngë i janë kënduar këtij rrap nga këngëtarë të njohur elbasanas. Rrëzë tij ndodhej edhe një çezmë me ujë të ftohtë, e cila ka ekzistuar deri para vitit 1990, që shërbente për shumë kalimtarë nga

81 Strategjia e Zhvillimit Rajonal Elbasan.

82 https://sq.wikipedia.org/wiki/Turizmi_n%C3%AB_Elbasan.

83 https://sq.wikipedia.org/wiki/Turizmi_n%C3%AB_Elbasan#Rrapi_i_Vojvod.C3.ABs.

rrethe të tjera si Korça, Erseka, apo edhe nga Tirana, të cilët ndalonin pikërisht këtu për të pirë ujë tek çezma e rrapit.

Por mbasi u shpall monument kulture mbas viteve 1990 çezma u prish, por edhe pa të bukuria e rrapit vazhdon të jetë tepër fisnike dhe madhështore. Shumë të rinj e të reja lenë takimin pikërisht pranë rrapit, për të shkuar më pas në parkun “Rinia”, i cili ndodhet përballë tij. Ky rrap me emrin Vojvodë, pret çdo ditë me qindra qytetarë, të cilët kohët e fundit edhe kujdesen për të.

Kështjella Skampis

Qyteti i Elbasanit ka kështjellën Skampis⁸⁴. Ajo përfaqëson një Castrum Statum, qendër e një legjioni romak. Si të gjitha kampet ushtarake romake edhe ky është ndërtuar sipas një plani orthogonal, i përcaktuar nga kryqëzimi në kënd të drejtë i dy rrugëve: Decumanus në drejtimin Perëndim-Lindje dhe Cardo në drejtimin Veri-Jug⁸⁵. Kjo gjë ka përcaktuar dhe planimetrinë e saj. Kështjella ka formën e një katërkëndëshi kënddrejtë në përmasa 308x348 m drejtuar në anët më të ngushta në drejtim Verilindje-Jugperëndim. Është e qarkuar nga një hendek 3 m i thellë që mbushej me ujë nga përroi i Zaranikës. Ajo ka 4 hyrje që ndodhen në mes të çdo kurtine të cilat mbrohen nga kulla. Kështjella është e pajisur me 26 kulla. Në katër qoshet e saj ndodhen kulla në formë freskoreje. Dy të tjera janë kulla hyrje dhe ndodhen në pjesën fundore të rrugës Cardo. Ato kanë planimetri katërkëndëshe ndërsa njëzet të tjerat kanë formën e shkronjës U⁸⁶. Kullat janë plotësisht të dala jashtë murit rrethues, vetëm katër prej tyre që mbrojnë hyrjet e rrugës Decumanus dalin përgjysmë jashtë murit rrethues. Të gjitha kullat e kështjellës pavarësisht nga forma e tyre dalin 8-9 m larg murit dhe gjenden 40-50 m larg njëra-tjetrës⁸⁷. Përbërja e murit rrethues tregon për tri periudha kryesore ndërtimi, që janë:

- Periudha e vonë romake;
- Periudha e hershme bizantine;
- Periudha osmane.

Muri i periudhës së vonë romake gjendet kudo në nivelin e poshtëm të kështjellës dhe përshkon gjithë planimetrinë e saj. Ngrihet mbi themelin e kështjellës dhe ruhet në lartësinë maksimale deri në 5 m⁸⁸. Trashësia e murit

84 Trashëgimia Kulturore e Qarkut Elbasan. Dokumente të marra nga Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Durrës, Sektori Elbasan.

85 Cerova. Y, “Castrum Scampis” Iliria 1-2: Tiranë 1997, fq. 287.

86 Cerova. Y, “Castrum Scampis” Iliria 1-2, Tiranë 1997, fq. 288.

87 Cerova. Y, po aty, fq. 287.

88 Cerova. Y, “Castrum Scampis” Iliria 1-2, Tiranë 1997, fq. 288.

rrethues është 3 m. Ndërtimet e realizuara në teknikën e njohur opus mixstum, përdorimi i brezit të tullave shërben si një lidhje e vërtetë ndërmjet dy faqeve të murit dhe bërthamës. Midis këtyre tri elementëve të ndryshëm sigurohet një lidhje e qëndrueshme.

Mendohet se lartësia e plotë e murit rrethues deri në shtegun e rojes ka qenë rreth 9 m. Pjesa e sipërme ka qenë e pajisur me shtegun e rojes, me një platformë të qarkullimit, vëzhgimit, mbrojtjes dhe me një parapet. Ky i fundit e ka trashësinë rreth 0,70 m dhe përbëhet nga gjoksmburoja dhe hapësira goditëse. Lartësia e parapetit varet nga këndi i goditjes dhe me ndërtimet romake ai ka qenë rreth 2 m.

Me krijimin e sistemit të ri administrativ dhe ushtarak bizantin, një pjesë e mirë e territoreve që ishin pranë qytetit Skampis dhe rrugës Egnatia përfshihen në themën e Durrësit. Këto territore u përfshinë në organizimin e ri administrativ kishtar dhe u përkisnin peshkopatave të Durrësit, Kunavisë-Kandavisë, Cernikos-Cermenikës. Materiali arkeologjik i zbuluar në kështjellën e Skampis për periudhat e shek VII-XV dëshmon për një rënie të theksuar të jetës në shekujt e parë dhe një rigjallërim i saj deri në prag të pushtimit osman. Në këtë periudhë, në këtë rajon ndeshen rrënoja të shumta të monumenteve kristiane në zonën e Shpatit, Çermenikës, Kërrabës, Dumresë e Sulovës. Të dhënat dhe analiza në lidhje me të gjitha fortifikimet në Gadishullin e Ballkanit dhe më gjerë përcaktojnë që kështjella e Skampisit është ndërtuar në kohën e perandorit romak Diklecian në v. 284-305 e.s. Studimet arkeologjike dëshmojnë për një ndërprerje të jetës në këtë qendër pas betejës së Adrianopolit në v.378 dhe dyndjes së fiseve vizigote drejt pjesës perëndimore të Gadishullit Ballkanik.

Pas kalimit të vizigotëve me Alarikun në krye për në gadishullin Apenin situata u rivendos dhe jeta vazhdoi normalisht deri në dyndjen tjetër të fiseve ostrogote pas gjysmës së parë të shek. V. Gjatë periudhës ndërmjet dy dyndjeve të njëpasnjëshme të fiseve gote mendohet se Skampisi si rezultat i zhvillimit ekonomik që bazohej në stabilitetin e Perandorisë Romake, u shndërrua në një qytet dhe u bë njëkohësisht qendër e rëndësishme ekonomike dhe qendër peshkopale. Në kohën e sundimit të perandorëve Anastas dhe Justiniani i parë, ka një stabilitet të jetës në krahinë. Pothuajse është vendosur siguria, ndihet një rritje ekonomike, e cila shihet në marrëdhëniet tregtare në këtë periudhë me Mesdheun Lindor dhe më pak me Afrikën Veriore.

Kështjella Skampis duhet të ketë qenë mjaft e dëmtuar në kohën e perandorit Justinian (527-565) kur ajo rindërtohet për faktin që Pokopi i Çezaresë cilësohet si ndërtim i mirëfillt⁸⁹. Në këtë kohë Kështjella ka pësuar riparime me karakter

89 Cerova. Y, "Castrum Scampis "Iliria 1-2, Tiranë 1997, fq. 289.

të përgjithshëm që vihen re edhe fundshekullin XX në disa trakte muresh. Gërmimet arkeologjike të kryera në territorin e saj nxorren në dritë pjesën veriore të atriumit të një bazilike të epokës paleokristiane. Mbi dyshtemenë e atriumit u gjetën disa elementë arkitektonikë paleokristianë. Zhvillimi i jetës në qytetin e Skampis dhe në zonën rreth tij do të pësojë një goditje të fortë në fillim të shekullit të VII në kohën e dyndjeve të tjera, kësaj radhe nga avarosllavët. Kalaja përfaqëson një kastrum klasik, e cila i përmbahet rreptësisht rregullave të ndërtimit romak. Edhe pse një tip i tillë ndërtimi i takon periudhës romake të ndërtimeve, vetë romakët një model të tillë e huazuan nga ndërtimet Epirotase. Këtë e vërtetojmë nga shkrimi i një strategu të shek. I i cili shprehet se "... qëmoti romakët e ngrinin kampin thuajse të shpërndarë... si shtinë në dorë kampin e Pirros panë vendosjen e tij dhe pak nga pak arritën në atë që është sot në përdorim"⁹⁰. Madje dhe Livi e vërteton një gjë të tillë kur shprehet se Pirroja "ish i pari që mësoi të tjerët si të vendosnin kampin". Interesante janë dhe intineraret apo shënimet e mbajtura nga kalimtarë të ndryshëm që kanë kaluar nëpër Scampis-in antik duke na informuar mbi ekzistencën e kësaj qendër të hershme historike. Të tilla përmendim intineraret e ndryshme mbi Via Egnatian. Në shek III-IV, nëpërmejt këtyre intinerareve dëshmohej lashtësia e kësaj qendre, e cila ishte shumë e lidhur dhe me Via Egnatian. Në Intinerarin e Antoninit përmendet dy herë në formën *Scampis*, sikundër edhe në tabelën e Peutingerit, ndërsa në intinerarin e Bordosë citohet si *mansio Hiscampis*⁹¹. Nga fundi i shekullit të IV e fillimi i shekullit të V shkrimtari Vegeti në veprën e tij "Lista e Rangjeve" (Notia Dignitatum) përmend **peudocomitatenses** Scampensen (Ushtritë pseudolëvizëse) nga Skampis-i, Skampis, që ishin në dispozicion të magistër Militin për Ilirikun.⁹² Skampis do të përmendet gjatë shekullit të V dy herë në burimet e shkruara: në vitin 458 mund të themi se Skampis të ketë qenë një qëndër peshkopale, kjo për faktin se Artemi peshkop i Skampis-it citohet sëbashku me peshkopë të tjerë të Epirit të Ri.⁹³ Ndërsa në vitin 459 gotët me në krye Teodorikun, duke qenë se ky i fundit nuk arriti dot të pushtonte Lihnidin (Ohrin), vazhdoi rrugën gjatë Via Egnatias dhe pushtoi Skampis-in, të cilët banorët e kishin braktisur me kohë. Më pas prej këtej ai pushtoi edhe Epidamnin.⁹⁴ Rreth Skampis-it të dhënat e fundit i përkasin shekullit të VI, periudhës së sundimit të perandor Justinian I. Skampisi figuron si një qytet, krahas qyteteve të tjera të Epirit të Ri sipas Hieroklit, ndërsa në listën e Prokopit të Cezaresë konsiderohet si një nga

90 Cerova, Y; Castrum Skampis, 1997, fq 285.

91 Cerova, Y, "Castrum Scampis "Iliria1-2; Tiranë 1997: fq. 285.

92 Demiri, Sh, "Histori e shkurtër e trevës së Elbasanit": Tiranë 2006; fq. 20.

93 Cerova, Y, "Castrum Scampis "Iliria1-2; Tiranë 1997, fq. 285.

94 Demiri, Sh, "Histori e shkurtër e trevës së Elbasanit", Tiranë 2006, fq. 23.

kështjellat e rindërtuar. Tashmë qyteti mbrohej nga një linjë muresh. Dokumenti i fundit që flet për ekzistencën e Skampis-it është dokumenti i pranverës së vitit 519. Në qytet vjen një delegacion i papës së Romës dhe mban një kreshme në katedralen e Skampis-it. Gjurmë të mundshme të një kishe apo katedraleje të tillë janë gjendur brënda në kala, ku është sot shtëpia e Naim Cekës⁹⁵. Janë dy letra, të cilat përmendin peshkopin Trojus të Skampis për pritjen e ngrohtë që i bënë klerikët e qytetit të deleguarit të Papës Hormidas në katedralen e Shën Pjetrit.⁹⁶

Një përshkrim disi më të plotë për kalanë dhe qytetin e Elbasanit është udhëtari turk Evlija Çelebiu në shekullin e XVII. Të dhënat e tij për fat të keq nuk mund të meren të gjitha në konsideratë, për shkak të ekzagjerimit që i bën madhësisë dhe deformimit të trajtës së kalasë. I pari që bëri të mundur identifikimin dhe lidhjen e Elbasanit me Skampis-in antik është studiuesi austriak Hann duke u mbështetur në Tabelën e Peutingerit. Por ky studiues duke mos arritur të analizonte shtresa më të vjetra dhe duke mos arritur të dallonte fortifikimin antik që përmënd Prokopi i Cezaresë, e cilësoi atë gabimisht si një kala mesjetare⁹⁷.

Gjatë periudhës së luftës së dytë botërore kalaja e Elbasanit do bëhet objekt studimi më i plotë nga arkeologët austriak K. Prashniker dhe A. Schober. Me mundësitë që iu krijuan ata do ti kushtojnë kalasë një studim të veçantë, të detajuar ku na japin informata mbi planimetrinë, përshkrimin e monumentit si dhe na japin informacion mbi teknikat e ndërtimit që janë përdorur për ndërtimin e saj. Gjithashtu ata kanë publikuar dhe fragmente të ndryshme arkitektonike të kalasë si dhe janë të parët që evidentuan nën muret mesjetare substruksione të një periudhe më të hershme fortifikimi, që i përket kohës së vjetër antike.⁹⁸ Në bazë të analizave të hollësishme nga gjetjet arkeologjike, ata mendojnë se kalaja e Skampis-it i përket periudhës së vjetër antike të viteve 300-530 të erës sonë.⁹⁹

95 Demiri. Sh, po aty, fq. 23.

96 Cerova. Y, "Castrum Scampis "Iliria1-2: Tiranë 1997, fq. 286.

97 Karaiskaj. Gj, "Kalaja e Elbasanit "Monumentet1, Tiranë 1975, fq.61

98 Karaiskaj. Gj, po aty, fq 61.

99 Cerova. Y, "Castrum Scampis "Iliria1-2, Tiranë 1997, fq. 286.

*Guri i M.Sabitit datohet pas mesit të shekullit të II-të e.s (rreth v.180). Ai është gjendur në fonadamentin e Portës së jashtme të Kalasë, në anën juglindore, gjatë demolimit të saj në vitin 1922, pas tërmetit të madh të vitit 1920. Në përgjithësi monummenti epigrafik ruhet në një gjëndje të mirë. Madhësia e shkronjave të mbishkrimit nuk është e barabartë, ato zvogëlohen gradualisht. Mbishkrimi përbëhet prej 17 rrjeshtash. Emri i ushtarit përmendet në rrjeshtin e parë dhe të dytë. Për sa i përket shkrimit shkronjat që janë brënda kllapave kanë gërma të shtuara nga studiuesit:

Rrjeshtat e parë:

M (arce) Sabidi (o) M (atce)? F (ilio)

Asm (ilia) Ma (ximo) mil (iti) lag (ionio) XI

Një nga zbulimet më të rëndësishme për qytetin e Elbasanit për sa i përket datimit të ekzistencës së tij të hershme dhe zbardhjen e disa problemeve historike, mbetet pa dyshim guri me mbishkrimin e legjionarit M. Sabiti* i gjetur në vitin 1922. Në sajë të kësaj gjetjeje u vërtetua nga pikëpamja arkeologjike se studiuesi Hann kishte të drejtë për vendodhjen e Skampis-it. Nga mbishkrimi i këtij monumenti epigrafik mësojmë se Skampis-i ishte një *vicus* dhe ishte nën varësinë e Dyrrahut. Koha e datimit të mbishkrimit i takon shekullit të II.¹⁰⁰

Nekropoli i Skampis-it u zbulua në vitet e para pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore. Ai ndodhej në lindje të kalsë, në të dy anët e Via Egnatias me drejtim lindje-perëndim. Via Egnatia këtu arrin gjerësinë gati 11m sëbashku me gjerësinë e hendeqeve në dy anët e saj. Duke u bazuar në itinerarët që u gjenden në nekropol si dhe mënyrës së konstruksionit të varreve datohen në periudhën e antikitetit të vonë.¹⁰¹

Edhe inxhinier J. Adami është i mendimit se bërthama e qytetit të Elbasanit është brenda mureve të kalasë dhe ka arritur në këtë konkluzion gjatë gjurmimit të rrugëve antike në vitet 1948-49. Ka dhënë mendime dhe për sa i përket monumenteve arkeologjike që ishin pranë rrugëve. Ai jep dhe një përshkrim arkitekturor të kalasë duke dalluar në të faza të ndryshme ndërtimi dhe duke bërë edhe një krahasim të kalasë me kalatë brënda dhe jashtë vendit është i mendimit se koha e ndërtimit të kalasë i takon shekujve III-IV të erës sonë.¹⁰² Gjerak Karauskaj ka kryer një studim më të hollësishëm rreth kalasë së Elbasanit nga pikëpamja arkitektonike. Ai na jep dhe një përshkrim të mureve duke dalluar në to disa faza ndërtimi si dhe na japë një datë përafërsisht të saktë se kur është ndërtuar ajo. Në të gjitha shtresat e poshtme të mureve, autori evidenton periudhën e parë të ndërtimit me tekniken *opus mixtum* me katër rreshta tullash në brez. Të po të njëjtës periudhë janë dhe portat e kullave. Sipas tij, periudha më e mundshme e ndërtimit të kalasë është gjysma e dytë e parë e shekullit të IV të erës sonë. Ndërsa të gjitha rindërtimet me breza tullash është i mendimit se i përkasin periudhës nga mesi i shekullit të V deri në vitet

Claud (ine) signif (ere) cornu (cularis)

Përkthimi:

Mark Sabidit birit të Markut (?)

Aemilia Maksimit, ushtar të legjionit të XI

Klaudian sher jë bartësit..

Më tej na jepn informata rreth jetës së tij, ku mësojmë se ka qenë centurion (komandant i një njësie prej 100 vetësh) në legjionin e XI galik, është dekoruar për fitoren kundër judejve . Është transferuar në legjionin e IV Skytik si centurion, pastaj në legjionin e e i prej perandorit Antonin Piu, pastaj në legjionin e XIII. Mendohet se ai ka jetuar rreth 70 vjet dhe ka shërbyer në ushtri për gati 40 vjet. (Shyqyri Demiri: "Histori e shkurtër e trevës së Elbasanit ", fq. 21-21)

100 Demiri. Sh,» Histori e shkurtër e trevës së Elbasanit", Tiranë 2006, fq. 21.

101 Cerova. Y,» Castrum Scampis « Iliria 1-2, Tiranë 1997, fq. 286.

102 Po aty, fq. 286.

e para të sundimit të perandor Justiniani I. Duke filluar nga shekulli i VI deri në periudhën kur kalaja u rindërtua nga sulltan Mehmeti i II në vitin 1466, mendon se jetesa në kala është ndërprerë.¹⁰³ Gërmime të tjera janë realizuar gjatë viteve 1987-88 në pjesën jugperëndimore në brendësi të territorit të kalasë duke na dhënë më shumë informacione mbi lindjen dhe zhvillimin e kësaj qendre. Duke u mbështetur në teknikën e ndërtimit të mureve rrethuese të kështjellës dhe duke e krahasuar atë me kështjella të tjera të Gadishullit Ballkanik, si dhe duke u bazuar në materialet e shumta arkeologjike rezultoi se jeta në Skampis i ka fillimet me ndërtimin e kalasë, nga fundi i shekullit të III-të të erës sonë dhe ka vazhduar pa ndërprerje deri në mesjetën e vonë.¹⁰⁴

Kulla monumentale e orës¹⁰⁵

Karakteristikë e qyteteve shqiptare, në krahasim me qendrat e tjera urbane të Perandorisë Osmane, ishte prania në mjediset e tyre urbane që nga mesi i shek. XVI, i kullave të posaçme në të cilat kishte orë për matjen e kohës. Përgjatë shek. XVII ishin pajisur me të tilla objekte pothuaj të gjitha qendrat qytetare, si Prizreni, Berati, Shkodra, Prishtina, Peja, Kruja dhe Elbasani. Idenë për ndërtimin e tyre e kishin sjellë tregtarët vendas, në kontakte të shpeshta me qytetet evropiane. Ata sollën prej andej edhe mekanizmat kohëmatës, për të cilët ndërtuan kulla të posaçme në sheshet e pazareve apo në vende pranë tyre të zgjedhura, që kulla të bëhej element mbizotërues i siluetës së qytetit. Në Elbasan si vend për ngritjen e saj u pëlqye kulla e hyrjes së kalasë pranë xhamisë së Fatiut, të cilën Evlija Çelebiu e cilëson shumë të bukur dhe që funksiononte shumë mirë. Në formën e saj të hershme ky sahat qytetar nuk njihet, madje në të njëjtin vend vërtetohet që janë ngritur radhazi tre të tilla, njëri i përkohshëm me strukturë druri dhe i fundit që njohim, sic thuhet në mbishkrim, u ngrit me mirësinë e banorëve të qytetit në vitin 1899. Kulla ngrihet në lartësinë me trekate funksionale, me planimetri katrore 4,3 m x 4,3 m. Në ballin nga qyteti ndodhet porta e hyrjes, mbi harkun e së cilës është shkruar historiku i ndërtimit të saj. Teksti i mbishkrimit është: *“Mbreti i botës Abdylhamiti bujar në hijen e hirit të tij u ngrit sahati i hijshëm, burrat me sedër të Elbasanit patën mirësinë dhe ngjallën këtë kohëtregues të bukur dhe zemërledhatues, shumë u përpoq, u kujdesua dhe u interesua Aqif beu, Zoti i dhashtë si shpërblim gjithë të mirat e kësaj bote kur tingëllon, me zërin e tij njofton për bukuri kohën e saktë në mënyrë të përsosur nga të katër anët tregon minutat meqë zotëron intuitën e vjershëtorit tuaj o Refit vitin e ndërtimit të tij*

103 Karaiskaj. Gj, «Kalaja e Elbasanit» Monumentet 1, Tiranë 1975, fq. 62-63.

104 Cerova. Y, «Castrum Scampis» Iliria 1-2: Tiranë 1997, fq. 287.

105 Enciklopedia e Qarkut Elbasan.

e ndërtuan në fillim të vitit 1315¹⁰⁶. Artistikisht Kulla e Orës së Elbasanit është një gjetje origjinale në propocionet dhe në trajtimin dekorativ të strukturave të jashtme.

Namazgjaja

Në fundin e shek. XV, qyteti i Elbasanit mori një shtrirje të gjerë jashtë mureve të kalasë, duke arritur përgjatë një shekulli përmasat e një qyteti të madh të kohës. Varoshi ndahej në 18 lagje të banuara nga qytetarë të besimit islam e 10 lagje me banorë të krishterë. Në qytet dallonte ndër të tjerë edhe Namazgjaja, një shesh lëndine i rrethuar me 60 selvi të larta. Me drejtimin nga kibra, ajo kishte të theksuar nikenë, mihrabin dhe shkallaren e minberit të realizuar me strukturë guri. Rreth e rrotull një bordurë prej guri dhe kangjella druri qarkonte sipërfaqen e namazgjasë në të katër anët. Ajo ishte në përmasa të mëdha dhe mendohet se ajo vinte e para ndaj të gjitha të tjerave të ndërtuara në Shqipëri.

Bazilika e Klosit

Në fshatin Klos të Sulovës në rrugën që kalon pranë kalasë antike të Qafës gjenden rrënojat e një bazilike. Bazilika e Klosit është trenefëshe në arkada mbi pilastra drejtëkëndëshe. Gjatë ekzistencës së saj bazilika ka pësuar trasformime. Mendohet se është ndërtuar në shek. XIII- XIV dhe përbën një dëshmi me rëndësi, si ndërtim në një zonë fshatare

Bazilika në Tepe

Bazilika në Tepe të Elbasanit ndodhet në ullishtat e qytetit shumë pranë tij, ç'ka tregon se bazilika i takon varrezës së Skampisit. Është e drejtuar nga lindja. Ajo u gjet me mure që ruhen pak mbi tokën. U përkiste disa fazave ndërtimore. Faza e parë e ndërtimit paraqet një bazilikë me tri mjedise të formuara nga dy kolona. Muret mbi të cilët mbështetet, janë ndërtuar me gurë dhe breza 3-4 rradhësh tulle. Lartësia e plotë e murit ka qenë 5,5 m. Në fazën e dytë në kishë u bënë një sërë transformimesh, për t'ia përshtatur më mirë përdorimit si kishë varrezash, funksionin që mund të ketë pasur që në fillim. Këto ndryshime lidhen me futjen brenda saj, në nefin verior, të dy varreve me qemer tullash.

Dyshemeja e kishës në këtë kohë ndahet nga rrugët me pllaka shtuf në 4 panele mozaiku, dy nga dy, simetrike kryesisht me motive bimore e gjeometrike. Kolonat e ikonastasis janë prej mermeri gri të prura nga një vend tjetër. Në pllakat e ikonastasis me përmasa 102 x 92 cm, janë gdhendur luanë, kaprollë, shpendë

¹⁰⁶ Karaiskaj. Gj.» Kalaja e Elbasanit « Monumentet 1, Tiranë 1975, fq. 78.

të ndryshëm, krahas ornamenteve bimore. Ky rindërtim datohet në shek. V e.s. Më vonë monumentit i është bërë një ndryshim në anën perëndimore.

Ndryshimi është bërë në shek. VI e.s. dhe përkon i njëjtë me atë të një rindërtimi në kalanë e Elbasanit. Me rrënimin nga tërmetet, mundet që në v. 518 kisha, nuk rindërtohet më, sepse Skampis kishte katedralen e Shën Pjetrit, që përmendet në dokumente dhe se në këtë kohë lejohej varrimi brenda kalave. Nga ky monument i ndërtuar brenda kalasë janë gjetur kapitete e kolona dritaresh.

Hamami i Pazarit përbën një ndër banjat e ruajtura më së miri në qytetin e Elbasanit. Ajo ndodhet në qendër të qytetit, në pazarin përballë kalasë ¹⁰⁷. Hamami i Pazarit gëzon statusin e kategorisë së I të monumenteve të kulturës ¹⁰⁸. Kjo banjë mesjetare shquhet për zgjidhjet funksionale dhe elementët e saj teknikë të përsosur. Vaskat e ujit janë kudo të punuara, nëpërmjet gdhëndjes, prej një guri të vetëm, i cili në banjat e mëdha trajtohet si element dekorativ. Ato furnizoheshin me ujë të nxehtë dhe ujë të ftohtë nëpërmjet dy tubave prej qeramike ¹⁰⁹.

Banja e Pazarit të Elbasanit është një nga shembujt më të goditur, që iu nënshtrua ndërhyrjeve restauruese ¹¹⁰.

Kisha e Grabovës është ndërtuar në fshatin Grabovë e Siperme rreth shekullit të XVIII. Si shumë kisha orthodokse është me orientim lindje-perëndim. Hyrja kryesore është nga perëndimi. Permasat janë afërsisht 25x20m ¹¹¹. Kisha gëzon statusin e kategorisë së I të monumenteve të kulturës, status i fituar me vendimin nr 786, datë 05.11.1984 ¹¹².

Kisha e Shën Mërisë është shpallur monument kulture në vitin 1963. Ajo gjëndet në qytetin e Elbasanit dhe shquhet për vlerat e saj etnokulturore e arkitekturore të rralla në rajon ¹¹³. Kisha e Shën Mërisë është një ndërtim me arkitekturë të stilit bizantin, ku janë përdorur gurë të gdhëndur. Nga të dhënat historike, mësohet se brenda mureve të kalasë kanë qënë ndërtuar tunele me skema të caktuara për shërbime të rëndësishme. Në brendësi të kishës gjënden

107 A touristic guide to Elbasan, Tiranë 2012, fq 69.

108 Ligji Nr. 9592, datë 27.07.2006, «Për disa shtesa e ndryshime të ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003» Për Trashëgiminë Kulturore.

109 Roberto Pierini, Recovering and improving Elbasan fortress, Pisa University 2008.

110 Emin Riza, Teoria dhe praktika e restaurimit të monumenteve të arkitekturës, fq 165.

111 Roberto Pierini, Recovering and improving Elbasan fortress, Pisa University 2008.

112 Kartela e Drejtorisë Rajonale të Monumenteve të Kulturës Durrës- Sektori Elbasan.

113 A touristic guide to Elbasan, Shtëpia Botuese «Erik», 2012, fq 70.

katakombet, ku vendoseshin trupat e të vdekurve, si dhe kanalet e brendshëm të saj, të drejtuar për në pjesën e poshtme të qytetit¹¹⁴.

Kisha e Shën Kollit (Shelcan) ndodhet përgjatë rrugës Elbasan-Gjinar, një godinë njëkatëshe në të cilën ruhen afreske të piktorit të famshëm Onufri. Kisha është ndërtuar shumë pranë rrugës kryesore, që shekuj më parë shërbente për të lidhur Elbasanin me qytetet e tjera në Jug, si Fierin, Beratit etj.¹¹⁵ Kisha kategorizohet si monument kulturore i kategorisë I ¹¹⁶. Kisha është shpallur monument kulture në vitin 1968¹¹⁷.

Kisha e Shën Gjon Vladimirit është shpallur monument kulture i kategorisë së I në vitin 1948¹¹⁸. Kisha është një sallë me permasa 20x13m. Dyshemeja është e shtruar me rrasa guri dhe ndodhet më e ulur me 80cm nga niveli i tokës natyrore në pjesën e jashtme. Nga veriu dhe jugu merr ndriçim nga një rrjesht me 4 dritare për anë të vendosura në lartësi pranë tavanit dhe nga perëndimi nga tre të tjera. Në pjesën e hyrjes është një pjesë e ngritur prej druri ku hipet me shkallë po prej druri. Ikonostasi është muraturë tulle përfshin dhe 2 kollona brenda tij. Pas tij ndodhet apsidi i cili ruhet në gjendjen origjinale edhe pse është shumë i vjetëruar¹¹⁹.

Ura e Kamarës është shpallur monument kulture në vitin 1963, me vendimin nr 6, datë 15.01.1963 nga Rektori i Universiteti Shtetëror ¹²⁰. Është urë mesjetare e ndërtuar rreth viteve 1714. Ka pasur disa periudha ndërtimi. Ka pësuar një rindërtim gjatë periudhës osmane. Themelet e urës duken të fortë dhe ajo vazhdon të shërbejë banorëve të zonës. Ndodhet rreth 5km larg qytetit të Librazhdit, në fshatin Mirakë. Ura është asimetrike, me tre qemerë interesantë për nga forma dhe lloji i ndërtimit. Qemeri i madh i urës ka një hapësirë prej 23 metrash dhe qemeri i djathtë është në formë segmenti rrethor. Ndërmjet tyre ka dritare shkarkuese në formë lundre. Ura e Kamarës është e gjatë rreth 40 m dhe e gjerë rreth 3.5m dhe midis tyre ndodhen dritare shkarkuese në formë

114 Po aty, fq 71.

115 Po aty, fq 72.

116 Ligji Nr. 9592, datë 27.07.2006, «Për disa shtesa e ndryshime të ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003» Për Trashëgiminë Kulturore.

117 Sipas të dhënave të marra nga Kartela e Drejtorisë Rajonale të trashëgimisë kulturore, Sektori Elbasan.

118 Ligji Nr. 9592, datë 27.07.2006,» Për disa shtesa e ndryshime të ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003» Për Trashëgiminë Kulturore.

119 Kartela e Drejtorisë Rajonale të Monumenteve të Kulturës Durrës- Sektori Elbasan

120 Po aty, fq 45.

lundre¹²¹. Eshte e vendosur mbi tre qemere, te ndertuar me gure ngjyre gri në te bardhe si vete perberja e malit të Murrashit, bazamenti për kalimtarët është ndërtuar me një kalldrëm me gurë lumi të rrumbullakët. Mendohet që ura të ketë patur edhe parmakë, por si rezultat i përmytjes së saj nga lumi Shkumbin nuk janë më.

Gërmadhat Antike (Stacioni rrugor Ad Quintum) është shpallur monument kulture në vitin 1963, Rektorati i Universitetit Shtetëror¹²². I ndërtuar në shekullin II-III ky stacion ndodhet 5m larg gjurmëve antike të rrugës Egnatia¹²³. Ka një planimetri drejtkëndëshe, me sipërfaqe 130 m², me këto mjedise: dhoma e zhveshjes, mjedisi i ngrohtë, mjedisi i nxehtë, dhe ai me ujë të ftohtë. Në brendësi ishte dhoma e zhveshjes, që shërbente për lidhjen e mjedisëve. Muret e Hamamit janë ndërtuar me muraturë të përzier. Furnizimi me ujë bëhej me anë të kanaleve nga një depozitë mbi murin e nimfeut dhe largoheshin me një sistem tjetër kanalizimi.

Kalaja e Peqinit është ngritur në periudhën mesjetare të shek të XV duke shfrytëzuar themelet e kohës antike. Për shkak të periudhës pak a shumë të gjatë të ekzistencës dhe të përdorimit të vazhdueshëm kalaja ka pësuar ndryshime¹²⁴. Në këtë kala përveç periudhës së parë të ndërtimit, konstatohen edhe 3 periudha kryesore rindertimi. E para i takon shek. I dhe të III ku kanë qenë vetëm muret rrethuese si dhe disa pjesë të dy kullave. Periudha e dytë e ndërtimit duhet t'i përkasë viteve 1670 kur kalaja u vizitua nga udhëtari turk Elvia Çelebia. Në shënimet e tij kalaja përshkruhet në të njëjtën formë me atë të periudhës së dytë. Kësaj periudhe i përket ndërtimi i disa ambjenteve dhe të portës së vogël të hapur në kullën 4 këndëshe. Mbi to është ndërtuar dhe një xhami e vogël pa minare kryesisht për të kryer ritet fetare për ushtarët që jetonin në kala. Periudhës së tretë i takon pjesa e ndërtimeve brenda dhe jashte kullave. Në të dyja anët e saj ndodhet një frengji e vogël për vendosjen e pushkëve dhe përballë hyrjes se kullës ka një frengji të vogël topi. Në këtë periudhë bëhet kthimi i kullave nga të rrumbullaktë në poligonale rindertime që i përkasin viteve 1770. Qyteti në këtë kohë ishte i zgjeruar në pjesën veriore dhe verilindore të kalasë ku terreni është më i sheshtë dhe më i gjerë. Një gjë të tillë e dëshmon dhe ndërtimi i tre xhamive dhe i një teqeje në këtë anë ndaj hapja e një porte të vogël

121 Historia e arkitekturës shqiptare, Botim i Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës, Insituti i Monumenteve të Kulturës, Tiranë 1979, fq 345

122 Kartelat e Drejtorisë Rajonale të Monumenteve të Kulturës Durrës- Sektori Elbasan

123 Historia e arkitekturës shqiptare, Botim i Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës, Insituti i Monumenteve të Kulturës, Tiranë 1979,fq 346.

124 Po aty, fq 347.

u bë pikërisht për të lehtësuar komunikimin me qytetin kur krahina dhe kalaja e Peqinit ishin shndërruar në shesh betejash ndërmjet Bushatllinjve të Shkodrës dhe Ahmet Kurt Pashës së Beratit. Si rezultat i goditjeve të herë pas hershme kalaja pati nevojë për rindertime. Nga teknika e ndërtimit kullat e kalasë janë të ngjashme me disa kulla në kalanë e Beratit, të Shkodrës e Tepelenës dhe këto punime njihen si punime të kohës së Ali Pashë Tepelenës.

Muzeu historik

Muzeu etnografik në Elbasan¹²⁵, është i vetmi i mbetur pas prishjes dhe tjetërsimit të muzeve të tjera. Ky objekt me vlera arkitektonike dhe historike brenda mureve ka një pasuri të vyer të kulturës popullore të kësaj treve, mes të cilave spikasin punime dhe elementë nga rreth 80 lloj zeje. Në dhomat e godinës dykatëshe të muzeut, përmes objekteve pasqyrohet mënyra e jetesës së kësaj zone, mobilimet, veshjet, etj. Janë renditur dhomat në mënyrën sesi ato funksiononin duke të dhënë imazhin e një shtëpie të vjetër elbasanase, duke përfshirë gjithçka.

Muzeu Etnografik u krijua në vitin 1986 në shtëpinë e Sejdinëve e cila ishte ruajtur si monument tradite edhe pse pronarët e saj ishin cilësuar “armiqtë e popullit”. Jo shumë larg sheshit të Bezistanit në qendër të qytetit kjo shtëpi është restauruar së fundi. Është një ndërtesë karakteristike me çardak, e veçantë në llojin e saj në trevën e Elbasanit, ajo është përcaktuar si simbol i shtëpive elbasanase. Në planin arkitekturor, banesa e ndërtuar në vitin 1870 ngjan me shtëpitë karakteristike të Beratit dhe Shkodrës, por ka shumë elementë që e bëjnë unike. Kati i parë i banesës, dikur magazinë për prodhimet bujqësore të familjes Sejdini, përbëhet nga tre dhoma dhe një sallon, në të cilat tani paraqiten vlerat e traditës popullore, por edhe dokumente historike me vlerë. Dhoma e punimit të leshit, dhoma e metaleve si dhe dhoma e tabakëve kanë zënë vend në këtë kat, duke i krijuar mundësi vizitorit që të njihet me kulturën dhe traditën vendase.

Kati i dytë i muzeut përbëhet nga një korridor i madh, dhoma e punës së vajzave, dhoma e grave, dhoma e burrave dhe dhoma e nuses. Në numrin e madh të zejeve, që pasqyrohen në këtë muze, përmenden punimet e shajakpunuesve, qeleshepunuesve, kazazëve, punimet e opingarëve, e saraçëve, punimet e zilexhinjve, armëtarëve, argjendarëve, çibukçinjve, samarxhinjve, mullinjtë primitivë të vajit, si dhe guri mortor i legjionarit Mark Sabitis, monumenti që vërteton arkeologjikisht vendndodhjen e Skampis. Punonjësit e muzeut etnografik, shprehen se zejtaria në qytetin e Elbasanit nisi të zhvillohej në

125 https://sq.wikipedia.org/wiki/Muzeu_Etnografik_i_Elbasanit

gjysmën e parë të shekullit të XVII-të.

Gjithçka që ruhet në muze transmeton një mozaik të pasur vlerash, që pasqyrojnë tiparet etnografike të krahinës. Të gjitha këto janë realizuar me copa të kushtueshme, zbukuruar me motive vendase të thurura me gajtane dhe tel argjendi ose ari. Sipas tyre, kostumet e burrave dhe të grave që dalloheshin për bukurinë dhe elegancën çmoheshin shumë nga të huajt.

Një dolloman apo xhybe e kategorisë së parë, që përdorej nga aristokracia, e punuar me copë kadife të kuqe të importuar, tregtohej përkundrejt një shumë të madhe. Në gjysmën e dytë të shekullit të XIX në punimin e kostumeve kombëtare përmenden mjeshtërit elbasanas Hasan Dilja, Tahir Kryemadhi etj. Ka ende familje që trashëgojnë zejet e vjetra, por pak prej tyre arrijnë ti realizojnë punimet ashtu siç bënin të parët e tyre. Mosrritja e krimbit të mëndafshit, humbja e tezgjahut apo edhe futja e teknologjisë kanë bërë që gjithçka të jetë tepër të vështirë për t'u realizuar.

Shtëpia muze e Kostandin Kristoforidhit, Zbulimet e fundit

Në Elbasan tashmë janë identifikuar 5 bazilika paleokristiane. Bazilika e pestë është zbuluar jashtë kalasë, në jug të saj. Mozaiku është polikromi i ndarë në panele në të cilat janë realizuar skena biblike. Në panelin tjetër, i cili nuk është zbuluar plotësisht mendohet se është realizuar kopshti i Edenit. Qyteti i Elbasanit është një nga qytetet më të vjetra shqiptare me një qendër historike, siç është kalaja, por dhe me territore përreth që fshehin pasuri të natyrës arkeologjike, që hedhin dritë mbi identitetin e këtij qyteti, kulturën dhe historinë e tij. Qyteti "Skampa", është themeluar nga Romanët gjatë rrugës Egnatia në shekullin e dytë para Krishtit. Vendet në kala duken sikur kanë origjinë nga termet bizantine, impianti urbanistik tepër në rregull.

Monumentet natyrore

Zona e Elbasanit shquhet për potencialin turistik të saj, falë pozitës gjeografike të favorshme, larmisë së mikroklimës, pasurive të shumta ujore, larmisë së formave të relievit, të shoqëruara me një botë të pasur bimore e shtazore. Për fat turizmi në zonën e Elbasanit ka shumë pika karakteristike tradicionale. Disa prej tyre janë Rrapi i Mansit, Kroi i Kalit, Ulliri i Qejfit, Burimi i Bankës, Gurra e Labinotit, Tuneli i Mirakës etj. Por mbi të gjitha veçohen për turizmin liqenet e Dumresë, Llixhat e Elbasanit, Gjinari e Busheku. Si kudo turizmi edhe në zonën e Elbasanit përbën një sektor të rëndësishëm jo vetëm për vlerën ekonomike, por edhe për atë kulturore e historike¹²⁶.

126 Strategjia Rajonale e Qarkut Elbasan, Elbasan, fq 30.

“Ulliri i Qejfit”, tempulli i dashurisë së qytetit

Rrapi i Mansit, Kroji i Kalit, Burimi i Bankës, Gurra e Labinotit, Tuneli i Mirakës, Ulliri i Qejfit¹²⁷... Janë këto disa nga zonat turistike të Elbasanit, qytet në Shqipërinë e Mesme, që të tërheqin jo vetëm për bukuritë që ofrojnë, por edhe për emrat e veçantë, të vendosur në shekuj nga vetë vizitorët. Mes tyre spikat ‘Ulliri i qejfit’, ose ‘Ullini i qejfit’ siç e quajnë në dialekt elbasanllinjte. Është një vend që ndodhet në majë të kurorës së gjelbër, në hyrje të Elbasanit dhe nga kjo pikë qyteti mund të shihet në pëllëmbë të dorës. Por jo vetëm kaq.

Janë më shumë se 20000 hektarë ullinj që krijojnë kurorën e gjelbër të qytetit të Elbasanit. Kultivimi i këtij druri është pasion i elbasanllinjve, jo vetëm se ulliri është një pemë që gjelbëron në çdo stinë, por edhe se frutet e tij janë mjaft të ushqyeshme dhe kurative.

Në fund të kësaj kurore, ndodhet një pemë ulliri e veçuar nga të tjerat, e rrethuar nga një lëndinë e vogël. Pranë këtij ulliri ndodhet dhe një çezmë, e ndërtuar në vitin 1900 nga kalajasi Pal Shuteriqi.

Kjo pemë prej mëse një shekulli e gjysmë njihet me emrin ‘Ulliri i qejfit’. Etnologu i njohur elbasanas, Thanasi Meksi, thotë se “është quajtur kështu pasi nga kjo pikë Elbasani shihej në pëllëmbë të dorës dhe panorama që të shfaqej ishte vetëm gjelbërim. Nga ky vend shihej ullishta gjithandej, deri afër Petreshit dhe ajo që të ofrohej ishte vërtetë e mrekullueshme”.

Duke vijuar shpjegimin e tij lidhur me këtë emër, etnologu Meksi shtoi se “atje njerëzit shkonin për qejf, për të parë nga lart qytetin e tyre, për t’u freskuar nga ajo çezmë dhe më pas uleshin së bashku, drekonin dhe diskutonin për probleme të ndryshme”. Pikëpyjekja e tyre, vijon etnologu Meksi, kishte një emër ‘Ulliri i qejfit’, pasi atje shkonin veç për qejf. Edhe këngëtari i njohur elbasanas, Isuf Myzyri, shkonte shpesh atje me miqtë dhe grupin popullor.

Shoqëria e Shuteriqve dhe e Xhufkave të kalasë, frekuentonin këtë pikë turistike çdo fundjavë, ndërsa poetë të ndryshëm, ndër të cilët përmenden Nexhip Ejupi e Milianov Kallupi i kanë kushtuar vargje “Ullirit të qejfit”. ‘Ulliri i qejfit’ vijon etnologu elbasan, është tempulli kryesor ku shprehet dashuria për qytetin. “Kurora e ullirit nënkupton për banorët mirësi, paqe e mbarësi”, shprehet ai. Kryebashkiaku i Elbasanit, Qazim Sejdiu, një frekuentues i rregullt i kësaj pike, kujton momente nga fëmijëria e tij. “Shkonim gjithnjë atje lart.

Prindërit e mi kishin një dëshirë të madhe të shijonin atë natyrë të qetë e të pastër”, vijon ai. “Kam shëtitur në shumë vende përgjatë këtyre viteve, por ai ulli dhe ajo lëndinë e vogël, mbetet ndër më të bukurit”, shprehet kryebashkiaku Sejdiu. Tashmë ‘Ulliri i qejfit’ nuk vizitohet si dikur. “Ky vend

¹²⁷https://sq.wikipedia.org/wiki/Turizmi_n%C3%AB_Elbasan#.E2.80.9CUlliri_i_Qejfit.E2.80.9D.2C_tempulli_i_dashuris.C3.AB_s.C3.AB_qytetit

kaq i mrekullueshëm ka nevojë për investim. Çezma, e cila ka më shumë se një shekull që është ndërtuar, duhet restauruar”.

Busheku

Busheku me rrepet shekullore është një nga pikat historike e turistike më të bukura të Elbasanit. Ai është një nga vendet më të preferuara tradicionalisht nga elbasanasit. Busheku ndodhet në jug të qytetit, në luginën e Shkumbinit në të majtë të rrjedhës së tij. Është një pikë turistike me burime të shumta ujore, ku veçohet një burim karstik, me prurje 70 litra në sekondë që del rrëzë një shkëmbi gjigant.

Kjo pikë ndodhet në fshatin Shushicë të komunës me të njëjtin emër, rreth 9 km larg qytetit të Elbasanit. Vendasit e quajnë veten me fat që natyra u ka dhuruar një pasuri kaq të çmuar natyrore. Banorët e Elbasanit e quajnë veten me fat që natyra u ka dhuruar një pasuri natyrore si ajo e Bushekut, një zonë e mbushur me rrepe shekullore dhe me burime të ftohta ujore.

Vetëm 9 km larg qytetit të Elbasanit, Busheku, një nga pikat historike e turistike më të veçanta të këtij rajoni, vazhdon të jetë një nga vendet më të preferuara tradicionalisht nga elbasanasit, pavarësisht mungesës së investimeve që më së shumti janë privuar nga problemet e pronësisë. Vendasit të thonë se, së pari duhet të investohet në rehabilitimin e pak kilometrave rrugë, por edhe në ngritjen e godinave akomoduese, të cilat do të rrisnin numrin e turistëve vendas dhe të huaj. Pavarësisht problemeve, përpjeket në këtë drejtim kanë nisur.

Një biznesmen elbasanas ka ndërtuar së fundmi një kompleks pishine në Bushek, i cili çdo fundjavë tejmbushet nga pushuesit. Vendasit shprehen të bindur se nuk do të jetë e largët dita që pika turistike e Bushekut do të kthehet në një perlë të vërtetë të turizmit shqiptar.

Dita e Verës, festa tradicionale e Elbasanit

Dita e Verës është një festë me origjinë të lashtë pagane. Ajo është festë arbëreshe e trashëguar në veçanti nga qytetarët e VALM-it Elbasanit (Skampa e lashtësisë) dhe festohet më 14 mars.

Festimi kryhet në nderim të natyrës së bukur shqiptare dhe bimësisë që merr jetë në këtë datë. Tanimë kjo festë është bërë edhe ditë kombëtare pushimi. Shenja dalluese e këtij festimi është gatimi i ballokumeve. Ndonëse kjo ditë vazhdon të ruhet dhe festohet madhërisht në qytetin e lashtë të (VALMIT) Elbasanit, ajo është festë e të gjithë shqiptarëve. Më 13 mars njerëzit marrin një tufë të vogël bari të njomë bashkë me rrënjët dhe dheun, që ta kenë në

mëngjesin e datës 14 mars në shtëpi. Ky zakon i lashtë ruhet dhe festohet jo vetëm në Elbasan po edhe në Dibër, Strugë e Prespë.

Dita e Verës ishte dita e fillimit të vitit sipas kalendarit shumë të lashtë të shqiptarëve, pra një ditë që kremtohej shumë shekuj para se të lindte krishterimi. Ajo kremtohej me 1 mars të kalendarit Julian, ditën e parë të vitit të ri (sipas kalendarit Gregorian, “14 mars”) Ajo ishte një festë mbarëshqiptare, që kremtohej si në Veri edhe në Jug, por me nuanca të ndryshme, sipas krahinave.

Si dëshmi po sjellin këtu dy përshkrime të kuptimit dhe kremtimit të “Ditës së Verës” “njëra për krahinat jugore, tjetra për malësitë veriore. Janë përshkrime të botuara në kohën kur në Shqipëri nuk kishte parti politike, madje në kohën kur as institucionet klerikale nuk futnin hundët në kremtime të ashtuquajtura pagane. Përshkrimin e parë e kemi nga i madhi Faik Konica, i cili gati 100 vjet më parë, në kohën e sundimit osman, shkruante me atë stilin e vet elegant.

Në këtë kapitull evidentohet metodologjia mbi bazën e së cilës është bërë e mundur përmbushja e synimit që përmban studimi i ndërmarrë. Ky studim bazohet në përdorimin e miksuar të metodave sasiore e cilësore. Miksimi në fjalë, ndër të tjera ndihmon edhe **në adresimin e pyetjeve kërkimore dhe çështjeve të ngritura në këtë studim**. Metodat e përdorur është metoda sasiore e grumbullimit të të dhënave përmes procesit anketues të zhvilluar me një pjesë të konsiderueshme të popullsisë së përzgjedhur enkas. Në të njëjtën kohë i jemi referuar edhe metodës cilësore në procesin e grumbullimit të të dhënave **përmes intervistave të thelluara me specialistë në institucione vendore**.

Theksojmë se studimi ruan natyrë përshkruese, sepse mundëson një përshkrim të hollësishëm **të çështjeve në studim nëpërmjet** analizës së detajuar të informacionit që merret nga të anketuarit, nga specialistë të ndryshëm dhe nga analiza e literaturës së cilës i jemi referuar. Për më tepër në arritjen e synimit tonë jemi mbështetur në një masë të konsiderueshme edhe në një studim të kryer posacërisht për problematikën e interesit tonë studimor¹²⁸.

3.1 INSTRUMENTAT E KËRKIMIT

Për këtë studim është përdorur një pyetësor më të dhëna demografike, mbi nivelin arsimimit dhe mbi statusin e punësimit të hartuar nga studiuesja e këtij disertacioni, i mbështetur nga një instrument i hartuar dhe propozuar nga një ekip kërkuesish të Bankës Botërore, përfshirë Cristian Grootaert, Deeepa Narayan, Veronica Nyhan Jones dhe Michael Woolcock¹²⁹. Ky instrument është hartuar për t'u përdorur në vendet në zhvillim edhe si rezultat i pamjaftueshmërisë së studimeve që masin në mënyrë të drejtpërdrejtë rolin e faktorëve socio-kulturorë dhe politikë në përjashtimin social. Në Shqipëri çdo pesë vjet përdoret LSMS, që synon matjen e nivelit të jetesës, duke e vënë theksin në faktorët ekonomikë (të ardhurat, konsumi etj.), por ky instrument që është përdorur në këtë studim është një instrument plotësues. Qëllimi i këtij instrumenti është të prodhojë të dhëna shifrore për rolin e kapitalit njerëzor e

128 Referuar studimit "Vullnetarizmi dhe Trashëgimia Kulturore "Organizata jo-qeveritare Eman-
cipimi Civil Ma Ndryshe – EC Ma Ndryshe, Tetor 2009, Prizren.

129 Dokument Pune Nr.18 i Bankes Boterore, fq 34.

kapitalit social në lidhje me dimensionet e përkatësisë në rrjete sociale, besimit dhe solidaritetit, aksioneve të përbashkëta dhe bashkëveprimit, fuqizimit dhe aksioneve kolektive, për një fushë mjaft delikate si ajo e ruajtjes dhe zhvillimit të diversitetit të integruar të trashëgimisë kulturore.

Një nga anët pozitive të tij është se ky instrument është pilotuar dhe testuar për standardet e besueshmërisë dhe të vlefshmërisë në vendin tonë. Ky instrument synon që me anë të të dhënave që do të mblidhen, të shihet se si ndërvepron një komunitet i caktuar dhe se çfarë karakteristikash ka ai, sidomos në lidhje me pjesëmarrjen e individëve për vullnetarizmin.

Ky instrument ka edhe anën e tij pozitive, sepse në grupin e ekspertizës për këtë instrument është edhe studiuesi Robert Putnam, teorisë së të cilit i referohet shpesh ky studim. Për hartimin e këtij instrumenti kanë shërbyer studime të ndërmarra në vende të ndryshme. Gjatë testimit të tij në vendin tonë doli në pah se duheshin më pak pyetje për sesionin e përkatësisë në shoqata, por edhe adaptime socio-kulturore. Gjithashtu, kjo fazë evidentoi edhe faktin mbi kuptueshmërinë e shkallëve dhe për riformulimin e pyetjeve të pakuptueshme. Në përfundim, përdorimi i testimit të këtij instrumenti është shumë i domosdoshëm përpara aplikimit të tij në terren.

Anketa

Anketa e përdorur në studim është ndërtuar me qëllim mbledhjen e një informacioni sa më të gjerë lidhur me opinionet dhe qëndrimet e banorëve të përzgjedhur në studim lidhur me problematikat e vullnetarizmit për ruajtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë kulturore.

Për t'i shërbyer sa më mirë qëllimit të kërimit dhe arritjes së objektivave, në hartimin e anketës janë marrë në konsideratë studime të ndryshme respektive që ndërthurin çështjen e vullnetarizmit dhe të zbatimit të një strategjie dhe plane të diversitetit të trashëgimisë kulturore lokale, veçanërisht në kushtet mjedisore, sociale e shëndetësore sipas modelit të studimit të Komisionit Europian: Special Eurobarometer *"Attitudes of European citizens towards the environment"* (2005), studimi i OBSH-së: *"Addressing the social determinants of health: the urban dimension and the role of local government"* (2008 dhe 2010).

Anketa e përdorur në këtë kërkim ka dy blloqe bazë. Blloku i parë bazohet në mbledhjen e të dhënave principale. Blloku i dytë synon mbledhjen e të dhënave gjenerale të banorëve, të cilat janë të dhëna sekondare por shumë të rëndësishme për interpretimin e të dhënave të mbledhura në zonën e studimit.

Variabla të pavarur në këtë studim janë:

- | | |
|--------------------------------------|---|
| 1. <i>Gjinia:</i> | Femër /Mashkull |
| 2. <i>Mosha (vjeç):</i> | 20-30; 31-40; 41-50; 51-60; mbi 61 |
| 3. <i>Arsimi:</i> | Tetëvjeçar; I mesëm; I lartë; Tjetër. |
| 4. <i>Punësimi:</i> | Po/Jo |
| 5. <i>Të ardhurat personale/leke</i> | 5.000-10.000; 10.000-20.000;
20.000-30.000; 40.000-50.000; mbi 51.000. |
| 6. <i>Vitet e banimit në zonë:</i> | 1-5 vjet; 5-10 vjet; Më shumë. |
| 7. <i>Gjendja civile:</i> | Beqar; I/e martuar; I/e divorcuar; I/e ve. |

Lidhur me çështjet që adreson, anketa e përdorur është konceptuar në tre rubrika madhore. Brenda secilës janë vendosur pyetjet sipas çështjeve që ky studim kërkon t'u jap përgjigje. Në çdo rubrikë janë përfshirë pyetje të mbyllura (të parakoduara dhe me alternativa të përcaktuara) dhe pyetje të hapura

Përsa i përket konceptimit të rubrikave, ato synojnë të grupojnë informacionin në blloqe përgjigjesh sipas çështjeve që gjykohen oportune dhe të rëndësishme për këtë kërkim, në këtë mënyrë ndihmojnë dhe interpretimin e tyre.

Rubrika e parë synon të përftojë të dhëna lidhur me ekzistencën ose jo të problemeve që lidhen me vullnetarizmin, duke iu përgjigjur pyetjeve:

- a) Sa e vlerësojnë qytetarët e anketuar vullnetarizmin si një mjet të dobishëm në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.
- b) Sa informacion kanë qytetarët e Elbasanit për iniciativa të tilla, gjë që tregon për mungesën e angazhimit qytetar për mbrojtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore, ose në rastin më të mirë për mungesën e promovimit të kësaj pune në rrethin e gjërë të qytetit.
- c) A ekziston diferenca në mes të bindjes dhe angazhimit si një ndër shkaqet themelore për përpjekjet e shoqërisë civile për të promovuar punën vullnetare në fushën e trashëgimisë kulturore dhe për t'i ofruar si qytetarëve ashtu edhe vendimmarrësve alternativa të duhura politike.
- d) A mendoni se vullnetarizmi në trashëgimi kulturore mund të prodhojë zhvillim ekonomik për qytetin.
- e) Edhe në rastet kur qytetarët vlerësojnë se kanë kontribuar në ndonjë aktivitetet vullnetar në mbrojtje të trashëgimisë kulturore, a ekziston mendësia se shumica e këtij aktiviteti kufizohet në pjesë shumë personale të tyre.

- f) Si mendojnë qytetarët kur bëhet fjalë për rolin e institucioneve/sectorëve të caktuar në nxitjen e vullnetarizmit në mbrojtje të trashëgimisë kulturore; a është shoqëria civile ajo që duhet të jetë prijëse e këtij procesi, në nxitjen e qytetarëve për angazhim vullnetar edhe në trashëgimi kulturore.
- g) Për nxitjen e qytetarëve për angazhim vullnetar në trashëgimi kulturore a ndikon njohja zyrtare e punës vullnetare si faktor mjaft i rëndësishëm, sikurse është vlerësuar me raporte të shumta edhe në fusha tjera.
- h) Cili është kuptimi i përgjithshëm i termit “Vullnetarizëm” në mesin e qytetarëve të Elbasanit? A është është nga më të ndryshmit?
- i) A e njohin qytetarët e Elbasanit trashëgimisë kulturore të qytetit. A mendojnë që i njohin mirë, mesatarisht ose shumë objektet dhe vlerat e trashëgimisë kulturore në qytet.
- j) Sipas qytetarëve të Elbasanit, a zë rinia apo mosha e mesme vendin kryesor në punën vullnetare për trashëgimi kulturore.
- k) A bëhet pengesë papunësia dhe gjendja e vështirë ekonomike në angazhimin vullnetar të qytetarëve.
- l) A është e rëndësishme puna vullnetare për ruajtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë kulturore në qytetin e Elbasanit.

Rubrika e dytë lidhet me mbledhjen e të dhënave mbi nivelin e informimit dhe mbi mënyrën e marrjes së informacionit, ndihmën dhe shërbimet e kërkuara/ofruara si dhe roli që luan shteti dhe institucionet vendore në trajtimin e çështjeve të adresuara prej tyre. Këto pyetje shërbejnë për të kuptuar jo vetëm nivelin e informacionit dhe mënyrës së marrjes së tij, por edhe cili është roli i institucioneve vendore në informimin e banorëve. Në këtë rubrikë pyetja që lidhet me atë se çfarë banorët kërkojnë është e hapur. Si variabla të varur në këtë rubrikë konsiderohen niveli i informimit për vullnetarizmin për ruajtjen dhe zhvillimin e diversitetit të trashëgimisë kulturore, frekuenca e ndihmës së kërkuar dhe e mbështetjes institucionale të ofruar si dhe lloji i mbështetjes së kërkuar.

Rubrika e tretë lidhet me mbledhjen e të dhënave për gjendjen konkrete të 145 monumenteve të kulturës të marrë në shqyrtim dhe kujdesit për to. Në alternativën e hapur jepen disa nga shqetësimet tipike të natyrës së konservimit dhe organizimit (pas konsultimit kjo me literaturën). Në mënyrë që banorët të

mos ndihen të bezdisur nga pyetjet mbi ruajtjen e diversitetit të trashëgimisë kulturore dhe shqetësimet që ndiejnë nga kjo, pyetjet e anketimit dhe të intervistimit ndonjëherë janë drejtuar edhe për të afërmit apo njerëz të tjerë në zonë. Gjithashtu kjo shërben edhe për të mësuar më shumë mbi individët e tjerë të cilët janë jashtë studimit. Pyetjet mbi vullnetarizmin, konservimin, zhvillimit të diversitetit të kulturës etj, janë bërë për të përcaktuar edhe popullatën tjetër jashtë zonave të marra në studim. Në total anketa përmban 21 pyetje.

Intervista

Në këtë studim, është përdorur intervista individuale (metoda cilësore) dhe me problemin në qendër. Secila prej pyetjeve ka adresuar një çështje të caktuar duke i lënë gjithashtu hapësirë të intervistuarve të ofrojnë një opinion sa më të gjerë për tematikën e ngritur. Qëllimi i përdorimit të intervistave ka qënë marrja e një informacioni të detajuar, të drejtpërdrejtë, konkret, koherent dhe të përdorshëm për funksionimin dhe koordinimin e institucioneve të ndryshme në identifikimin dhe trajtimin e problematikave të ndryshme, si dhe mbështetjen e ofruar për banorët e ndikuar direkt nga degradimi mjedisor, për ti shërbyer në këtë mënyrë qëllimit të studimit dhe arritjes së objektivave të tij.

Duke konsideruar këtë qëllim, si dhe duke patur primare mbledhjen e një informacioni të detajuar për çështje të pa trajtuara më parë, siç janë problemet e shkaktuara nga ndotja mjedisore apo bashkëpunimi midis institucioneve vendore për çështje që lidhen me problematika të reja të pa trajtuara më parë, intervistat janë ndërtuar me pyetje të fokusuara dhe të orientuara drejt çështjeve të studimit.

Për specialistët pranë institucioneve vendore (bashki/komuna), janë adresuar këto çështje me interes:

- *Informimi dhe sensibilizimi i banorëve lidhur me diversitetin e trashëgimisë kulturore ndotjen në zonë;*
- *Informimi dhe sensibilizimi i banorëve lidhur me ndotjen në zonë;*
- *Trajtimi i rasteve dhe vlerësimi i nevojave;*
- *Buxheti;*
- *Bashkëpunimi institucional (vendor dhe qendror);*
- *Masat për uljen e ndotjes;*
- *Kuadri ligjor;*
- *Çështje të lidhura me strategjinë dhe planin rajonal të zhvillimit të diversitetit të trashëgimisë kulturore.*

Institucionet vendore të përzgjedhura për këto intervista kanë qënë, specialistë të trashëgimisë kulturore dhe monumenteve të kulturës, specialistë

të mjedisit dhe shërbimeve sociale në institucionet vendore (bashki/komuna) si dhe specialistë të agjensisë rajonale kulturore e mjedisore. Këto institucione janë përzgjedhur, pasi janë në mënyrë direkte të lidhura me shërbimet ndaj banorëve. Në total janë realizuar 6 (gjashtë) intervista.

3.2 PËRZGJEDHJA E KAMPIONIT

Popullata e studimit janë të gjithë banorët e vendosur në zonat e monumenteve të trashëgimisë kulturore. Në mënyrë ideale studimi duhet të përfshinte të gjitha zonat e trashëgimisë kulturore dhe mjedisore pasi në këtë mënyrë do të kishte një gjithëpërfshirje të popullsisë banuese në këto zona. Por kampionimi që kemi zgjedhur na jep mundësinë të studiojmë një pjesë të caktuar të popullatës target dhe të mund të përftojme të dhëna përfaqësuese për tërësinë e saj.

Nisur nga tipologjia e studimit, metoda e kampionimit i referohet asaj probabilitare të grumbullimit/shtresëzimit (cluster), si një metodë shumë-fazëshe e cila lidhet me përzgjedhjen e njësive studimore në mënyrë progresive. Përmes kampionimit probabilitar, si një procedurë përmes të cilës përzgjedhja e pjesëmarrësve bazohet në parimin se çdo njësi e popullatës ka probabilitet të barabartë dhe të llogaritshëm për tu përfshirë në kampionim, është proceduar me ngushtimin e kampionit. Anketa është plotësuar nga rreth 145 të anketuar në të 145 vendet e monumenteve të kulturës të marrë në studim.

Procesi i kampionimit ka kaluar këto faza:

1. Fillimisht është përpiluar lista e monumenteve të trashëgimisë kulturore të përfshira në Qarkun e Elbasanit. Kjo është një listë relativisht e gjatë. Më pas u diferencuan, duke marrë 145 në studim, duke bërë një përzgjedhje të tyre.

2. Faza e dytë i referohet përzgjedhjes së zonave duke konsideruar këto kritere selektive: nivelin e mirë të ruajtjes së monumenteve, nivelit të monumenteve të kulturës sipas ndotjes (ajër, ujë, tokë), si rezultat i përqendrimit të industrisë së rëndë prodhuese aktive në këto zona si dhe relativisht një popullsi të lartë banuese. Sipas kësaj përzgjedhje janë veçuar katër qytete: Elbasani, Peqini, Cërriku dhe Librazhdi.

3. Faza e tretë me përzgjedhjen e zonave më afër burimeve ndotëse ku janë veçuar disa monumente në katër zonat e përmendura më lart (Elbasan, Peqin, Gramsh, Librazhd)

4. Faza e fundit i referohet përzgjedhjes probabilitare të pjesëmarrësve në studim përmes kampionimit të thjeshtë rastësor. Është përdorur përzgjedhja përmes mënyrës së trokitjes një në tre (1 në 3) shtëpi.

Instrumenti matës i kërkimit

Një anketim pilot me 3 pyetësorë është realizuar në mënyrë që të testoheshin të gjitha hapat e studimit. Nga rezultatet e këtij anketimi pilot autorja ka rishikuar edhe një herë pyetësorin e shpërndarë gjithashtu ka bërë të mundur të ndryshoj dhe planin e tabelave për t'u prodhuar.

Në pyetjet që kërkohej një mendim në lidhje me çështjet e shtruara u përdorën pyetjet me 4 shkallë si: Aspak, Pak, Mesatarisht dhe Shumë. Gjithashtu midis metodave të ndryshme të intervistimit u zgjodh metoda personale. Një interviste quhet personale kur kërkon përgjigje për pyetjet e drejtuara ballë për ballë me të intervistuarin.

Konfidencialiteti

Aspekti i konfidencialitetit statistikor i cili është cituar edhe në pyetësorin e drejtuar tek personat që u përzgjedhën për t'u anketuar, që nënkupton që autorja ka marrë të gjitha masat për mbrojtjen e të dhënave që lidhen me çdo person që është intervistuar, përgjigjet e të cilëve janë marrë direkt për qëllimet e kësaj teme dhe gjithashtu edhe përpunimi i të dhënave është realizuar në atë mënyrë të tillë që të mos të shkelë të drejtën e konfidencialitetit.

Në fillim të çdo pyetësori i anketuari mund të lexonte:

Ky pyetësor i drejtohet banoreve që jetojnë në zonat e monumenteve të trashëgimisë kulturore. Të gjithë të dhënat që do të merren nga ju do të përdoren vetëm për efekt studimor, dhe në do të ishim shumë të lumtur nëse do të na ndihmonit të jeni pjesë e këtij kërkimi me përgjigjet tuaja. Përgjigjet tuaja do të jenë tërësisht konfidenciale dhe do të agregohen me gjithë pyetësorët e tjerë dhe do të analizohen për publikim, në këtë mënyrë asnjë informacion individual nuk është i identifikueshëm. Ju lutem thjesht vendosni një "X" në alternativën që reflekton mendimin tuaj për secilën pyetje.

Ky paragraf i lejon të anketuarve të sigurohen se autorja do të parandalojë çdo përdorim jostatistikor të të dhënave të marra dhe zbulimin e personave të cilët janë përgjigjur pyetësorit të drejtuar nga autori. Të dhënat e përdorura nga autorja nuk mund që:

- Të identifikohen në mënyrë të drejtpërdrejtë - Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një person i intervistuar identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur nga të tjerët.

- Të identifikohen në mënyrë të tërthortë - Identifikimi i tërthortë është mundësia për të kuptuar identitetin e një të intervistuari duke kombinuar të dhënat që jepen në një tabelë.

3.3 KUFIZIMET E STUDIMIT

Kërkimi shkencor në përgjithësi ndeshet me vështirësi dhe problematika të ndryshme. Në studimin tonë janë ndeshur këto kufizime:

Së pari, mënyra e përzgjedhjes së pjesëmarrësve në studim. Kështu, një pjesë e madhe e tyre u përzgjedhën në bazë të kampionimit probabilitar duke u bazuar në parimin se çdo njësi e popullatës ka një probabilitet të barabartë për tu përfshirë në kampionim.

Së dyti, mënyra e përzgjedhjes së zonave në studim, duke përdorur disa kritere selektive që konsistojnë në nivelin më të lartë të ruajtjes së monumenteve të kulturës, nivelin të ndotjes dhe një sërë kriterësh të tjera. Kjo mënyrë përzgjedhjeje gjykoj që mund të ketë ndikuar në perceptimet e popullatës të marë në studim dhe në korrektësinë e përgjigjeve të dhëna.

Së treti, mënyra e organizimit të fokus grupeve nxorrën në pah qasjet e popullatës në një konstatim të përbashkët, duke mos lejuar interpretime dhe perceptime të tjera në lidhje me problematikën e studimit. Kështu, konstatimi i përbashkët i pjesëmarrësve në fokus grupe ishte në drejtim të domosdoshmërisë së punës vullnetare dhe përgjegjësisë qytetare për të parandaluar degradimin e objekteve dhe vlerave të trashëgimisë kulturore të Qarkut të Elbasanit.

Së katërti, mungesa e theksuar e informacionit që ka të bëjë me nivelin e informimit pr vullnetarizmin për ruajtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë kulturore. Shumica e pjesëmarrësve në studim kishin shumë pak informacion në lidhje me këtë çështje të rëndësishme që qëndron në funksion të ruajtjes së vlerave të trashëgimisë kulturore.

Së pesti, mbledhja e informacionit me anë të intervistave me specialistët e trashëgimisë kulturore në qark ishte i pamjaftueshëm pasi numri i pjesëmarrësve ishte mjaft i ulët. Në total, janë realizuar vetëm gjashtë intervista me specialistët e fushës. Nga ana tjetër, përgjigjet e dhëna nga ana e specialistëve kanë qënë tepër të gjata dhe herë pas here dilnin jashtë kontekstit të pyetjes së drejtuar nga studiuesja.

3.4 ANALIZA E TË DHËNAVE

Për përpunimin e të dhënave sasiore është përdorur programi kompjuterik SPSS, versioni 16.0¹³⁰. Për t'i shërbyer sa më mirë fokusit të studimit është përdorur analiza deskriptive si një teknikë që ndihmon në përshkrimin e përgjithshëm të të dhënave. Për të gjitha pyetjet e anketës janë raportuar frekuencat dhe përqindjet. Një pjesë e rëndësishme e pyetjeve u analizua përmes analizës përshkruese kryqëzuese crosstab¹³¹ dhe testit chi square¹³², duke krijuar mundësinë e një interpretimi më të madh për çështjet e adresuara përmes anketës midis variablave të ndryshëm. Në këtë studim është realizuar përpunimi i të dhënave edhe në funksion të qyteteve (zonave studimore), gjinisë, moshës, arsimit, punësimit, të ardhurave mujore, viteve të banimit në zonë dhe gjendjes civile.

Për analizën e të dhënave cilësore, të mbledhura nga intervistat e thelluara (cilësore) studimi ka analizuar në mënyrë të detajuar materialin e mbajtur shënim që korrespondon me çdo intervistë të realizuar apo materialin e marrë përmes e-mailit. Ajo çfarë favorizoi interpretimin e shpejtë, menjëherë pas përfundimit të secilës prej interviste ishte numri i vogël i të intervistuarve.


Referuar të dhënave cilësore të mbledhura nga intervistat ballë për ballë, këto të dhëna u përpunuan dhe u koduan sipas fjalëve kyç me interes për studimin duke evidentuar perceptimet dhe qëndrimet e specialistëve për secilën tematikë në fokus të studimit. Fillimisht shënimet për çdo intervistë u rilexuan me kujdes në mënyrë që të rikrijohej një skemë e strukturuar mbi to. Më pas përgjigjet u grupuan sipas çështjes që përmbante çdo pyetje dhe u kalua në analizën e materialit të shkruar ku u hartua një listë nënkodesh. Thëniet u evidentuan në fillim më vete sipas çështjes.

130 "A step by step guide to data analysis using SPSS 4th edition " Julie Pallant page: 14.

131 Procedura e **crosstabulimit** ju lejon të eksploronit relacionet normale midis dy variablave. Ajo procedure do t'ju tregojë në **output** një tabelë në të cilat pasqyrohen shpërndarjet e frekuencave të lidhura për dy variablat e zgjedhura për tu studiuar. E shoqëruar nga statistika gjithashtu ajo ju tregon nëse ka një lidhje statistikisht të rëndësishme midis dy variablave.

132 Ky test është një test statistikor i përdorur për të krahasuar të dhënat e vërtetuara me të dhënat e pritura për të përftuar rezultate sipas hipotezave specifike. **Burimi:** "A step by step guide to data analysis using SPSS 4th edition " Julie Pallant page: 65

Grafiku 1: Shpërndarja e të anketuarve sipas gjinisë




Në tabelën e mëposhtme është studiuar grupmosha kundrejt gjinisë për personat që janë përgjigjur pyetësorit. Bazuar në të dhënat e tabelës vihet re se **gjinia dominuese janë femrat**.

Tabela 1: Të intervistuar sipas grupmoshës dhe gjinisë

Mashkull		Gjinia		Total
		Femër		
Grupmosha	15-29 vjeç	26	27	53
	30-44 vjeç	33	43	76
	45-59 vjeç	8	6	14
	60 + vjeç	2	0	2
Total		69	76	145


Duke marrë parasysh **që zgjedhja e të anketuarve ka qenë rastësore, 76 persona** të anketuar janë të grupmoshës 30-44 vjeç. Kjo është grupmosha që ka më shumë **të anketuar** dhe shpërndarja femra meshkuj është sipas shpërndaja totale të të anketuarve. Interes të veçantë duke u nisur nga të dhënat e marra nga pyetësori paraqet dhe niveli arsimor i të anketuarve.

Grafiku 2: Shpërndarja e të anketuarve sipas nivelit arsimor




Sipas të dhënave të tabelës së mësipërme 0.7% e të anketuarve kanë deklaruar në pyetësor që nuk kanë kryer asnjë cikël studimi, bachelor kanë kryer 39.3% të të anketuarve, kurse pjesa tjetër 23.4% kanë kryer master profesional/shkencor.

Grafiku 3: Shpërndarja e të anketuarve sipas punësimit



Në grafikun e mësipërm jepen të anketuarit sipas punësimit pasi në pyetësor u është drejtuar pyetja: A.7: A punoni aktualisht? dhe nga të dhënat 63.4% kanë deklaruar se punojnë dhe 36.6% kanë deklaruar se nuk punojnë aktualisht.

Grafiku 4: Shpërndarja e të anketuarve sipas të ardhurave mujore



Në grafikun e mësipërm jepen të anketuarit sipas të ardhurave mujore pasi në pyetësor u është drejtuar pyetja: A.8 E ardhura mesatare mujore, nga të dhënat 68.3% kanë deklaruar se kanë të ardhura mujore 18001-35000 lekë të reja mujore dhe vetëm 1.4% e të anketuarëve kanë deklaruar se kanë të ardhura mujore më shumë se 87000 lekë të reja mujore.

Fokus grupet

Për të nxjerrë disa përfundime paraprake që të më jepnin mundësi për të bërë disa pyetje kërkimore dhe të përcaktoja hipotezën dhe rrugët e zgjidhjes bëra disa sondazhe dhe pyetsorë që përfshinë komunitetet e 145 objekteve të monumenteve të kulturës të paraqitur në shtojcën 2. E organizova këtë metodologji në dy fokus grupet dhe jam munduar që të mas opinionin dhe t'i përmbledhim rekomandimet e aktivistëve të shoqërisë civile dhe njohësve të tjerë të fushës së trashëgimisë dhe vullnetarizmit.

Ndonëse qasjet e njerëzve dallonin në pika të caktuara, megjithatë përfundimet e fokus grupeve nxjerrin në pah një fakt: substanca e diskutimeve dhe e përfundimeve mbetej gjithnjë e njëjtë. Konstatimi i përbashkët i pjesëmarrësve të fokus grupeve ishte në drejtim të domosdoshmërisë së punës vullnetare dhe përgjegjësisë qytetare për t'i ndaluar përmasat mjaft të rrezikshme që ka marrë degradimi i objekteve dhe vlerave të trashëgimisë kulturore të Qarkut të Elbasanit.


Diskutimet u fokusuan edhe në mënyrat e promovimit dhe përhapjes së punës vullnetare tek grupet e gjera shoqërore, me çka do të barteshin përvojat

individuale vullnetare në veprime grupore. Por vullnetarizmi në Elbasan, sipas pjesëmarrësve të fokus grupeve, është konsiderueshëm i përhapur në fusha të caktuara, e ndër ta në ndihmë humanitare, ndihmë personave me aftësi të kufizuara, dhurim të gjakut, pastrim dhe disa sfera tjera. Megjithatë, sikurse dëshmojnë edhe rezultatet e anketës me qytetarë, aktivitetet vullnetare nuk janë të përhapura sa duhet në fushën e kulturës, e sidomos në trashëgimi kulturore. Marrë parasysh specifikat e qytetit, pjesëmarrësit e fokus grupeve konkluduan se Elbasani, më shumë se në çdo fushë tjetër, ka nevojë për punë vullnetare në mbrojtjen dhe ruajtjen e objekteve dhe monumenteve të trashëgimisë kulturore.

3.5 REZULTATE TË ANKETËS PËR KONTRIBUTIN E VULLNETARIZMIT

Po të analizohen disa nga rezultatet e anketës, vërejmë një disponim të përgjithshëm pro punës vullnetare në fushën e trashëgimisë kulturore dhe përfitimeve që sjell mobilizimi i resurseve kulturore për zhvillimin e ekonomisë lokale. Shihet qartë se qytetarët e Elbasanit kanë bindje mjaft pozitive për nevojën dhe domosdoshmërinë e punës vullnetare për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, por paradoksalisht, të pyetur për involvimin e tyre direkt, ata tregojnë se nuk janë edhe aq aktivisht të angazhuar në punë dhe aktivitete vullnetare në këtë fushë¹³³.


Grafiku 5: Sa mund të kontribuojë vullnetarizmi në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore?



¹³³ Mbeshtetur tek analiza e te dhenave në perfundim te anketes.


Qytetarët e anketuar e vlerësojnë vullnetarizmin si një mjet të dobishëm në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Mbi 74.5% prej tyre mendojnë se vullnetarizmi kontribuon mesatarisht ose shumë në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

Grafiku 6: A ka iniciativa vullnetare në komunitetin tuaj për mbrojtje të trashëgimisë kulturore?




Edhe pse puna vullnetare vlerësohet si shumë e dobishme për mbrojtje të trashëgimisë kulturore, iniciativat e tilla në Elbasan janë të pakta. Shumica e qytetarëve të Elbasanit nuk kanë informata për iniciativa të tilla, gjë që tregon për mungesën e angazhimit qytetar për mbrojtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore, ose në rastin më të mirë për mungesën e promovimit të kësaj pune në rrethin e gjerë të qytetit.

Grafiku 7: A jeni pjesë e këtyre iniciativave?




Mungesa e iniciativave vullnetare nuk është për tu habitur kur shikohet angazhimi i respondentëve në iniciativa të tilla. Vetëm 18.6 % prej tyre kontribuojnë vullnetarisht gjithmonë ose shpesh në mbrojtje të trashëgimisë kulturore. Ky paradoks dhe kjo diferencë në mes të bindjes dhe angazhimit paraqet një ndër shkaqet themelore për përpjekjet e shoqërisë civile për të promovuar punën vullnetare në fushën e trashëgimisë kulturore dhe për t'i ofruar si qytetarëve ashtu edhe vendimmarrësve alternativa të duhura politike.

Grafiku 8: A pajtoheni me qëndrimin se vullnetarizmi në trashëgimi kulturore mund të prodhojë zhvillim ekonomik për qytetin?




Me konstatimin se vullnetarizmi në trashëgimi kulturore mund të prodhojë zhvillim ekonomik për qytetin nuk janë pajtuar vetëm 2.1 % e qytetarëve të anketuar, ndërsa më shumë se gjysma e tyre plotësisht pajtohen me këtë konstatim. Edhe pse kjo pyetje i'u është bërë qytetarëve të rastësishëm, shumica nga të cilët nuk janë pjesë e iniciativave vullnetare për trashëgimi (shih rezultatet e pyetjes 3), vërehet se shumica dërmuese e tyre të paktën e shohin këtë fushë me potencial ekonomik. Edhe pse i pamjaftueshm, ky nivel i vetëdijes mund të shërbejë si një bazë e mirë për ngritjen e iniciativave të ndryshme institucionale dhe civile për materializimin.

Grafiku 9: Në çfarë objektsh të trashëgimisë kulturore keni kontribuar me veprimtari vullnetare kohëve të fundit?




Edhe në rastet kur qytetarët vlerësojnë se kanë kontribuar në ndonjë aktivitetet vullnetar në mbrojtje të trashëgimisë kulturore, shumica e këtij aktiviteti kufizohet në pjesë shumë personale të tyre. Më shumë se gjysma janë angazhuar në punë vullnetare në shtëpitë dhe objektet e tyre fetare. Objektet “publike” të trashëgimisë kulturore kanë përfituar nga aktiviteti vullnetar i qytetarëve vetëm në më pak se 27% të rasteve, gjë që në njëfarë mase e arsyeton shkallën e ultët të njohurisë së qytetarëve për iniciativat ekzistuese. Gjithashtu vërehet edhe kufizimi i këtij aktiviteti vetëm në objektet më të njohura të qytetit, duke lënë anash një numër shumë të madh të objekteve të tjera të trashëgimisë kulturore të cilat nuk janë shumë të ekspozuara në publikun e gjerë. Kjo e dhënë e bën shqetësuese situatën e promovimit të objekteve të trashëgimisë kulturore në qarkun e Elbasanit, duke filluar nga mungesa e shenjëzimit të këtyre objekteve e deri te përkujdesja institucionale dhe qytetare ndaj tyre.

Grafiku 10: Në çfarë vlerash të trashëgimisë kulturore keni kontribuar me veprimtari vullnetare kohëve të fundit?



Përveç objekteve, trashëgimia kulturore e Elbasanit është e pasur edhe me vlera tjera. Qytetarët e qarkut duket se më së shumti angazhohen për ruajtjen dhe kultivimin e muzikës, si vlerë e traditës qytetare. Edhe pse nuk janë bërë matje të opinionit publik, festivali i muzikës së vjetër qytetare elbasanase dhe publiciteti që ka në mbarë vendin, por edhe në Kosovë e te shqiptarët e Maqedonisë, mund të jetë një ndër arsytet e këtij angazhimi më të madh, në krahasim me vlerat tjera të trashëgimisë kulturore.

Grafiku 11: A pajtoheni me qëndrimin se vullnetarizmi në trashëgimi kulturore mund të prodhojë zhvillim ekonomik për qytetin?




Me konstatimin se vullnetarizmi në trashëgimi kulturore mund të prodhojë zhvillim ekonomik për qytetin nuk janë pajtuar vetëm 2% e qytetarëve të

anketuar, ndërsa më shumë se gjysma e tyre plotësisht pajtohen me këtë konstatim.

Edhe pse kjo pyetje i'u është bërë qytetarëve të rastësishëm, shumica nga të cilët nuk janë pjesë e iniciativave vullnetare për trashëgimi (shih rezultatet e pyetjes 3), vërehet se shumica dërmuese e tyre të paktën e shohin këtë fushë me potencial ekonomik.

Edhe pse i pamjaftueshëm, ky nivel i vetëdijes mund të shërbejë si një bazë e mirë për ngritjen e iniciativave të ndryshme institucionale dhe civile për materializimin e vlerave të trashëguara dhe punës vullnetare.

Grafiku 12: Renditni sipas përgjegjësisë (1-5) aktorët e mëposhtem që kanë rol në nxitjen e vullnetarizmit në mbrojtje të trashëgimisë kulturore?




Kur bëhet fjalë për rolin e institucioneve/sectorëve të caktuar në nxitjen e vullnetarizmit në mbrojtje të trashëgimisë kulturore, qytetarët mendojnë që shoqëria civile është ajo që duhet të jetë prijëse e këtij procesi me afërsisht 46.2 % e të anketuarve. Lidhja e vullnetarizmit (jo vetëm në këtë fushë) me shoqërinë civile rezulton jo e befasishme, për shkak të perceptimit të përgjithshëm që puna vullnetare dhe shoqëria civile janë dy pjesë të asociuara në mes vete.

Komuna rezulton segmenti i dytë (22.2%) që ka përgjegjësi për të nxitur vullnetarizmin në trashëgimi kulturore, përkundër përgjegjësi dhe kompetencave që gëzon. Pas qeverisë, e cila renditet e treta me 16.6%, bizneset(12.4%) janë vlerësuar që kanë më së paku përgjegjësi në nxitjen e punës vullnetare për trashëgimi kulturore.

Ky vlerësim bie ndesh me vlerësimin se vullnetarizmi në trashëgimi kulturore mund të prodhojë zhvillim ekonomik për qytetin (shih rezultatet e pyetjes 6), për shkak që në rast të një zhvillimi të tillë bizneset do të ishin ato

që do të përfitonin më së shumti. Kjo, në logjikën e shëndoshë, duhet t'i nxisë bizneset që të jenë ndër iniciatorët kryesorë të promovimit të punës vullnetare në trashëgimi kulturore.

Grafiku 13: Cilët janë faktorët nxitës për ju, që të angazhoheni për punë vullnetare për trashëgiminë kulturore?



Duke qenë në përputhje me vlerësimin e pyetjes së kaluar, iniciativat nga OJQ-të (52.4%) rezultojnë të jenë faktorët kryesorë nxitës për angazhimin e qytetarëve në punë vullnetare për trashëgimi kulturore. Kjo edhe është dëshmuar përgjatë viteve të fundit si e vërtetë në praktikë, në raste të ndryshme të aktiviteteve të organizuara nga OJQ të ndryshme.

Përkundër vlerësimit të përgjithshëm për degradimin e trashëgimisë kulturore të qarkut të Elbasanit, kjo shërben si nxitje për angazhim vullnetar vetëm te një pjesë shumë e vogël e qytetarëve. Indiferenca e përgjithshme politike dhe sociale e popullsisë duket se është reflektuar edhe në këtë segment, përkundër traditës dhe frymës qytetare të aktivizmit në komunitet të qytetarëve elbasanas gjatë të kaluarës.


Njohja zyrtare e punës vullnetare, sikurse është vlerësuar me raporte të shumta edhe në fusha tjera, është faktor mjaft i rëndësishëm në nxitjen e qytetarëve për angazhim vullnetar edhe në trashëgimi kulturore.

Tabela 2: Si e kuptoni termin “Vullnetarizëm”?

	Frekuenca	Përqindja	Përqindja e vlefshme	Përqindja Kumulative
Obligim	15	10.3	10.3	10.3
Punë me kompensim	5	3.4	3.4	13.8
Punë pa kompensim	46	31.7	31.7	45.5
Hobi	26	17.9	17.9	63.4
Kohë e lirë	31	21.4	21.4	84.8
Ndjenjë e përkatësisë	20	13.8	13.8	98.6
Tjetër Specifiko	2	1.4	1.4	100.0
Total	145	100.0	100.0	


Rreth 1/3 e tyre e kuptojnë si një punë pa kompensim, ndërsa një pjesë tjetër e konsiderueshme si kohë të lirë (21.4%) dhe hobi (17.9%). Këto të dhëna tregojnë një situatë jo shumë inkurajuese për vullnetarizmin në përgjithësi, duke e ulur qysh në fillim vet konceptin e punës vullnetare për çështje të caktuara të interesit të përgjithshëm dhe duke e zhvendosur rëndësinë e saj poshtë prioriteteve të qytetarëve të Elbasanit. Megjithatë, një pjesë e tyre vullnetarizmin e kuptojnë në një rrafsh më të gjërë, duke e përshkruar si “ndjenjë të përkatësisë” (13.8%) dhe “obligim” (10.3%).

Grafiku 14: Sa jeni vullnetarë, si qytetarë të Elbasanit?




Qytetarët e Qarkut të Elbasanit mendojnë se 64.1% e të anketuarve janë pak vullnetarë dhe vetëm 2 persona mendojnë se qytetarët janë shumë vullnetarë.

Grafiku 15: A është trashëgimia kulturore prioritet në raport me çështjet e tjera që e preokupojnë Elbasanin?




Duke qenë në vijë me epitetet e ndryshme të qytetit të Elbasanit për vjetërsinë dhe traditën e tij, qytetarët e vlerësojnë trashëgiminë kulturore si prioritet të qytetit (71 %).

Grafiku 16: Sa e njihni trashëgimie kulturore të qytetit?




Njohja e trashëgimisë kulturore të qytetit nga vet qytetarët e Elbasanit konsiderohet e mirë. Shumica prej tyre (77.9%) mendojnë që i njohin mesatarisht ose shumë objektet dhe vlerat e trashëgimisë kulturore në qytet. Nëse angazhimi i tyre për mbrojtjen e këtyre vlerave mund të merret si një matës i kualitetit të njohjes së tyre, atëherë kjo njohje e relativizon rëndësinë e saj, duke mos i përkthyer informatat dhe dijen për to në angazhim për ruajtjen dhe promovimin e tyre.

Grafiku 17: Cilat kategori moshash duhet të angazhohen në vullnetarizëm për trashëgimime kulturore?



Rinia zë vendin kryesor në punën vullnetare për trashëgimi kulturore (71.7%), sipas qytetarëve të Elbasanit, e përcjellë menjëherë nga mosha e mesme. Përkundër rëndësisë së pakontestueshme të angazhimit të rinisë në këtë fushë, duke pasur parasysh edhe përqindjen e madhe të tyre në popullsinë e përgjithshme, vlerësimi shumë i ulët për angazhimin e moshës së tretë në trashëgimi kulturore (vetëm 2,8%) e bën njohurinë dhe përvojën e kësaj shtrese të popullsisë të pashfrytëzuar sa duhet.


Grafiku 18: Sa paraqet pengesë papunësia dhe gjendja ekonomike në angazhimin tuaj vullnetar?




Papunësia dhe gjendja e vështirë ekonomike paraqesin pengesë të madhe në angazhimin vullnetar të qytetarëve. Ky vlerësim bie ndesh me disa nga vlerësimet e tjera të po të njëjtëve qytetarë. Nëse vullnetarizmi në trashëgimi

kulturore paraqet potencial për zhvillim ekonomik; nëse koha e lirë përbën një pjesë domethënëse për angazhim në punë vullnetare dhe nëse trashëgimia kulturore paraqet një prioritet të lartë për qytetin e Elbasanit, atëherë logjika e shëndoshë do të na jepte rezultate të kundërta. Puna vullnetare do të duhej të shihej si një mjet shumë efikas në zvogëlimin e papunësisë dhe përmirësimin e gjendjes ekonomike të qytetarëve.

Grafiku 19: A ekziston (funksionon) ndonjë grup i vullnetarëve në qytetin e Elbasanit?



Grafiku 20: Sa është e nevojshme që Elbasani të ketë grupe të vullnetarëve rreth çështjeve të ndryshme?



Përfundimisht, rëndësia e punës vullnetare në qytetin e Elbasanit vlerësohet e lartë. Mbi 87% të qytetarëve të anketuar mendojnë që Elbasani ka nevojë të madhe për grupe të vullnetarëve rreth çështjeve të ndryshme. Kjo nevojë, duke u kombinuar me hapësirën e madhe për përmirësim të gjendjes jo vetëm në trashëgimi kulturore, është një element shtesë për angazhimin e

të gjithë faktorëve relevantë në promovimin e punës vullnetare për të mirën e komunitetit në përgjithësi.

Konkluzione

Mbështetur në grafikët e mësipërm nxjerrim këtë përfundim se: Të gjithë vullnetarët që kanë dëshirë të angazhohen në projekte të tilla, si p.sh, për përkrahje e promovim të diversitetit kulturor të qarkut të Elbasanit, duhet të kenë si synim transformimin progresiv të shoqërisë përmes demokracisë pjesëmarrëse, duke shfrytëzuar trashëgiminë si një vlerë të përbashkët. Por në këtë definicion lind pyetja se si duhet të realizohet ky synim? Të dhënat e këtij studimi na çojnë drejt gjetjeve kryesore dhe rrugët për realizimin e tyre:

- a) Natyralizimi me konceptin e Ruajtjes së Integruar të Trashëgimisë Kulturore;
- b) Hartimi i Strategjisë së Zhvillimit Rajonal të Trashëgimisë Rajonale;
- c) Krijimi i një “Plani për Diversitetin e Trashëgimisë Kulturore në Qarkun e Elbasanit”.

Sipas të dhënave të tabelave të mësipërme, të gjitha moshat e pranojnë rëndësinë e trashëgimisë në njëfarë niveli. Mbi 90% të qytetarëve të anketuar mendojnë që Elbasani ka nevojë të madhe për grupe të vullnetarëve rreth çështjeve të ndryshme. Kjo nevojë, duke u kombinuar me hapësirën e madhe për përmirësim të gjendjes jo vetëm në trashëgimi kulturore, është një element shtesë për angazhimin e të gjithë faktorëve relevantë në promovimin e punës vullnetare për të mirën e komunitetit në përgjithësi.

Por, njohja e rëndësisë së trashëgimisë nuk nënkupton gjithmonë vlerësimin dhe të kuptuarin e trashëgimisë. Sepse ka ndodhur dhe ndodh rëndomtë, që trashëgimia i është nënshtruar shkatërrimit, ndonjëherë me vetëdije, për arsye të ndërlikuara, ose pa vetëdije, duke e lënë të shkatërrohet, shpërbëhet dhe zhduket.

Njohja e vlerës së trashëgimisë së shumëllojshme, nderimi dhe vendosja e saj në vendin e duhur në histori, është një proces sfidues por edhe ngazëllues, nëse menaxhohet si duhet.

Duke gjykuar se “Plani Rajonal për Diversitetin e Trashëgimisë Kulturore” është gjetja kryesore në këtë disertacion, dua të nxjerr njëherazi në pah se si ai duhet të theksoj thelbin e trashëgimisë në zemër të jetës së komunitetit, duke ofruar një pasqyrë të trashëgimisë së rajonit, duke prezantuar idenë e

trashëgimisë dhe një plan për trashëgiminë. Më tutje, siç do të lexoni në kreun pas-ardhës, ai pasqyron ndryshimin në qendrimet dhe qasjet e aktorëve lokal si rezultat i procesit, thekson konsideratat strategjike në procesin e zhvillimit dhe vendos objektivat për veprimet e tyre të ndërlidhura e të arritshme.

Një aspekt tjetër i gjetjeve të nxjerra nga analiza e situatës në qarkun e Elbasanit, por edhe nga të dhënat e literaturës¹³⁴ për këto tipe projektesh¹³⁵ është se ai thekson:

Lidhjen organike në mes të trashëgimisë dhe diversitetit duke minimizuar dallimin në mes trashëgimisë kulturore materiale dhe jo materiale dhe trashëgimisë natyrore përmes një qasje të tërësishme, pjesëmarrëse dhe të integruar ku të gjitha komunitetet kanë zërin dhe vendin e tyre. Ai gjithashtu nxit përfshirjen e arteve bashkëkohore si një formë e shprehjes së trashëgimisë, diversitetit dhe identiteteve të shumëfishta të rajonit. Kjo është thelbësore për përfshirjen sociale dhe zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm.

3.6 ANALIZAT E PAVARËSISË PËR VARIABLAT NË STUDIM

Analiza e pavarësisë për gjininë

Në këtë seksion do të analizojmë pavarësinë midis variablave në studim me qëllimin e vërtetimit apo hedhjes poshtë të hipotezave. Do të analizojmë të dhënat e studimit nëse ka ndonjë lidhje midis gjinisë së personit që është intervistuar dhe sjelljes së tij ndaj vullnetarizmit. Variabli, gjinia është një variabël i tipit kategorik. Ajo merr dy vlera:

- 1- Mashkull
- 2- Femër

Ndërsa variabli i cili lidhet me konceptin se si kuptohet termi “Vullnetarizëm” merr shtatë vlera:

1. Obligim
2. Punë me kompensim
3. Punë pa kompensim
4. Hobi
5. Kohë e lirë

¹³⁴ Ky plan mbështetur në Projektin e Bashkimit Evropian/Këshillit të Evropës ku “Përkrahja për Promovimin e Diversitetit Kulturor “ka qenë risi-prurës në angazhimin e komuniteteve lokale me trashëgiminë e tyre, teksa ka zhvilluar metodat dhe programet e përshtatshme lokale, duke u bazuar në standardet e miratuara.

¹³⁵ Projekti Pilot për Zhvillim Lokal (PPZHL) të Programit Rajonal të Këshillit të Evropës për Trashëgimi Kulturor dhe Natyror në Evropën Juglindore.

6. Ndjenjë e përkatësisë
7. Tjetër /Specifiko

Të dy variablat në shqyrtim (gjinia dhe vullnetarizmi) janë të tipit kategorik. Për të realizuar analizën se cila do të përcaktojë nëse ka ndonjë lidhje midis tyre do të përdoret testi Hi-katror(Chi-Square)¹³⁶ me një nivel gabimi 5%. Testi Hi-katror i cili është një test statistikor për pavarësinë e variablave me njëri tjetrin mund të realizohet nëse plotësohen këto kushte:

- Variabla që do të studiohen të jenë në shkallë matje kategorike (gjinia dhe vullnetarizmi).
- Të kenë të paktën 2 kategori (vullnetarizmi ka 7 kategori dhe gjinia ka 2)
- Një njësi studimi (individët e pyetur) për një pyetje të klasifikohet vetëm në një kategori


Të dhënat që në po studiojmë i përmbushin kriteret e mësipërme. Hipotezat që studimi ngre janë:

H_0 : Nuk ka një lidhje midis gjinisë dhe përcaktimit të termit të vullnetarizmit.

H_1 : Ka një lidhje midis gjinisë dhe përcaktimit të termit të vullnetarizmit.

Analiza dhe hipotezat do të bëhen për variablin gjinia me pyetjen “Si kuptohet termi “Vullnetarizëm “dhe gjithashtu edhe me pyetjen “Sa jeni vullnetarë, si qytetarë të Qarkut të Elbasanit?” veç e veç.

Grafiku 21: Vullnetarizimi dhe Gjinia



¹³⁶ Ky test është një test statistikor i përdorur për të krahasuar të dhënat e vrojtueshme me të dhënat e pritura për të përftuar rezultate sipas hipotezave specifike. **Burimi:** “A step by step guide to data analysis using SPSS 4th edition “ Julie Pallant page: 65

Rezultatet në përqindje tregojnë se termin vullnetarizëm si punë pa kompensim e përcaktojnë 42.1% e femrave të intervistuar, ndërsa meshkujt janë rreth 20.3%. Kjo analizë e thjeshtë përshkruese duket sikur tregon një lidhje se mund të ketë diferenca në përcaktimin e termit vullnetarizëm. Le ta shohim nëse kjo diferencë është statistikisht e rëndësishme. Për këtë do të aplikojmë testin e sipërpërmendur Hi-Katror¹³⁷.

Tabela 3: Testi Hi-Katror

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Vlera e testit Chi-Square	10.830(a)	6	.004<5%
Numri i individëve të pyetur	145		

Testi tregon se midis variablave në shqyrtim ekziston një lidhje. Pra mund të konkludojmë se ka një lidhje statistikore të rëndësishme midis gjinisë dhe përcaktimit të termit vullnetarizëm.

Analiza se sa janë vullnetarë, si qytetarë të Qarkut të Elbasanit

Sipas të dhënave janë analizuar 145 individë të gjinive të ndryshme. Nuk ka asnjë vlerë që mungon për secilin nga variablat.

Tabela 4: Sa jeni vullnetarë dhe Gjinia

Mashkull		Gjinia		Total
		Femër		
Sa jeni vullnetarë, si qytetarë të Qarkut të Elbasanit?	Aspak	17	16	33
	Pak	43	50	93
	Mesatarisht	7	10	17
	Shumë	2	0	2
Total		69	76	145

Rezultatet tregojnë se nga 69 meshkujt që janë marrë në intervistim 17 prej tyre janë shprehur se qytetarët e Elbasanit nuk janë aspak vullnetarë, ndërsa nga 76 ferat e intervistuar 16 prej tyre janë shprehur se qytetarët e Elbasanit nuk janë aspak vullnetarë. Po ti konvertojmë rezultatet në përqindje tregojnë se për femrat qytetarët e Elbasanit janë pak vullnetarë, afërsisht 65.8% ndërsa meshkujt janë rreth 62.3%. Kjo analizë e thjeshtë përshkruese duket sikur nuk tregon një lidhje se mund të ketë diferenca në përcaktimin e përgjithshëm për

¹³⁷ Ky test është një test statistikor I përdorur për të krahasuar të dhënat e vrojtuar me të dhënat e pritura për të përftuar rezultate sipas hipotezave specifike. **Burimi:** “A step by step guide to data analysis using SPSS 4th edition “ Julie Pallant page: 65

vullnetarizëm. Le ta shohim nëse kjo diferencë është statistikisht e rëndësishme. Për këtë do të aplikojmë testin e sipërpërmendur Hi-Katror.

Tabela 5: Testi Hi-Katror

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Vlera e testit Chi-Square	2.755(a)	3	.431>5%
Numri i individëve të pyetur	145		

Testi tregon se midis variablave në shqyrtim nuk ekziston një lidhje. Përmund të konkludojmë se nuk ka një lidhje statistikore të rëndësishme midis gjinisë dhe perceptimit sa janë vullnetarë, si qytetarë personat që jetojnë në Qarkun e Elbasanit.

Analiza e pavarësisë për Grupmoshën

Në analizën që do të bëjmë me të dhënat e studimit në do të studiojmë nëse ka ndonjë lidhje midis grupmoshës së personit që është intervistuar dhe sjelljes së tij ndaj vullnetarizmit. Variabli grupmosha është një variabël i tipit kategorik. Ai merr 4 vlera:

- 1- 15-29 vjeç
- 2- 30-44 vjeç
- 3- 45-59 vjeç
- 4- 60 vjeç +

Ndërsa variabli i cili lidhet me konceptin se si kuptohet termi “Vullnetarizëm” merr shtatë vlera si më sipër.

Të dy variablat në shqyrtim (grupmosha dhe vullnetarizmi) janë të tipit kategorik. Për të realizuar analizën e cila do të përcaktojë nëse ka ndonjë lidhje midis tyre do të përdoret testi Hi-katror (Chi-Square) me një nivel gabimi 5%. Testi Hi-katror i cili është një test statistikor për pavarësinë e variablave me njëri tjetrin mund të realizohet nëse plotësohen këto kushte:

- Variabla që do të studiohen të jenë në shkallë matje kategorike (grupmosha dhe vullnetarizmi).
- Të kenë të paktën 2 kategori (vullnetarizmi ka 7 kategori dhe grupmosha ka 4).
- Një njësi studimi (individët e pyetur) për një pyetje të klasifikohet vetëm në një kategori.

Të dhënat që në po studiojmë i përmbushin kriteret e mësipërme. Hipotezat që studimi ngre janë:


H_0 : Nuk ka një lidhje midis grupmoshës dhe përcaktimit të termit të vullnetarizmit.

H_1 : Ka një lidhje midis grupmoshës dhe përcaktimit të termit të vullnetarizmit.

Analiza dhe hipotezat do të bëhen për variablin grupmosha me pyetjen “Si kuptohet termi “Vullnetarizëm” dhe gjithashtu edhe me pyetjen “Sa jeni vullnetarë, si qytetarë të Qarkut të Elbasanit?” veç e veç. Për të analizuar këtë hipotezë shikojmë tabelën e cila tregon lidhjen midis grupmoshës dhe përcaktimit të termit të vullnetarizmit. Sipas të dhënave janë analizuar 145 individë të grupmoshave të ndryshme. Nuk ka asnjë vlerë që mungon për secilin nga variablat.

Rezultatet tregojnë se nga 53 personat e pyetur në grup moshën 15-29 vjeç, 6 prej tyre e përcaktojnë termin vullnetarizmit si obligim, ndërsa në grup moshën 45-59 vjeç nga 14 personat e anketuar 2 prej tyre e konsiderojnë termin si obligim.

Grafiku 22: Si e kuptoni termin “Vullnetarizëm” sipas grupmoshës



Rezultatet në përqindje tregojnë se të gjithë individët 60+ e shohin termin vullnetarizëm si obligim ndërsa mosha 30-44 vjeç e përcaktojnë rreth 6.6% e personave të intervistuar. Kjo analizë e thjeshtë përshkruese duket sikur tregon një lidhje se mund të ketë diferenca në përcaktimin e termit vullnetarizëm. Le ta shohim nëse kjo diferencë është statistikisht e rëndësishme. Për këtë do të aplikojmë testin e sipërpërmendur Hi-Katror.

Tabela 6: Testi Hi-Katror

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Vlera e testit Chi-Square	27.796(a)	18	.045<0.05
Numri i individëve të pyetur	145		

Testi tregon se midis variablave në shqyrtim ekziston një lidhje. Pra mund të konkludojmë se ka një lidhje statistikore të rëndësishme midis grupmoshës dhe përcaktimit të termit vullnetarizëm.

Analiza se sa janë vullnetarë, si qytetarë të Qarkut të Elbasanit

H_0 : Nuk ka një lidhje midis grupmoshës dhe vullnetarizmit.

H_1 : Ka një lidhje midis grupmoshës dhe vullnetarizmit.


Për të analizuar këtë hipotezë shikojmë tabelën e cila tregon lidhjen midis grupmoshës se sa janë vullnetarë, si qytetarë të Qarkut të Elbasanit. Sipas të dhënave janë analizuar 145 individë të grupmoshave të ndryshme. Nuk ka asnjë vlerë që mungon për secilin nga variablat.

Tabela 7: Grupmosha dhe vullnetarizimi

		Sa jeni vullnetarë, si qytetarë të Qarkut të Elbasanit?				Total
		Pak	Mesatarisht	Shumë		
Grupmosha	15-29 vjeç	17	29	7	0	53
	30-44 vjeç	16	52	7	1	76
	45-59 vjeç	0	10	3	1	14
	60 + vjeç	0	2	0	0	2
Total		33	93	17	2	145

Rezultatet tregojnë se nga 76 personat e pyetur të grupmoshës 30-44 vjeç, 16 prej tyre mendojnë se qytetarët e Elbasanit nuk janë aspak vullnetarë, ndërsa nga personat e pyetur të grupmoshës 15-29 vjeç, 17 prej tyre e përcaktojnë se qytetarët e Elbasanit nuk janë aspak vullnetarë.

Grafiku 23: Sa jeni vullnetarë, si qytetarë të Qarkut të Elbasanit sipas grupmoshës



Rezultatet në përqindje tregojnë se 68.4% e personave të pyetur në moshën 30-44 vjeç mendojnë se qytetarët e Elbasanit janë pak vullnetarë, afërsisht 71.4% e personave 45-59 vjeç mendojnë këtë fakt. Kjo analizë e thjeshtë përshkruese duket sikur nuk tregon një lidhje se mund të ketë diferenca në përcaktimin e përgjithshëm për vullnetarizëm. Le ta shohim nëse kjo diferencë është statistikisht e rëndësishme. Për këtë do të aplikojmë testin e sipërpërmendur Hi-Katror.

Tabela 8: Testi Hi-Katror

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
	13.229(a)	9	.153>5%
Vlera e testit Chi-Square	145		

Testi tregon se midis variablave në shqyrtim nuk ekziston një lidhje. Pra mund të konkludojmë se nuk ka një lidhje statistikore të rëndësishme midis grupmoshës dhe perceptimit sa janë vullnetarë, si qytetarë personat që jetojnë në Qarkun e Elbasanit.

Analiza e pavarësisë për Vendbanimin

Në analizën që do të bëjmë me të dhënat e studimit në do të studiojmë nëse ka ndonjë lidhje midis vendbanimit të personit që është intervistuar dhe sjelljes së tij ndaj vullnetarizmit. Variabli vendbanimi është një variabël i tipit kategorik. Ai merr 2 vlera:

1- Urbane

2- Rurale

Ndërsa variabli i cili lidhet me konceptin se si kuptohet termi “Vullnetarizëm” merr shtatë vlera si më sipër.

Të dy variablat në shqyrtim (vendbanimi dhe vullnetarizmi) janë të tipit kategorik. Për të realizuar analizën e cila do të përcaktojë nëse ka ndonjë lidhje midis tyre do të përdoret testi Hi-katror (Chi-Square) me një nivel gabimi 5%. Testi Hi-katror i cili është një test statistikor për pavarësinë e variablave me njëri tjetrin mund të realizohet nëse plotësohen këto kushte:

- Variabla që do të studiohen të jenë në shkallë matje kategorike (vendbanimi dhe vullnetarizmi).
- Të kenë të paktën 2 kategori (vullnetarizmi ka 7 kategori dhe vendbanimi ka 2).
- Një njësi studimi (individët e pyetur) për një pyetje të klasifikohet vetëm në një kategori.

Të dhënat që në po studiojmë i përmbushin kriteret e mësipërme. Hipotezat që studimi ngre janë:

H_0 : Nuk ka një lidhje midis vendbanimit dhe përcaktimit të termit të vullnetarizmit.

H_1 : Ka një lidhje midis vendbanimit dhe përcaktimit të termit të vullnetarizmit.

Analiza dhe hipotezat do të bëhen për variablin vendbanimi me pyetjen “Si kuptohet termin “Vullnetarizëm” dhe gjithashtu edhe me pyetjen “Sa jeni vullnetarë, si qytetarë të Qarkut të Elbasanit?” veç e veç.

Analiza se si kuptohet termin “Vullnetarizëm”

H_0 : Nuk ka një lidhje midis vendbanimit dhe përcaktimit të termit të vullnetarizmit.

H_1 : Ka një lidhje midis vendbanimit dhe përcaktimit të termit të vullnetarizmit.


Për të analizuar këtë hipotezë shikojmë tabelën e cila tregon lidhjen midis vendbanimit dhe përcaktimit të termit të vullnetarizmit. Sipas të dhënave janë analizuar 145 individë të vendbanimeve të ndryshme. Nuk ka asnjë vlerë që mungon për secilin nga variablat.

Tabela 9: Vullnetarizëm dhe vendbanimi

Urbane		Zona ku jetoni		Total
		Rurale		
Si e kuptoni termin “Vullnetarizëm”?	Obligim	13	2	15
	Punë me kompesim	5	0	5
	Punë pa kompesim	38	8	46
	Hobi	15	11	26
	Kohë e lirë	28	3	31
	Ndjenjë e përkatësisë	20	0	20
	Tjetër Specifiko	2	0	2
Total		121	24	145

Rezultatet tregojnë se nga 121 personat e pyetur në zonat urbane, 13 prej tyre e përcaktojnë termin vullnetarizëm si obligim, ndërsa nga 24 personat e anketuar 2 prej tyre e konsiderojnë termin si obligim.

Grafiku 24: Si e kuptoni termin “Vullnetarizëm” sipas vendbanimit



Rezultatet në përqindje tregojnë se 45.8% në të gjithë zonat rurale e shohin termin vullnetarizëm si hobi ndërsa në zonat urbane e përcaktojnë si hobi tërësisht 12.4% e personave të intervistuar. Kjo analizë e thjeshtë përshkruese duket sikur tregon një lidhje se mund të ketë diferencë në përcaktimin e termin vullnetarizëm. Le ta shohim nëse kjo diferencë është statistikisht e rëndësishme. Për këtë do të aplikojmë testin e sipërpërmendur Hi-Katror.

Tabela 10: Testi Hi-Katror

	Value	Df	Asymp. Sig. (2-sided)
Vlera e testit Chi-Square	19.039(a)	6	.004<0.05
Numri i individëve të pyetur	145		

Testi tregon se midis variablave në shqyrtim ekziston një lidhje. Pra mund të konkludojmë se ka një lidhje statistikore të rëndësishme midis vendbanimit dhe përcaktimit të termit vullnetarizëm.

❖ **Analiza se sa janë vullnetarë, si qytetarë të Qarkut të Elbasanit**

H_0 : Nuk ka një lidhje midis vendbanimit dhe vullnetarizmit.

H_1 : Ka një lidhje midis vendbanimit dhe vullnetarizmit.


Për të analizuar këtë hipotezë shikojmë tabelën e cila tregon lidhjen midis vendbanimit se sa janë vullnetarë, si qytetarë të Qarkut të Elbasanit.

Tabela 11: Sa jeni vullnetarë, si qytetarë të Qarkut të Elbasanit dhe vëndbanimi

Urbane	Zona ku jetoni		Total
	Rurale		
Sa jeni vullnetarë, si Aspak	29	4	33
qytetarë të Qarkut të Pak	76	17	93
Elbasanit? Mesatarisht	15	2	17
Shumë	1	1	2
Total	121	24	145

Rezultatet tregojnë se nga 121 personat e pyetur në zonat urbane 29 prej tyre mendojnë se qytetarët e Elbasanit nuk janë aspak vullnetarë, ndërsa nga personat e pyetur të vendbanimit rural 4 nga 24 persona të pyetur prej tyre mendojnë se qytetarët e Elbasanit nuk janë aspak vullnetarë.

Grafiku 25: Sa jeni vullnetarë, si qytetarë të Qarkut të Elbasanit sipas vendbanimit



Rezultatet në përqindje tregojnë se 62.8% e personave të pyetur në zonat urbane mendojnë se qytetarët e Elbasanit janë pak vullnetarë, afërsisht 70.8% e personave të pyetur në zonat rurale mendojnë këtë fakt. Kjo analizë e thjeshtë përshkruese duket sikur nuk tregon një lidhje se mund të ketë diferenca në përcaktimin e përgjithshëm për vullnetarizëm. Le ta shohim nëse kjo diferencë është statistikisht e rëndësishme. Për këtë do të aplikojmë testin e sipërpërmendur Hi-Katror.

Tabela 12: Testi Hi-Katror

	Value	Df	Asymp. Sig. (2-sided)
Vlera e testit Chi-Square	2.572(a)	3	.462>5%
Numri i individëve te pyetur	145		

Testi tregon se midis variablave në shqyrtim nuk ekziston një lidhje. Pra mund të konkludojmë se nuk ka një lidhje statistikore të rëndësishme midis vendbanimit dhe perceptimit sa janë vullnetarë, si qytetarë personat që jetojnë në Qarkun e Elbasanit.

Analiza e pavarësisë për Nivelin Arsimor

Në analizën që do të bëjmë me të dhënat e studimit në do të studiojmë nëse ka ndonjë lidhje midis nivelit arsimor të personit që është intervistuar dhe sjelljes së tij ndaj vullnetarizmit. Variabli niveli arsimor është një variabël i tipit kategorik. Ai merr 5 vlera:

1. Pa shkollë
2. Tetëvjeçar
3. I Mesëm / Profesional

4. Bachelor
5. Master profesional/shkencor

Ndërsa variabli i cili lidhet me konceptin se si kuptohet termi “Vullnetarizëm” merr shtatë vlera si më sipër. Të dy variablat në shqyrtim (niveli arsimor dhe vullnetarizmi) janë të tipit kategorik. Për të realizuar analizën e cila do të përcaktojë nëse ka ndonjë lidhje midis tyre do të përdoret testi Hi-katror (Chi-Square) me një nivel gabimi 5%. Testi Hi-katror i cili është një test statistikor për pavarësinë e variablave me njëri tjetrin mund të realizohet nëse plotësohen këto kushte:

- Variabla që do të studiohen të jenë në shkallë matje kategorike (niveli arsimor dhe vullnetarizmi).
- Të kenë të paktën 2 kategori (vullnetarizmi ka 7 kategori dhe niveli arsimor ka 5).
- Një njësi studimi (individët e pyetur) për një pyetje të klasifikohet vetëm në një kategori.

Të dhënat që në po studiojmë i përmbushin kriteret e mësipërme. Hipotezat që studimi ngre janë:

H_0 : Nuk ka një lidhje midis niveli arsimor dhe përcaktimit të termit të vullnetarizmit.

H_1 : Ka një lidhje midis nivelit arsimor dhe përcaktimit të termit të vullnetarizmit.

Analiza dhe hipotezat do të bëhen për variablin e nivelit arsimor me pyetjen “Si kuptohet termi “Vullnetarizëm” dhe gjithashtu edhe me pyetjen “Sa jeni vullnetarë, si qytetarë të Qarkut të Elbasanit?” veç e veç.

Analiza se si kuptohet termi “Vullnetarizëm”


H_0 : Nuk ka një lidhje midis niveli arsimor dhe përcaktimit të termit të vullnetarizmit.

H_1 : Ka një lidhje midis nivelit arsimor dhe përcaktimit të termit të vullnetarizmit.

Për të analizuar këtë hipotezë shikojmë tabelën e cila tregon lidhjen midis nivelit arsimor dhe përcaktimit të termit të vullnetarizmit. Sipas të dhënave janë analizuar 145 individë të niveleve arsimore të ndryshme. Nuk ka asnjë vlerë që mungon për secilin nga variablat. Rezultatet tregojnë se nga 57 personat e pyetur që kanë përfunduar bachelor si nivel arsimor, 6 prej tyre e përcaktojnë termin e vullnetarizmit si obligim, ndërsa nga 34 personat e anketuar që kanë

përfunduar master profesional/shkencor 3 prej tyre e konsiderojnë termin si obligim.

Grafiku 26: Niveli më i lartë i arsimit të përfunduar dhe përcaktimit të termit të vullnetarizmit



Rezultatet në përqindje tregojnë se 19.1% e personave të anketuar që kanë përfunduar shkollën e mesme të përgjithshme apo profesionale e shohin termin vullnetarizëm si hobi ndërsa personat që kanë mbaruar master e përcaktojnë si hobi rreth 20.6% e personave të intervistuar. Kjo analizë e thjeshtë përshkruese duket sikur tregon një lidhje se mund të ketë diferenca në përcaktimin e termit vullnetarizëm. Le ta shohim nëse kjo diferencë është statistikisht e rëndësishme. Për këtë do të aplikojmë testin e sipërpërmendur Hi-Katror.

Tabela 13: Testi Hi-Katror

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Vlera e testit Chi-Square	24.038(a)	24	.459>0.05
Numri i individëve të pyetur	145		

Testi tregon se midis variablave në shqyrtim nuk ekziston një lidhje. Pra mund të konkludojmë se nuk ka një lidhje statistikore të rëndësishme midis nivelit arsimor dhe përcaktimit të termit vullnetarizëm.

Analiza se sa janë vullnetarë, si qytetarë të Qarkut të Elbasanit

H_0 : Nuk ka një lidhje midis nivelit arsimor dhe vullnetarizmit.

H_1 : Ka një lidhje midis nivelit arsimor dhe vullnetarizmit.


Për të analizuar këtë hipotezë shikojmë tabelën e cila tregon lidhjen midis nivelit arsimor se sa janë vullnetarë, si qytetarë të Qarkut të Elbasanit.

Tabela 14: Niveli më i lartë i arsimimit të përfunduar dhe vullnetarizmi

Aspak		Sa jeni vullnetarë, si qytetarë të Qarkut të Elbasanit?				Total
		Pak	Mesatarisht	Shumë		
Cili është niveli më i lartë i arsimimit të përfunduar?	Pa shkollë	0	1	0	0	1
	Tetëvjeçar	2	4	0	0	6
	I Mesëm / Profesional	15	29	3	0	47
	Bachelor	7	41	8	1	57
	Master profesional/shkencor	9	18	6	1	34
Total		33	93	17	2	145

Rezultatet tregojnë se nga 57 personat e pyetur që kanë një diplomë Bachelor 15 prej tyre mendojnë se qytetarët e Elbasanit nuk janë aspak vullnetarë, ndërsa nga personat e pyetur që kanë përfunduar master profesional/shkencor 9 nga 34 persona të pyetur prej tyre mendojnë se qytetarët e Elbasanit nuk janë aspak vullnetarë.

Grafiku 27: Niveli më i lartë i arsimimit të përfunduar dhe vullnetarizimi



Rezultatet në përqindje tregojnë se 66.7% e personave të pyetur që kanë përfunduar shkollën tetëvjeçare mendojnë se qytetarët e Elbasanit janë pak vullnetarë, afërsisht 71.9% e personave të pyetur që kanë diplomën bachelor mendojnë këtë fakt. Kjo analizë e thjeshtë përshkruese duket sikur nuk

tregon një lidhje se mund të ketë diferenca në përcaktimin e përgjithshëm për vullnetarizëm. Le ta shohim nëse kjo diferencë është statistikisht e rëndësishme. Për këtë do të aplikojmë testin e sipërpërmendur Hi-Katror.

Tabela 15:Testi Hi-Katror

	Value	Df	Asymp. Sig. (2-sided)
Vlera e testit Chi-Square	11.309(a)	12	.503>5%
Numri i individëve te pyetur	145		

Testi tregon se midis variablave në shqyrtim nuk ekziston një lidhje. Pra mund të konkludojmë se nuk ka një lidhje statistikore të rëndësishme midis vendbanimit dhe perceptimit sa janë vullnetarë, si qytetarë personat që jeton në Qarkun e Elbasanit.

Analiza e pavarësisë për të ardhurat

Në analizën që do të bëjmë me të dhënat e studimit në do të studiojmë nëse ka ndonjë lidhje midis të ardhurave të personit që është intervistuar dhe sjelljes së tij ndaj vullnetarizmit. Variabli të ardhurat është një variabël i tipit kategorik. Ai merr 4 vlera:

1. 0 – 18 000 Lekë
2. 18 001 – 35 000 Lekë
3. 35 001 – 87 000 Lekë
4. Më shumë se 87 000 Lekë

Ndërsa variabli i cili lidhet me konceptin se si kuptohet termi “Vullnetarizëm “merr shtatë vlera si më sipër. Të dy variablat në shqyrtim (të ardhurat dhe vullnetarizmi) janë të tipit kategorik. Për të realizuar analizën e cila do të përcaktojë nëse ka ndonjë lidhje midis tyre do të përdoret testi Hi-katror (Chi-Square) me një nivel gabimi 5%. Testi Hi-katror i cili është një test statistikor për pavarësinë e variablave me njeri tjetrin mund të realizohet nëse plotësohen këto kushte:

- Variabla që do të studiohen të jenë në shkallë matje kategorike (të ardhurat dhe vullnetarizmi).
- Të kenë të paktën 2 kategori (vullnetarizmi ka 7 kategori dhe të ardhurat ka 4).

- Një njësi studimi (individët e pyetur) për një pyetje të klasifikohet vetëm në një kategori.

Të dhënat që në po studiojmë i përmbushin kriteret e mësipërme.

Hipotezat që studimi ngre janë:

H_0 : Nuk ka një lidhje midis të ardhurave dhe përcaktimit të termit të vullnetarizmit.

H_1 : Ka një lidhje midis të ardhurave dhe përcaktimit të termit të vullnetarizmit.

Analiza dhe hipotezat do të bëhen për variablin e të ardhurave me pyetjen “Si kuptohet termi “Vullnetarizëm” dhe gjithashtu edhe me pyetjen “Sa jeni vullnetarë, si qytetarë të Qarkut të Elbasanit? veç e veç.


Analiza se si kuptohet termi “Vullnetarizëm”

H_0 : Nuk ka një lidhje midis të ardhurave dhe përcaktimit të termit të vullnetarizmit.

H_1 : Ka një lidhje midis të ardhurave dhe përcaktimit të termit të vullnetarizmit.

Për të analizuar këtë hipotezë shikojmë tabelën e cila tregon lidhjen midis të ardhurave dhe përcaktimit të termit të vullnetarizmit. Sipas të dhënave janë analizuar 145 individë të niveleve të të ardhurave të ndryshme. Nuk ka asnjë vlerë që mungon për secilin nga variablat. Rezultatet tregojnë se nga 99 personat e pyetur që kanë të ardhura nga 18001-35000 lekë, 8 prej tyre e përcaktojnë termin vullnetarizëm si obligim dhe 33 prej tyre si punë pa kompensim, ndërsa nga 15 personat e anketuar që kanë të ardhura prej 0 – 18 000 lekë 3 prej tyre e konsiderojnë termin si hobi.

Grafiku 28: Vullnetarizmi dhe të ardhurat



Rezultatet në përqindje tregojnë se 50% e personave të anketuar që kanë të ardhura mbi 87000 lekë të rinj e shohin termin vullnetarizëm si hobi ndërsa më pak këtë term e shohin personat që kanë të ardhura nga 18001-35000 rreth 16.2% e personave të intervistuar. Kjo analizë e thjeshtë përshkruese duket sikur tregon një lidhje se mund të ketë diferenca në përcaktimin e termit vullnetarizëm. Le ta shohim nëse kjo diferencë është statistikisht e rëndësishme. Për këtë do të aplikojmë testin e sipërpërmendur Hi-Katror.

Tabela 16: Testi Hi-Katror

	Value	Df	Asymp. Sig. (2-sided)
Vlera e testit Chi-Square	13.801(a)	18	.742>0.05
Numri i individëve te pyetur	145		

Testi tregon se midis variablave në shqyrtim nuk ekziston një lidhje. Pra mund të konkludojmë se nuk ka një lidhje statistikore të rëndësishme midis të ardhurave dhe përcaktimit të termit vullnetarizëm.

Analiza se sa janë vullnetarë, si qytetarë të Qarkut të Elbasanit

H_0 : Nuk ka një lidhje midis të ardhurave dhe vullnetarizmit.

H_1 : Ka një lidhje midis të ardhurave dhe vullnetarizmit.


Për të analizuar këtë hipotezë shikojmë tabelën e cila tregon lidhjen midis të ardhurave se sa janë vullnetarë, si qytetarë të Qarkut të Elbasanit. Sipas të dhënave janë analizuar 145 individë me të ardhura të ndryshme. Nuk ka asnjë vlerë që mungon për secilin nga variablat.

Tabela 17: Sa jeni vullnetarë dhe të ardhurave ku futet e ardhurat mesatare mujore

		Zgjidhni njërin nga intervalet e të ardhurave ku futet e ardhura mesatare mujore				Total
		0 – 18 000 Lekë	18 001 – 35 000 Lekë	35 001 – 87 000 Lekë	Më shumë se 87 000 Lekë	
Sa jeni vullnetarë, si qytetarë të Qarkut të Elbasanit?	Aspak	4	23	6	0	33
	Pak	11	64	18	0	93
	Mesatarisht	0	11	4	2	17
	Shumë	0	1	1	0	2
Total		15	99	29	2	145

Rezultatet tregojnë se nga 99 personat e pyetur që kanë të ardhura nga 18001-35000, 23 prej tyre mendojnë se qytetarët e Elbasanit nuk janë aspak vullnetarë, ndërsa nga personat e pyetur që kanë të ardhura nga 0-18000 lekë të rinj 4 nga 15 persona të pyetur prej tyre e përcaktojnë se qytetarët e Elbasanit nuk janë aspak vullnetarë.

Grafiku 29: Sa jeni vullnetarë, si qytetarë të Qarkut të Elbasanit?



Rezultatet në përqindje tregojnë se 73.3% e personave të pyetur që kanë të ardhura mujore nga nën 18000 lek mendojnë se qytetarët e Elbasanit janë

pak vullnetare, afërsisht 64.6 % e personave të pyetur që kanë të ardhura nga 18001-35000 lek të rinj mendojnë këtë fakt. Kjo analizë e thjeshtë përshkruese duket sikur nuk tregon një lidhje se mund të ketë diferenca në përcaktimin e përgjithshëm për vullnetarizëm. Le ta shohim nëse kjo diferencë është statistikisht e rëndësishme. Për këtë do të aplikojmë testin e sipërpërmendur Hi-Katror.

Tabela 18: Testi Hi-Katror

	Value	Df	Asymp. Sig. (2-sided)
Vlera e testit Chi-Square	18.546(a)	9	.029<5%
Numri i individëve te pyetur	145		

Testi tregon se midis variablave në shqyrtim ekziston një lidhje. Pra mund të konkludojmë se ka një lidhje statistikore të rëndësishme midis të ardhurave dhe perceptimit sa janë vullnetarë, si qytetarë personat që jetojnë në Qarkun e Elbasanit.

Analiza e pavarësisë për gjininë

Në analizën që do të bëjmë me të dhënat e studimit në do të studiojmë nëse ka ndonjë lidhje midis gjinisë së personit që është intervistuar dhe sjelljes së tij ndaj vullnetarizmit. Variabli gjinia është një variabël i tipit kategorik. Ajo merr dy vlera:.

Ndërsa variabli i cili lidhet me konceptin se si kuptohet termi “Vullnetarizëm” merr shtatë vlera si më sipër.

Të dy variablat në shqyrtim (gjinia dhe vullnetarizmi) janë të tipit kategorik. Për të realizuar analizën e cila do të përcaktojë nëse ka ndonjë lidhje midis tyre do të përdoret testi Hi-katror(Chi-Square) me një nivel gabimi 5%. Testi Hi-katror i cili është një test statistikor për pavarësinë e variablave me njeri tjetrin mund të realizohet nëse plotësohen këto kushte:

- Variabla që do të studiohen të jenë në shkallë matje kategorike (gjinia dhe vullnetarizmi).
- Të kenë të paktën 2 kategori (vullnetarizmi ka 7 kategori dhe gjinia ka 2).
- Një njësi studimi (individët e pyetur) për një pyetje të klasifikohet vetëm në një kategori.

Të dhënat që në po studiojmë i përmbushin kriteret e mësipërme. Hipotezat që studimi ngre janë:

H_0 : Nuk ka një lidhje midis gjinisë dhe përcaktimit të termit të vullnetarizmit.

H_1 : Ka një lidhje midis gjinisë dhe përcaktimit të termit të vullnetarizmit.

Analiza dhe hipotezat do të bëhen për variablin gjinia me pyetjen “Si kuptohet termin “Vullnetarizëm” dhe gjithashtu edhe me pyetjen “Sa jeni vullnetarë, si qytetarë të Qarkut të Elbasanit?” veç e veç.

Analiza se si kuptohet termin “Vullnetarizëm”

H_0 : Nuk ka një lidhje midis gjinisë dhe përcaktimit të termit të vullnetarizmit.

H_1 : Ka një lidhje midis gjinisë dhe përcaktimit të termit të vullnetarizmit.


Për të analizuar këtë hipotezë shikojmë tabelën e cila tregon lidhjen midis gjinisë dhe përcaktimit të termit të vullnetarizmit.

Tabela 19: Vullnetarizëm dhe Gjinia

		Gjinia		Total
		Femër		
Si e kuptoni termin “Vullnetarizëm”?	Obligim	10	5	15
	Punë me kompesim	3	2	5
	Punë pa kompesim	14	32	46
	Hobi	13	13	26
	Kohë e lirë	16	15	31
	Ndjenjë e përkatësisë	11	9	20
	Tjetër Specifiko	2	0	2
Total		69	76	145

Rezultatet tregojnë se nga 69 meshkujt e intervistuar 10 prej tyre e mendojnë termin vullnetarizëm si obligim, ndërsa nga 76 femrat e intervistuar 5 prej tyre e konsiderojnë termin si obligim.

Grafiku 30: Vullnetarizmi dhe gjinia e të intervistuarit



Rezultatet në përqindje tregojnë se për femrat termi vullnetarizëm si punë pa kompensim e përcaktojnë 42.1% e tyre, ndërsa meshkujt rreth 20.3%. Kjo analizë e thjeshtë përshkruese duket sikur tregon një lidhje se mund të ketë diferenca në përcaktimin e termit vullnetarizëm. Le ta shohim nëse kjo diferencë është statistikisht e rëndësishme. Për këtë do të aplikojmë testin e sipërpërmendur Hi-Katror.

Tabela 20: Testi Hi-Katror

	Value	Df	Asymp. Sig. (2-sided)
Vlera e testit Chi-Square	10.830(a)	6	.004<5%
Numri i individëve të pyetur	145		

Testi tregon se midis variablave në shqyrtim ekziston një lidhje. Pra mund të konkludojmë se ka një lidhje statistikore të rëndësishme midis gjinisë dhe përcaktimit të termit vullnetarizëm.

Analiza se sa janë vullnetarë, si qytetarë të Qarkut të Elbasanit

H_0 : Nuk ka një lidhje midis gjinisë dhe vullnetarizmit.

H_1 : Ka një lidhje midis gjinisë dhe vullnetarizmit.


Për të analizuar këtë hipotezë shikojmë tabelën e cila tregon lidhjen midis gjinisë se sa janë vullnetarë, si qytetarë të Qarkut të Elbasanit:

Tabela 21: Sa jeni vullnetarë, si qytetarë dhe Gjinia

		Gjinia		Total
		Femër		
Sa jeni vullnetarë, si qytetarë të Qarkut të Elbasanit?	Aspak	17	16	33
	Pak	43	50	93
	Mesatarisht	7	10	17
	Shumë	2	0	2
Total		69	76	145

Rezultatet tregojnë se nga 69 meshkujt e intervistuar 17 prej tyre mendojnë se qytetarët e Elbasanit nuk janë aspak vullnetarë, ndërsa nga 76 fermtat e intervistuar 16 prej tyre mendojnë se qytetarët e Elbasanit nuk janë aspak vullnetarë.

Grafiku 31: Sa jeni vullnetarë, si qytetarë të Qarkut të Elbasanit sipas gjinisë



Rezultatet në përqindje tregojnë se për femrat qytetarët e Elbasanit janë pak vullnetarë, afërsisht 65.8% ndërsa meshkujt janë rreth 62.3%. Kjo analizë e thjeshtë përshkruese duket sikur nuk tregon një lidhje se mund të ketë diferenca në përcaktimin e përgjithshëm për vullnetarizëm. Le ta shohim nëse kjo diferencë është statistikisht e rëndësishme. Për këtë do të aplikojmë testin e sipërpërmendur Hi-Katror.

Tabela 22: Testi Hi-Katror

	Value	Df	Asymp. Sig. (2-sided)
Vlera e testit Chi-Square	2.755(a)	3	.431>5%
Numri i individëve te pyetur	145		

Testi tregon se midis variablave në shqyrtim nuk ekziston një lidhje. Pra mund të konkludojmë se nuk ka një lidhje statistikore të rëndësishme midis gjinisë dhe perceptimit sa janë vullnetarë, si qytetarë personat që jetojnë në Qarkun e Elbasanit.

Analiza e pavarësisë për Grupmoshën

Në analizën që do të bëjmë me të dhënat e studimit në do të studiojmë nëse ka ndonjë lidhje midis grupmoshës së personit që është intervistuar dhe sjelljes së tij ndaj vullnetarizmit. Variabli grupmosha është një variabël i tipit kategorik. Ai merr 4 vlera:

1. 15-29 vjeç
2. 30-44 vjeç
3. 45-59 vjeç
4. 60 + vjeç

Ndërsa variabli i cili lidhet me konceptin se si kuptohet termi “Vullnetarizëm” merr shtatë vlera si më sipër.

Të dy variablat në shqyrtim (grupmosha dhe vullnetarizmi) janë të tipit kategorik. Për të realizuar analizën e cila do të përcaktojë nëse ka ndonjë lidhje midis tyre do të përdoret testi Hi-katror (Chi-Square) me një nivel gabimi 5%. Testi Hi-katror i cili është një test statistikor për pavarësinë e variablave me njëri tjetrin mund të realizohet nëse plotësohen këto kushte:

- Variabla që do të studiohen të jenë në shkallë matje kategorike (grupmosha dhe vullnetarizmi).
- Të kenë të paktën 2 kategori (vullnetarizmi ka 7 kategori dhe grupmosha ka 4).
- Një njësi studimi (individët e pyetur) për një pyetje të klasifikohet vetëm nënjë kategori.

Të dhënat që në po studiojmë i përmbushin kriteret e mësipërme.

Hipotezat që studimi ngre janë:

H_0 : Nuk ka një lidhje midis grupmoshës dhe përcaktimit të termit të vullnetarizmit.

H_1 : Ka një lidhje midis grupmoshës dhe përcaktimit të termit të vullnetarizmit.

Analiza dhe hipotezat do të bëhen për variablin grupmosha me pyetjen “Si kuptohet termin “Vullnetarizëm” dhe gjithashtu edhe me pyetjen “Sa jeni vullnetarë, si qytetarë të Qarkut të Elbasanit?” veç e veç.

Analiza se si kuptohet termin “Vullnetarizëm”

H_0 : Nuk ka një lidhje midis grupmoshës dhe përcaktimit të termit të vullnetarizmit.

H_1 : Ka një lidhje midis grupmoshës dhe përcaktimit të termit të vullnetarizmit.


Për të analizuar këtë hipotezë shikojmë tabelën e cila tregon lidhjen midis grupmoshës dhe përcaktimit të termit të vullnetarizmit. Sipas të dhënave janë analizuar 145 individë të grupmoshave të ndryshme. Nuk ka asnjë vlerë që mungon për secilin nga variablat.

Tabela 23: Grupmosha dhe termi “Vullnetarizëm”

Grupmosha	Si e kuptoni termin “Vullnetarizëm”?							Total
	Obligim	Punë me kompesim	Punë pa kompesim	Hobi	Kohë e lirë	Ndjenjë e përkatësisë	Tjetër Specifiko	
15-29 vjeç	6	0	13	10	12	11	1	53
30-44 vjeç	5	4	28	13	16	9	1	76
45-59 vjeç	2	1	5	3	3	0	0	14
60 + vjeç	2	0	0	0	0	0	0	2
Total	15	5	46	26	31	20	2	145

Rezultatet tregojnë se nga 53 personat e pyetur në grup moshën 15-29 vjeç, 6 prej tyre e përcaktojnë termin vullnetarizëm si obligim, ndërsa në grup moshën 45-59 vjeç nga 14 personat e anketuar 2 prej tyre e konsiderojnë termin si obligim.

Grafiku 32: Vullnetarizmi sipas grupmoshës



Rezultatet në përqindje tregojnë se të gjithë individët 60+ e shohin termin vullnetarizëm si obligim ndërsa mosha 30-44 vjeç e përcaktojnë si të tillë pra rreth 6.6% e personave të intervistuar. Kjo analizë e thjeshtë përshkruese duket sikur tregon një lidhje se mund të ketë diferenca në përcaktimin e termit vullnetarizëm. Le ta shohim nëse kjo diferencë është statistikisht e rëndësishme. Për këtë do të aplikojmë testin e sipërpërmendur Hi-Katror.

Tabela 24: Testi Hi-Katror

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Vlera e testit Chi-Square	27.796(a)	18	.045<0.05
Numri i individëve te pyetur	145		

Testi tregon se midis variablave në shqyrtim ekziston një lidhje. Pra mund të konkludojmë se ka një lidhje statistikore të rëndësishme midis grupmoshës dhe përcaktimit të termit vullnetarizëm.

Analiza se sa janë vullnetarë, si qytetarë të Qarkut të Elbasanit

H_0 : Nuk ka një lidhje midis grupmoshës dhe vullnetarizmit.

H_1 : Ka një lidhje midis grupmoshës dhe vullnetarizmit.


Për të analizuar këtë hipotezë shikojmë tabelën e cila tregon lidhjen midis grupmoshës se sa janë vullnetarë, si qytetarë të Qarkut të Elbasanit. Sipas të dhënave janë analizuar 145 individë të grupmoshave të ndryshme. Nuk ka asnjë vlerë që mungon për secilin nga variablat.

Tabela 25: Grupmosha dhe vullnetarizmi

		Sa jeni vullnetarë, si qytetarë të Qarkut të Elbasanit?				Total
		Aspak	Pak	Mesatarisht	Shumë	
Grupmosha	15-29 vjeç	17	29	7	0	53
	30-44 vjeç	16	52	7	1	76
	45-59 vjeç	0	10	3	1	14
	60 + vjeç	0	2	0	0	2
Total		33	93	17	2	145

Rezultatet tregojnë se nga 76 personat e pyetur të grupmoshës 30-44 vjeç, 16 prej tyre e përcaktojnë se qytetarët e Elbasanit nuk janë aspak vullnetarë, ndërsa nga personat e pyetur të grupmoshës 15-29 vjeç 17 prej tyre e përcaktojnë se qytetarët e Elbasanit nuk janë aspak vullnetarë.

Grafiku 33: Sa jeni vullnetarë, si qytetarë të Qarkut të Elbasanit?



Rezultatet në përqindje tregojnë se 68.4% e personave të pyetur në moshën 30-44 vjeç mendojnë se qytetarët e Elbasanit janë pak vullnetarë, afërsisht 71.4% e personave 45-59 vjeç mendojnë këtë fakt. Kjo analizë e thjeshtë përshkruese duket sikur nuk tregon një lidhje se mund të ketë diferenca në përcaktimin e përgjithshëm për vullnetarizëm. Le ta shohim nëse kjo diferencë është statistikisht e rëndësishme. Për këtë do të aplikojmë testin e sipërpërmendur Hi-Katror.

Tabela 26: Testi Hi-Katror

	Value	Df	Asymp. Sig. (2-sided)
	13.229(a)	9	.153>5%
Vlera e testit Chi-Square	145		

Testi tregon se midis variablave në shqyrtim nuk ekziston një lidhje. Pra mund të konkludojmë se nuk ka një lidhje statistikore të rëndësishme midis grupmoshës dhe perceptimit sa janë vullnetarë, si qytetarë personat që jetojnë në Qarkun e Elbasanit.

Analiza e pavarësisë për Vendbanimin

Në analizën që do të bëjmë me të dhënat e studimit në do të studiojmë nëse ka ndonjë lidhje midis vendbanimit të personit që është intervistuar dhe sjelljes së tij ndaj vullnetarizmit. Variabli vendbanim është një variabël i tipit kategorik. Ai merr 2vlera:

1. Urbane
2. Rurale

Ndërsa variabli i cili lidhet me konceptin se si kuptohet termi “Vullnetarizëm” merr shtate vlera si më sipër. Të dy variablat në shqyrtim (vendbanimi dhe vullnetarizmi) janë të tipit kategorik. Për të realizuar analizën e cila do të përcaktojë nëse ka ndonjë lidhje midis tyre do të përdoret testi Hi-katror (Chi-Square) me një nivel gabimi 5%. Testi Hi-katror i cili është një test statistikor për pavarësinë e variablave me njëri tjetrin mund të realizohet nëse plotësohen këto kushte:

- Variabla që do të studiohen të jenë në shkallë matje kategorike (vendbanimi dhe vullnetarizmi).
- Të kenë të paktën 2 kategori (vullnetarizmi ka 7 kategori dhe vendbanimi ka 2).
- Një njësi studimi (individët e pyetur) për një pyetje të klasifikohet vetëm në një kategori.

Të dhënat që në po studiojmë i përmbushin kriteret e mësipërme.

Hipotezat që studimi ngre janë:

H_0 : Nuk ka një lidhje midis vendbanimit dhe përcaktimit të termit të vullnetarizmit.

H_1 : Ka një lidhje midis vendbanimit dhe përcaktimit të termit të vullnetarizmit.

Analiza dhe hipotezat do të bëhen për variablin vendbanimi me pyetjen “Si kuptohet termin “Vullnetarizëm” dhe gjithashtu edhe me pyetjen “Sa jeni vullnetarë, si qytetarë të Qarkut të Elbasanit?” veç e veç.

Analiza se si kuptohet termin “Vullnetarizëm”

H_0 : Nuk ka një lidhje midis vendbanimit dhe përcaktimit të termit të vullnetarizmit.

H_1 : Ka një lidhje midis vendbanimit dhe përcaktimit të termit të vullnetarizmit.


Për të analizuar këtë hipotezë shikojmë tabelën e cila tregon lidhjen midis vendbanimit dhe përcaktimit të termit të vullnetarizmit. Sipas të dhënave janë analizuar 145 individë të vendbanimeve të ndryshme. Nuk ka asnjë vlerë që mungon për secilin nga variablat.

Tabela 27: Termi “Vullnetarizëm” dhe vendbanimi

		Zona ku jetoni		Total
Urbane		Rurale		
Si e kuptoni termin “Vullnetarizëm”?	Obligim	13	2	15
	Punë me kompesim	5	0	5
	Punë pa kompesim	38	8	46
	Hobi	15	11	26
	Kohë e lirë	28	3	31
	Ndjenjë e përkatësisë	20	0	20
	Tjetër Specifiko	2	0	2
Total		121	24	145

Rezultatet tregojnë se nga 121 personat e pyetur në zonat urbane, 13 prej tyre e përcaktojnë termin vullnetarizëm si obligim, ndërsa nga 24 personat e anketuar 2 prej tyre e konsiderojnë termin si obligim.

Grafiku 34: Vullnetarizmi sipas vendbanimit



Rezultatet në përqindje tregojnë se 45.8% në të gjithë zonat rurale e shohin termin vullnetarizëm si hobi ndërsa në zonat urbane e përcaktojnë rreth 12.4 % e personave të intervistuar. Kjo analizë e thjeshtë përshkruese duket sikur tregon një lidhje se mund të ketë diferencë në përcaktimin e termit vullnetarizëm. Le ta shohim nëse kjo diferencë është statistikisht e rëndësishme. Për këtë do të aplikojmë testin e sipërpërmendur Hi-Katror.

Tabela 28: Testi Hi-Katror

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Vlera e testit Chi-Square	19.039(a)	6	.004<0.05
Numri i individëve të pyetur	145		

Testi tregon se midis variablave në shqyrtim ekziston një lidhje. Pra mund të konkludojmë se ka një lidhje statistikore të rëndësishme midis vendbanimit dhe përcaktimit të termit vullnetarizëm.

Analiza se sa janë vullnetarë, si qytetarë të Qarkut të Elbasanit

H_0 : Nuk ka një lidhje midis vendbanimit dhe vullnetarizmit.

H_1 : Ka një lidhje midis vendbanimit dhe vullnetarizmit.


Për të analizuar këtë hipotezë shikojmë tabelën e cila tregon lidhjen midis vendbanimit se sa janë vullnetarë, si qytetarë të Qarkut të Elbasanit. Sipas të dhënave janë analizuar 145 individë të vendbanimeve të ndryshme. Nuk ka asnjë vlerë që mungon për secilin nga variablat.

Tabela 29: Vullnetarizmi dhe vendbanimi

	Zona ku jetoni		Total
	Rurale		
Urbane			
Sa jeni vullnetarë, si			
Aspak	29	4	33
qytetarë të Qarkut të Pak	76	17	93
Elbasanit?			
Mesatarisht	15	2	17
Shumë	1	1	2
Total	121	24	145

Rezultatet tregojnë se nga 121 personat e pyetur në zonat urbane 29 prej tyre mendojnë se qytetarët e Elbasanit nuk janë aspak vullnetarë, ndërsa nga personat e pyetur të vendbanimit rural 4 nga 24 persona të pyetur mendojnë se qytetarët e Elbasanit nuk janë aspak vullnetarë.

Grafiku 35: Sa jeni vullnetarë, si qytetarë të Qarkut të Elbasanit?



Rezultatet në përqindje tregojnë se 62.8% e personave të pyetur në zonat urbane mendojnë se qytetarët e Elbasanit janë pak vullnetarë, afërsisht 70.8% e personave të pyetur në zonat rurale mendojnë të njëjtën gjë. Kjo analizë e thjeshtë përshkruese duket sikur nuk tregon një lidhje se mund të ketë diferenca në përcaktimin e përgjithshëm për vullnetarizëm. Le ta shohim nëse kjo diferencë është statistikisht e rëndësishme. Për këtë do të aplikojmë testin e sipërpërmendur Hi-Katror.

Tabela 30: Testi Hi-Katror

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Vlera e testit Chi-Square	2.572(a)	3	.462>5%
Numri i individëve të pyetur	145		

Testi tregon se midis variablave në shqyrtim nuk ekziston një lidhje. Pra mund të konkludojmë se nuk ka një lidhje statistikore të rëndësishme midis vendbanimit dhe perceptimit sa janë vullnetarë, si qytetarë personat që jetojnë në Qarkun e Elbasanit.

Analiza e pavarësisë për Nivelin Arsimor

Në analizën që do të bëjmë me të dhënat e studimit në do të studiojmë nëse ka ndonjë lidhje midis nivelit arsimor të personit që është intervistuar dhe sjelljes së tij ndaj vullnetarizmit. Variabli niveli arsimor është një variabël i tipit kategorik. Ai merr 5 vlera si më sipër. Ndërsa variabli i cili lidhet me konceptin se si kuptohet termin “Vullnetarizëm” merr shtatë vlera si më sipër.

Të dy variablat në shqyrtim (niveli arsimor dhe vullnetarizmi) janë të tipit kategorik. Për të realizuar analizën e cila do të përcaktojë nëse ka ndonjë lidhje midis tyre do të përdoret testi Hi-katror (Chi-Square) me një nivel gabimi 5%. Testi Hi-katror i cili është një test statistikor për pavarësinë e variablave me njeri tjetrin mund të realizohet nëse plotësohen këto kushte:

- Variabla që do të studiohen të jenë në shkallë matje kategorike (niveli arsimor dhe vullnetarizmi).
- Të kenë të paktën 2 kategori (vullnetarizmi ka 7 kategori dhe niveli arsimor ka 5).
- Një njësi studimi (individët e pyetur) për një pyetje të klasifikohet vetëm në një kategori.
-

Të dhënat që në po studiojmë i përmbushin kriteret e mësipërme. Hipotezat që studimi ngre janë:

H₀: Nuk ka një lidhje midis nivelit arsimor dhe përcaktimit të termit të vullnetarizmit.

H₁: Ka një lidhje midis nivelit arsimor dhe përcaktimit të termit të vullnetarizmit.

Analiza dhe hipotezat do të bëhen për variablin nivelit arsimor me pyetjen “Si kuptohet termin “Vullnetarizëm” dhe gjithashtu edhe me pyetjen “Sa jeni vullnetarë, si qytetarë të Qarkut të Elbasanit?” veç e veç.


Analiza se si kuptohet termi “Vullnetarizëm”

H_0 : Nuk ka një lidhje midis nivelit arsimor dhe përcaktimit të termit të vullnetarizmit.

H_1 : Ka një lidhje midis niveli arsimor dhe përcaktimit të termit të vullnetarizmit.

Për të analizuar këtë hipotezë shikojmë tabelën e cila tregon lidhjen midis nivelit arsimor dhe përcaktimit të termit të vullnetarizmit. Sipas të dhënave janë analizuar 145 individë të niveleve arsimore të ndryshme. Nuk ka asnjë vlerë që mungon për secilin nga variablat. Rezultatet tregojnë se nga 57 personat e pyetur që kanë përfunduar studimet bachelor si nivel arsimor, 6 prej tyre e përcaktojnë termin vullnetarizëm si obligim, ndërsa nga 34 personat e anketuar që kanë përfunduar master profesional/shkencor 3 prej tyre e konsiderojnë termin si obligim.

Grafiku 36: Niveli më i lartë i arsimimit të përfunduar dhe përcaktimit të termit të vullnetarizmit



Rezultatet në përqindje tregojnë se 19.1% e personave të anketuar që kanë përfunduar shkollën e mesme të përgjithshme apo profesionale e shohin termin vullnetarizëm si hobi ndërsa personat që kanë mbaruar master e përcaktojnë si hobi rreth 20.6% e personave të intervistuar. Kjo analizë e thjeshtë përshkruese duket sikur tregon një lidhje se mund të ketë diferenca në përcaktimin e termit

vullnetarizëm. Le ta shohim nëse kjo diferencë është statistikisht e rëndësishme. Për këtë do të aplikojmë testin e sipërpërmendur Hi-Katror.

Tabela 31: Testi Hi-Katror

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Vlera e testit Chi-Square	24.038(a)	24	.459>0.05
Numri i individëve te pyetur	145		

Testi tregon se midis variablave në shqyrtim nuk ekziston një lidhje. Pra mund të konkludojmë se nuk ka një lidhje statistikore të rëndësishme midis nivelit arsimor dhe përcaktimit të termit vullnetarizëm.

Analiza se sa janë vullnetarë, si qytetarë të Qarkut të Elbasanit

H_0 : Nuk ka një lidhje midis nivelit arsimor dhe vullnetarizmit.

H_1 : Ka një lidhje midis nivelit arsimor dhe vullnetarizmit.


Për të analizuar këtë hipotezë shikojmë tabelën e cila tregon lidhjen midis nivelit arsimor se sa janë vullnetarë, si qytetarë të Qarkut të Elbasanit. Sipas të dhënave janë analizuar 145 individë të vendbanimeve të ndryshme. Nuk ka asnjë vlerë që mungon për secilin nga variablat.

Tabela 32: Niveli më i lartë i arsimimit të përfunduar dhe vullnetarizmi

	Sa jeni vullnetarë, si qytetarë të Qarkut të Elbasanit?				Total
	Aspak	Pak	Mesatarisht	Shumë	
Cili është niveli më i lartë i arsimimit të përfunduar?					
Pa shkollë	0	1	0	0	1
Tetëvjeçar	2	4	0	0	6
I Mesëm / Profesional	15	29	3	0	47
Bachelor	7	41	8	1	57
Master	9	18	6	1	34
profesional/shkencor					
Total	33	93	17	2	145

Rezultatet tregojnë se nga 57 personat e pyetur që kanë një diplomë Bachelor 15 prej tyre mendojnë se qytetarët e Elbasanit nuk janë aspak vullnetarë, ndërsa nga personat e pyetur që kanë përfunduar master profesional/shkencor 9 nga 34 persona të pyetur prej tyre e përcaktojnë se qytetarët e Elbasanit nuk janë aspak vullnetarë.

Grafiku 37: Niveli më i lartë i arsimit të përfunduar dhe vullnetarizmi



Rezultatet në përqindje tregojnë se 66.7% e personave të pyetur që kanë përfunduar shkollën tetëvjeçare mendojnë se qytetarët e Elbasanit janë pak vullnetarë, afërsisht 71.9% e personave të pyetur që kanë diplomën bachelor mendojnë këtë fakt. Kjo analizë e thjeshtë përshkruese duket sikur nuk tregon një lidhje se mund të ketë diferenca në përcaktimin e përgjithshëm për vullnetarizëm. Le ta shohim nëse kjo diferencë është statistikisht e rëndësishme. Për këtë do të aplikojmë testin e sipërpërmendur Hi-Katror.

Tabela 33: Testi Hi-Katror

	Value	Df	Asymp. Sig. (2-sided)
Vlera e testit Chi-Square	11.309(a)	12	.503>5%
Numri i individëve të pyetur	145		

Testi tregon se midis variablave në shqyrtim nuk ekziston një lidhje. Pra mund të konkludojmë se nuk ka një lidhje statistikore të rëndësishme midis vendbanimit dhe perceptimit sa janë vullnetarë, si qytetarë personat që jetojnë në Qarkun e Elbasanit.

Analiza e pavarësisë për të ardhurat

Në analizën që do të bëjmë me të dhënat e studimit në do të studiojmë nëse ka ndonjë lidhje midis të ardhurave të personit që është intervistuar dhe sjelljes së tij ndaj vullnetarizmit. Variabli të ardhurat është një variabël i tipit kategorik. Ai merr 4 vlera:

1. 0 – 18 000 Lekë
2. 18 001 – 35 000 Lekë
3. 35 001 – 87 000 Lekë
4. Më shumë se 87 000 Lekë

Ndërsa variabli i cili lidhet me konceptin se si kuptohet termi “Vullnetarizëm” merr shtatë vlera si më sipër. Të dy variablat në shqyrtim (të ardhurat dhe vullnetarizmi) janë të tipit kategorik. Për të realizuar analizën e cila do të përcaktojë nëse ka ndonjë lidhje midis tyre do të përdoret testi Hi-katror (Chi-Square) me një nivel gabimi 5%. Testi Hi-katror i cili është një test statistikor për pavarësinë e variablave me njeri tjetrin mund të realizohet nëse plotësohen këto kushte:

- Variabla që do të studiohen të jenë në shkallë matje kategorike (të ardhurat dhe vullnetarizmi).
- Të kenë të paktën 2 kategori (vullnetarizmi ka 7 kategori dhe të ardhurat ka 4).
- Një njësi studimi (individët e pyetur) për një pyetje të klasifikohet vetëm në një kategori.

Të dhënat që në po studiojmë i përmbushin kriteret e mësipërme. Hipotezat që studimi ngre janë:

H_0 : Nuk ka një lidhje midis të ardhurave dhe përcaktimit të termit të vullnetarizmit.

H_1 : Ka një lidhje midis të ardhurave dhe përcaktimit të termit të vullnetarizmit.

Analiza dhe hipotezat do të bëhen për variablin të ardhurave me pyetjen “Si kuptohet termin “Vullnetarizëm” dhe gjithashtu edhe me pyetjen “Sa jeni vullnetarë, si qytetarë të Qarkut të Elbasanit?” veç e veç.

Analiza se si kuptohet termi “Vullnetarizëm”

H_0 : Nuk ka një lidhje midis të ardhurave dhe përcaktimit të termit të vullnetarizmit.

H₁: Ka një lidhje midis të ardhurave dhe përcaktimit të termit të vullnetarizmit.


Për të analizuar këtë hipotezë shikojmë tabelën e cila tregon lidhjen midis të ardhurave dhe përcaktimit të termit të vullnetarizmit: Sipas të dhënave janë analizuar 145 individë të niveleve të të ardhurave të ndryshme. Nuk ka asnjë vlerë që mungon për secilin nga variablat.

Tabela 34: Termin “Vullnetarizëm” dhe të ardhurat mesatare mujore

Si e kuptoni termin "Vullnetarizem"?	Zgjidhni njërin nga intervalet e të ardhurave ku futet e ardhura mesatare mujore				Total
	0 – 18 000 Lekë	18 001 – 35 000 Lekë	35 001 – 87 000 Lekë	Më shumë se 87 000 Lekë	
Obligim	2	8	5	0	15
Punë me kompesim	0	5	0	0	5
Punë pa kompesim	6	33	7	0	46
Hobi	3	16	6	1	26
Kohë e lire	1	22	7	1	31
Ndjenjë e përkatësisë	2	14	4	0	20
Tjetër Specifiko	1	1	0	0	2
Total	15	99	29	2	145

Rezultatet tregojnë se nga 99 personat e pyetur që kanë të ardhura nga 18001-35000 lekë, 8 prej tyre e përcaktojnë termin vullnetarizëm si obligim dhe 33 prej tyre si punë pa kompensim, ndërsa nga 15 personat e anketuar që kanë të ardhura prej 0-18 000 lekë 3 prej tyre e konsiderojnë termin si hobi.

Grafiku 38: Si e kuptoni termin “Vullnetarizëm”?



Rezultatet në përqindje tregojnë se 50% e personave të anketuar që kanë të ardhura mbi 87000 lekë të rinj e shohin termin vullnetarizëm si hobi ndërsa më pak këtë term e shohin personat që kanë të ardhura nga 18001-35000 rreth 16.2% e personave të intervistuar. Kjo analizë e thjeshtë përshkruese duket sikur tregon një lidhje se mund të ketë diferenca në përcaktimin e termit vullnetarizëm. Le ta shohim nëse kjo diferencë është statistikisht e rëndësishme. Për këtë do të aplikojmë testin e sipërpërmendur Hi-Katror.

Tabela 35: Testi Hi-Katror

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Vlera e testit Chi-Square	13.801(a)	18	.742>0.05
Numri i individëve te pyetur	145		

Testi tregon se midis variablave në shqyrtim nuk ekziston një lidhje. Pra mund të konkludojmë se nuk ka një lidhje statistikore të rëndësishme midis të ardhurave dhe përcaktimit të termit vullnetarizëm.

Analiza se sa janë vullnetarë, si qytetarë të Qarkut të Elbasanit

H_0 : Nuk ka një lidhje midis të ardhurave dhe vullnetarizmit.

H_1 : Ka një lidhje midis të ardhurave dhe vullnetarizmit.


Për të analizuar këtë hipotezë shikojmë tabelën e cila tregon lidhjen midis të ardhurave se sa janë vullnetarë, si qytetarë të Qarkut të Elbasanit. Sipas të dhënave janë analizuar 145 individë me të ardhura të ndryshme. Nuk ka asnjë vlerë që mungon për secilin nga variablat.

Tabela 36: Sa jeni vullnetarë, si qytetarë të Qarkut të Elbasanit dhe të ardhurat mesatare mujore

		Zgjidhni njërin nga intervalet e të ardhurave ku futet e ardhura mesatare mujore				Total
		0 – 18 000 Lekë	18 001 – 35 000 Lekë	35 001 – 87 000 Lekë	Më shumë se 87 000 Lekë	
Sa jeni vullnetarë, si qytetarë të Qarkut të Elbasanit?	Aspak	4	23	6	0	33
	Pak	11	64	18	0	93
	Mesatarisht	0	11	4	2	17
	Shumë	0	1	1	0	2
Total		15	99	29	2	145

Rezultatet tregojnë se nga 99 personat e pyetur që kanë të ardhura nga 18001-35000, 23 prej tyre mendojnë se qytetarët e Elbasanit nuk janë aspak vullnetarë, ndërsa nga personat e pyetur që kanë të ardhura nga 0-18000 lekë të rinj 4 nga 15 persona të pyetur prej tyre e përcaktojnë se qytetarët e Elbasanit nuk janë aspak vullnetarë.

Grafiku 39: Sa jeni vullnetarë, si qytetarë të Qarkut të Elbasanit dhe të ardhurat



Rezultatet në përqindje tregojnë se 73.3% e personave të pyetur që kanë të ardhura mujore nën 18000 lekë mendojnë se qytetarët e Elbasanit janë pak vullnetarë, afërsisht 64.6 % e personave të pyetur që kanë të ardhura nga 18001-35000 lekë të rinj mendojnë këtë fakt. Kjo analizë e thjeshtë përshkruese duket sikur nuk tregon një lidhje se mund të ketë diferenca në përcaktimin e përgjithshëm për vullnetarizëm. Le ta shohim nëse kjo diferencë është statistikisht e rëndësishme. Për këtë do të aplikojmë testin e sipërpërmendur Hi-Katror.

Tabela 37: Testi Hi-Katror

	Value	Df	Asymp. Sig. (2-sided)
Vlera e testit Chi-Square	18.546(a)	9	.029<5%
Numri i individëve te pyetur	145		

Testi tregon se midis variablave në shqyrtim ekziston një lidhje. Pra mund të konkludojmë se ka një lidhje statistikore të rëndësishme midis të ardhurave dhe perceptimit sa janë vullnetarë, si qytetarë personat që jetojnë në Qarkun e Elbasanit.

GJETJA E PARË: KRIJIMI DHE PËRVIJIMI I STRATEGJISË RAJONALE TË TRASHËGIMISË KULTURORE, SI NJË GARANCI PËR MUNDËSIMIN E NJË ZHVILLIMI TË QËNDRUESHËM NË NIVEL QARKU

Bazuar në pyetjet e natyrës kërkimore, anketimeve të kryera si dhe analizës së plotë të dhënave, do të parashtrijmë gjetjet kryesore të këtij studimi. Një rëndësi të veçantë do ti kushtojmë kontributit të veçantë për evidentimin e rëndësisë së jashtëzakonshme që luan zbatimi konkret i Strategjisë për zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor të Qarkut të Elbasanit. *Strategjia Rajonale e Trashëgimisë Kulturore e Qarkut të Elbasanit është një strategji e rëndësishme në fushën e trashëgimisë kulturore, e cila ka si synim kryesor të saj avancimin e sistemit të ruajtjes dhe mbrojtjes së trashëgimisë kulturore në qark, në përputhje me standartet ndërkombëtare e kombëtare dhe parimet ligjore për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, shoqëror e kulturor.* Duke u bazuar tek kjo strategji, trashëgimia kulturore në qark përcaktohet si një shtyllë tepër e rëndësishme e zhvillimit të qëndrueshëm të qarkut. Kjo strategji ndërtohet në bazë të disa objektivave të përcaktuara qartazi nga analiza e përvojave të kaluara, anketimeve të realizuara nga qytetarët e përzgjedhur në Qarkun e Elbasanit, gjëndjes aktuale të objekteve të trashëgimisë kulturore. Me këtë strategji, prioritet mbetet avancimi i kuadrit ligjor dhe institucional në fushën e trashëgimisë kulturore në qark. Avancimi i vazhdueshëm i legjislacionit në fushën e trashëgimisë kulturore në nivel qarku duhet të jetë në plan të parë nën përputhje të plotë me legjislacionin e Bashkimit European dhe legjislacionit kombëtar në këtë drejtim. Promovimi i trashëgimisë kulturore të qarkut të Elbasanit duhet të shërbejë si një resurs për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, shoqëror e kulturor. Me anë të kësaj strategjie do të punohet për krijimin e një bashkëpunimi efektiv ndërinstitutional dhe ndërsektorial për ruajtjen dhe menaxhimin e objekteve të trashëgimisë kulturore në Qarkun e Elbasanit. Gjithëpërfshirja e trashëgimisë kulturore dhe promovimi

i vazhdueshëm i saj do të garantojë dhe do të nxjerrë në pah vlerat sociale, kulturore dhe ekonomike të trashëgimisë kulturore në Qarkun e Elbasanit. Nxitja e pjesmarrjes aktive në këtë strategji do të ndikojë në përmirësimin e vazhdueshëm e një komunikimi publik për qasjen e të gjithëve në mbrojtje të vlerave të trashëgimisë kulturore të qarkut, si një e drejtë e të gjithë qytetarëve të Qarkut të Elbasanit. Trashëgimia kulturore dhe vlerat që ajo mbart do të përcaktohen si një nga fushat më prioritare për insitucionet përgjegjëse në qark për vitet e ardhshme¹³⁸.

Si një fazë e rëndësishme e hartimit të kësaj strategjie ka shërbyer edhe konsultimi në mënyrë të vazhdueshme me ekspertët e fushës dhe grupeve të ndryshme të interesit si : doktorët e shkencave të fushës së trashëgimisë kulturore, ekspertët në fushën e trashëgimisë në qark, ekspertët e OJQ-ve që merren me trashëgiminë kulturore në Elbasan, Librazhd, Peqin, Gramsh si dhe drejtuesi i Muzeut Etnografik në Elbasan. Përfshirja e tyre në këtë strategji ka shërbyer si një garanci për zbatueshmërinë në mënyrë të përpiktë të saj.

Trashëgimia kulturore në Qarkun e Elbasanit është një dëshmi e një krijimtari shumë të hershme, që mbart vlera të jashtëzakonshme kulturore. Kjo pasuri e trashëguar me vlera unike, artistike, historike lidhet paralelisht me diversitetin e pasur të trashëgimisë arkeologjike, arkitekturore, tradicionale që gëzon Qarku i Elbasanit. Thirrja e vazhdueshëm për mobilizimin qytetar do të shihet si një mundësi për mbrojtjen dhe promovimin e vlerave të objekteve të trashëgimisë kulturore në Qarkun e Elbasanit. Kështu, trashëgimia kulturore ka një rol të jashtëzakonshëm në nxitjen e ndjenjës së identitetit kulturor dhe përkatësisë qytetare. Ajo konsiderohet ndër të tjera, si një pasuri që i përket të gjithë brezave të shoqërisë shqiptare.

GJETJA E DYTË : ZHVILLIMI I NJË KËNDVËSHTRIMI EUROPIAN PËR HARTIMIN DHE PËRVIJIMIN E NJË PLANI KONKRET RAJONAL TË TRASHËGIMISË KULTURORE NË QARKUN E ELBASANIT.

Bazuar në modelet dhe projektet e Bashkimit European në fushën e promovimit të trashëgimisë kulturore, do të parashtrojmë në këtë studim nevojën e krijimit të një plani konkret rajonal në fushën e trashëgimisë kulturore në Qarkun e Elbasanit. Ky plan do të nxisë bashkëpunimin midis bashkive të Qarkut të Elbasanit për promovimin e vazhdueshëm

138 Strategjia e Zhvillimit Rajon të Qarkut të Elbasanit, 2012-2016, fq 24.

e objekteve të trashëgimisë së tyre kulturore. Gjithashtu, ky plan do të ndihmojë autoritetet shtetërore e kulturore në qark për realizimin e objektivave të tyre në mbrojtje të vlerave të trashëgimisë kulturore. Kjo përpjekje do të vazhdojë nga ana e tyre deri në përmbushjen e objektivave të tyre për tu përafruar me normat dhe standartet e zhvilluara europiane. Në procesin e hartimit të kësaj gjetjeje, për zhvillimin një plani rajonal për diversitetin e trashëgimisë kulturore në Qarkun e Elbasanit, kam shfrytëzuar dhe modelin e suksesshëm të Këshillit Irlandez në fushën e trashëgimisë kulturore¹³⁹. Kjo më ka shërbyer si një referencë e plotë për të parashtruar nevojën e promovimit të hartimit të këtij plani rajonal në kushtet e Qarkut të Elbasanit. Bazuar në këtë model, nevojitet një qasje sistematike dhe e mirë strukturuar në funksion të zbatimit të këtij plani që po paraqesim. Ky plan përfshin edhe integrimin e të gjitha nismave të orientuara nga trashëgimia kulturore dhe zhvillimi i turizmit në këtë drejtim dhe në zhvillimin e sektorit të përgjithshëm të turizmit në rajon. Promovimi i diversitetit kulturor në Qarkun e Elbasanit është në fokus të veçantë të Bashkimit Europian dhe veçanërisht nga Këshilli i Europës¹⁴⁰. Po ti referohemi sërish procesit anketues të zhvilluar në këtë studim, dalim në përfundimin se të gjithë qytetarët që kanë dëshirë të angazhohen në mbrojtjen e dhe promovimin e vlerave që ofron trashëgimia kulturore e Qarkut të Elbasanit, duhet të kenë si synim transformimin progresiv të shoqërisë përmes demokracisë pjesmarrëse, duke përdorur trashëgiminë si vlerë të përbashkët. Gjithashtu, nëpërmjet këtij studimi po përpiqemi që të sigurojmë mirëqënien e komuniteteve, si një faktor mjaft i rëndësishëm dhe kontribues për të drejtat themelore të njeriut. Kjo do të arrihet nëpërmjet përmirësimit të cilësisë së jetesës dhe mjediseve jetësore që na rrethojnë. Duke synuar përmirësimin e cilësisë së jetës dhe mjediseve jetësore, në studimin tonë synojmë që të nxisim jetën e komunitetit duke u bazuar në individë aktivë, të përkushtuar të mbrojnë objektet e trashëgimisë kulturore në qark, përmes pjesmarrjes së lirë dhe demokratike. Ky proces i zhvillimit demokratik bazohet në shfrytëzimin e të gjitha burimeve lokale të trashëgimisë kulturore në qark, në krijimin e mundësive të barabarta në këto burime dhe në shpërndarjen e drejtë të përfitimeve mes të qytetarëve. Ky plan që në ofrojmë në këtë studim është produkt edhe i nismës rajonale të komuniteteve për zhvillimin e mëtejshëm kulturor e ekonomik të qarkut. Synimi kryesor mbetet

139 Shiko “Trashëgimia Kulturore në Irlandën e Veriut “hartuar nga Këshilli Irlandez, 2009, Fq 123.

140 Rekomandimi “Mbi promovimin e turizmit në fushën e trashëgimisë kulturore”, Këshilli i Europës, 2003.

promovimi i diversitetit kulturor të Qarkut të Elbasanit. Nëpërmjet këtij studimi ofrohet një kornizë për identifikimin e strategjive më të përshtatshme për të cuar para objektivat, në kontekstin e zhvillimit të nismave dhe komponentëve turistikë në fushën e trashëgimisë kulturore. Bazuar nga sa thëmë më sipër, besojmë se kjo gjetje e mirëmenduar e këtij studimi do të kontribuojë në zhvillimin rajonal të Qarkut të Elbasanit. Ky model që në ofrojmë në këtë studim mund të merret në konsideratë dhe të përdoret si një shëmbull pozitiv dhe për vëndët e tjera të Europës Juglindore.

PËRFUNDIME

Bazuar në krerët e mësipërm, në studim dalin këto përfundime:

- Rritja e ndërgjegjësimit dhe aktivizimit të qytetarëve në ruajtjen dhe administrimin korrekt të vlerave të trashëgimisë kulturore në Qarkun e Elbasanit. Trashëgimia jonë kulturore përbën një fushë mjaft të rëndësishme që kërkon një mobilizim shumë të gjërë qytetar në mbrojtje të vlerave që mbartin objektet kulturore në qark.
- Kontributi i vullnetarizmit si një mjet i domosdoshëm në mbrojtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore në Qark. Këtu i referohemi anketave të zhvihuara me qytetarët e Qarkut të Elbasanit, ku shumica e tyre mendojnë se vullnetarizmi kontribuon mjaftueshëm në mbrojtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore.
- Angazhimi i potencialeve rinore në procesin e ruajtjes dhe pasurimit të vlerave të trashëgimisë kulturore.
- Krijimi dhe përvijimi i raporteve bashkëkohore ndërmjet mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm në qark.
- Rritja e rolit të turizmit kulturor për promovimin e vlerave të objekteve të trashëgimisë kulturore dhe për arritjen e një shkalle zhvillimi ekonomik të qëndrueshëm në Qarkun e Elbasanit.
- Rritja e angazhimit të qytetarëve të Qarkut të Elbasanit për ruajtjen dhe pasurimin e mëtejshëm jo vetëm të objekteve kulturore por edhe në kultivimin e muzikës, si një vlerë e përbashkët e traditës elbasanase.
- Njohja e trashëgimisë kulturore të Qarkut të Elbasanit nga ana e qytetarëve mund të konsiderohet e kënaqshme. Bazuar në anketimin, shumica prej

tyre mendojnë se i njohin mesatarisht ose shumë objektet dhe vlerat e trashëgimisë kulturore.

- Qytetarët e Qarkut të Elbasanit e vlerësojnë maksimalisht trashëgiminë kulturore dhe e konsiderojnë atë si një prioritet për qarkun.
- Bazuar në anketimin e zhvilluar në këtë studim, rinia zë vëndin kryesor në angazhimin vullnetar në mbrojtje të vlerave të trashëgimisë kulturore. Pas kësaj kategorie, në vënd të dytë renditet mosha e mesme. Rinia në Qarkun e Elbasanit përbën një përqindje mjaft të konsiderueshme krahasuar me popullsinë e përgjithshme në nivel qarku.
- Nga anketimi del përfundimi se, papunësia dhe gjëndja e vështirë ekonomike e qytetarëve në qark përbëjnë pengesë të madhe në zngazhimin e tyre vullnetar në mbrojtje të objekteve të trashëgimisë kulturore. Angazhimi vullnetar duhet të shihet si një mjet tepër efikas në zvogëlimin e papunësisë dhe në përmirësimin e gjëndjes ekonomike të qytetarëve.
- Në përgjithësi, në studimin tonë, rëndësia e angazhimit vullnetar në Qarkun e Elbasanit vlerësohet mesatarisht e lartë. Mbi 90 % e qytetarëve të anketuar mendojnë se qarku ka nevojë për grupe të mëdha vullnetarësh rreth problematikave të ndryshme, në veçanti në fushën e trashëgimisë kulturore. Ky angazhim i qytetarëve shihet si një element shumë i rëndësishëm në promovimin dhe mbrojtjen e vlerave të jashtëzakonshme që mbartin objektet e trashëgimisë kulturore. Por nga ana tjetër, ky angazhim ndikon në promovimin e punës vullnetare për të mirën e përgjithshme të komunitetit.
- Bazuar në rezultatet e anketave të përdorura në këtë studim, del se iniciativat e OJQ-ve shërbejnë si faktorë nxitës për angazhimin e qytetarëve në punë vullnetare në mbrojtje të objekteve të trashëgimisë kulturore.
- Njohja zyrtare e punës vullnetare është faktor mjaft i rëndësishëm për nxitjen e qytetarëve të për tu angazhuar masivisht në mbrojtje të vlerave të trashëgimisë kulturore.
- Pas viteve '90 me përfundimin e proceseve të formimit të insitucioneve shtetërore në nivel lokal dhe qëndror, vëndi ynë posedon më të gjitha mundësitë dhe resurset për të ndërmarrë disa hapa konkretë në drejtimin

e mbrojtjes së objekteve të trashëgimisë kulturore.

- Vullnetarizmi shihet edhe si një faktor vendimtar për mirëqënien e qarkut, ndërsa puna vullnetare është përdorur si strategji dalëse nga situatat kur mungesa e fondeve rrezikon objektet dhe vlerat që mbart trashëgimia kulturore.
- Nga anketa e realizuar me qytetarët në Qarkun e Elbasanit, vërejmë qartë një bindje të theksuar dhe pajtueshmëri të përgjithshme për rëndësinë dhe rolin e punës vullnetare në mbrojtje të vlerave të trashëgimisë kulturore. Megjithatë, të pyetur për angazhimin e tyre në punë vullnetare, qytetarët e Qarkut të Elbasanit nuk kishin shumë përvoja për të na treguar. Nga këto të dhëna mund të përfundojmë se gadishmëria e qytetarëve për punë vullnetare duhet të ndërthuret me nxitjen e politikave dhe programeve konkrete, të cilat janë një detyrim i përbashkët i qeverisjes qëndrore, bashkive të qarkut dhe shoqërisë civile. Kur bëhet fjalë për rolin e institucioneve në nxitjen e vullnetarizmit në mbrojtje të trashëgimisë kulturore, qytetarët mendojnë se shoqëria civile është ajo që duhet të jetë prijëse e këtij procesi. Lidhja e vullnetarizmit me shoqërinë civile rezulton jo e befasishme, për shkak të përceptimit të përgjithshëm që puna vullnetare dhe shoqëria civile janë tepër të lidhura me njëra tjetrën.
- Përveç objekteve që mbartin vlera të jashtëzakonshme, trashëgimia kulturore në Qarkun e Elbasanit është e pasur dhe me vlera të tjera. Kështu, qytetarët në qark angazhohen në ruajtjen dhe kultivimin e muzikës, si një vlerë e përbashkët e traditës qytetare. Edhe pse nuk janë realizuar matje të opinionit publik në këtë drejtim, festivali i muzikës së vjetër qytetare elbasanase dhe publiciteti që ka në mbarë vëndin, mund të jenë një ndër arsytet e këtij angazhimi të madh, në krahasim me vlerat e tjera të trashëgimisë kulturore.
- Njohja e trashëgimisë kulturore nga ana e qytetarëve të qarkut, bazuar në rezultatet e anketimeve konsiderohet e kënaqshme. Shumica prej tyre, (rreth 77%) mendojnë se i njohin mesatarisht ose shumë objektet dhe vlerat e trashëgimisë kulturore në qark. Nëse angazhimi i tyre për mbrojtjen e këtyre vlerave mund të merret si një matës i kualitetit të njohjes së tyre, atëherë kjo njohje e relativizon rëndësinë e saj, duke mos i përkthyer

informatat dhe dijen për to në angazhim për ruajtjen dhe promovimin e tyre.

- Kuptimi i përgjithshëm i termit “Vullnetarizëm” në mesin e qytetarëve të Qarkut të Elbasanit është nga më të ndryshmit. Rreth 1/3 e tyre këtë e kuptojnë si një punë pa kompensim, ndërsa një pjesë tjetër e konsiderueshme si kohë të lirë dhe hobi. Këto të dhëna tregojnë një situatë jo shumë inkurajuese për vullnetarizmin në përgjithësi, duke e ulur konceptin e punës vullnetare për çështje të caktuara të interesit të përgjithshëm dhe duke e zhvendosur rëndësinë e saj poshtë prioriteteve të qytetarëve të Qarkut të Elbasanit. Megjithatë, një pjesë e tyre vullnetarizmin e kuptojnë në një kuptim më të gjërë, duke e përshkruar si “ndjenjë të përkatësisë « dhe obligim.
- Rëndësi e punës vullnetare në Qarkun e Elbasanit vlerësohet e lartë. Mbi 90 % të qytetarëve të anketuar mendojnë se Qarku i Elbasanit ka nevojë të madhe për grupe të vullnetarëve rreth çështjeve të ndryshme. Kjo nevojë, duke u kombinuar me hapësirën e madhe për përmirësim të gjëndjes jo vetëm në trashëgimi kulturore, është një element shtesë për angazhimin e të gjithë faktorëve të përshtatshëm për promovimin e punës vullnetare për të mirën e komunitetit në përgjithësi.
- Hartimi i strategjive konkrete rajonale në fushën e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore në qark;
- Pregatitja e një Plani Rajonal për diversitetin e trashëgimisë kulturore në Qarkun e Elbasanit. Këtu do të përfshihen të gjitha veprimet dhe detyrat drejtuar bashkive të qarkut, në identifikimin e objekteve të tyre të veçanta dhe në identifikimin e fushave të trashëgimisë kulturore;
- Koordinimi i të gjitha praktikave në fushën e menaxhimit të trashëgimisë kulturore, duke bërë të mundur përfshirjen e udhërrëfyesve lokalë në qark;
- Promovimi i mëtejshëm i trashëgimisë kulturore, si një burim i pacmuar studimi shkencor dhe nxitja e mëtejshme ndaj studiuesve të rinj i

ndërmarrjes së kësaj çështje në studimet e tyre;

- Angazhim maksimal në mbrojtje të trashëgimisë kulturore në qarkdhe pasurimi i mëtejshëm i saj, si një faktor thelbësor i integritetit në Bashkimin Europian;
- Mbështetje për kërkime të mëtejshme, jo vetëm në fushën e trashëgimisë kulturore por edhe në fusha të tjera si, : art, kulturë, shkencë etj.
- Krijim të qendrave kulturore rinore në bashkitë e qarkut për angazhim të rinjve të zonave të tyre në përfshirje të punës vullnetare.

REKOMANDIMET

Nisur nga rezultatet e procesit anketues, analizës që përmes tij ju bë rolit të vullnetarizmit në trashëgimi si dhe tek përvoja që ofrojnë rastët analoge në shtetet anëtare të BE-së, rekomandojmë që në funksion të administrimit, perfeksionimit dhe pasurimit të vlerave që përmban trashëgimia kulturore, vëmendja të përqëndrohet në këta tregues themellorë :

1. Për institucionet qëndrore

- Përmirësim i mëtejshëm i legjislacionit për trashëgiminë kulturore, në drejtim të ruajtjes dhe promovimit të vlerave të saj;
- Krijimi i një legjislacioni bashkëkohor për ruajtjen e qendrave, monumenteve dhe peisazheve historike si pjesë e rëndësishme e integritetit të monumenteve kulturore;
- Përshtatje e politikave ndërkombëtare për përfshirjen e komuniteteve në mbrojtje të objekteve të trashëgimisë kulturore;
- Promovim i mëtejshëm i trashëgimisë kulturore në vëndin tonë, përfshirë këtu dhe Qarkun e Elbasanit në rajon e botë;
- Krijim i projekteve në fushën e trashëgimisë kulturore ku të përfshihen komunitetet;
- Krijimi i një strukture të vetme për menaxhimin e trashëgimisë kulturore

në rrethet e Qarkut të Elbasanit;

- Promovimi i vazhdueshëm i trashëgimisë kulturore, si një element tepër i rëndësishëm në zhvillimin e turizmit në mbarë vëndin;
- Nxitja e kërkimit shkencor në fushën e trashëgimisë kulturore, duke marrë në konsideratë modelet më të mira që ofrojnë vëndët e zhvilluara perëndimore;
- Digjitalizimi i të gjithë objekteve të trashëgimisë sonë kulturore, përfshirë këtu dhe Qarkun e Elbasanit;
- Mbështetje të vazhdueshme me mjetë financiare ndaj subjekteve private që kontribuojnë për mbrojtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore në vënd;
- Rritje të investimeve në fushën e trashëgimisë kulturore, duke promovuar dhe pasuruar më tej vlerat e jashtëzakonshme që ajo mbart;
- Vendosje të standarteve të rrepta për aktivitetet e ndërmarra nga subjektet private në objektet kulturore të trashëgimisë kulturore;
- Rritje e numrit të botimeve dhe studimeve shkencore në fushën e trashëgimisë kulturore dhe mundësimi i i shpërndarjes së tyre, jo vetëm brënda vëndit por edhe në rrafshin ndërkombëtar.

2. Për institucionet lokale

- Vënia në zbatim në mënyrë të menjëhershme i Ligjit Për Vullnetarizmin dhe Ligjit “Për Trashëgiminë Kulturore”;
- Miratimi i rregulloreve përkatëse për promovimin e punës vullnetare në mbrojtje të vlerave të trashëgimisë kulturore në Qarkun e Elbasanit;
- Kontrolli dhe mbikqyrja e vazhdueshme e objekteve të rëndësishme të trashëgimisë kulturore në të gjithë qarkun;
- Hartimi i projekteve të ndryshme për promovimin e vullnetarizmit, në

funksion të ruajtjes dhe mbrojtjes së trashëgimisë kulturore në qark;

- Ndërmarrja e veprimeve të menjëhershme nga ana e bashkive në Qarkun e Elbasanit për të njohur autoritetet komunale në fushën e trashëgimisë kulturore dhe objekteve me vlera të veçanta të saj;
- Zhvillimi i nismave të përshtatshme nga ana e autoriteteve lokale për zhvillimin e mëtejshëm të turizmit, gjithmonë duke përdorur trashëgiminë kulturore tepër të pasur në këto zona të qarkut;
- Koordinimi i vazhdueshëm dhe shkëmbimi i informacionit në lidhje me praktikën e duhura për menaxhimin e mirë të trashëgimisë kulturore në bashkitë e qarkut;
- Rritja e vetëdijes nga ana e qytetarëve në zonat e Qarkut të Elbasanit për promovimin e ruajtjes së vlerave të trashëgimisë së tyre kulturore, pasurimin e mëtejshëm të tyre dhe përfshirjen e tyre në këtë proces;
- Krijim i strukturave rajonale në qark për të mundësuar përfshirjen dhe angazhimin e të rinjve për të promovuar më tej vlerat kulturore të trashëgimisë së tyre.

3. Për shoqërinë civile

- Nxitje të pjesmarrjes masive qytetare në mbrojtje të vlerave të trashëgimisë kulturore në Qarkun e Elbasanit;
- Angazhim maksimal i tyre në përhapjen e mëtejshme të punës vullnetare në zonat e qarkut;
- Përfshirje të punës vullnetare, në mbrojtje të trashëgimisë kulturore nga ana e institucioneve qendrore dhe vendore;
- Përfshirje e organizatave të shoqërisë civile në mbrojtje të vlerave të jashtëzakonshme të trashëgimisë kulturore;
- Informimi i vazhdueshëm i opinionit publik për rolin që luan puna vullnetare në mbrojtje të objekteve të trashëgimisë kulturore;
- Ndërmarrja e fushatave sensibilizuese për qytetarët e bashkive të qarkut

në lidhje me konceptin e vullnetarizmit dhe rolin e tij në funksion të mbrojtjes së objekteve të trashëgimisë kulturore.

4. Për organizatat ndërkombëtare dhe donatorët e ndryshëm

- Mbështetje financiare ndaj organizatave të ndryshme të shoqërisë civile që veprojnë në Qarkun e Elbasanit;
- Propagandim për njohjen zyrtare të punës vullnetare në qark;
- Financim të projekteve të ndryshme në fushën e trashëgimisë kulturore të ndërmarra në qark dhe nxitje të mëtejshme të kërkimit shkencor në këtë fushë;
- Promovim i mëtejshëm i punës vullnetare dhe vullnetarizmit në nivel lokal.

1. Sassatelli, Monica (ed.). *Trashëgimia si peizazh: negocimi i identitetit kulturor Evropian. Instituti i Universitetit Evropian, Qendra për studime të avancuara Robert Schuman. EUI dokument punues RSCAS Nr. 2006/05. Badia Fiesolana, San Domenico di Fiesole (Firence).*
2. 2006 Rezoluta (76) 28 në lidhje me adaptimin e ligjeve dhe rregulloreve për kërkesat e konservimit të integruar të trashëgimisë arkitekturale, Këshilli i Evropës 1976
3. Stovel, Herb. Përgatitja për rrezik: një manual menaxhmenti për trashëgiminë e kulturës botërore. Romë, ICCROM, 1998
4. Shukriu, Edi. Kosova antike. Prishtinë, Muzeu i Kosovës dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë, 2004.
